




Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Regulativni Autoritet Železnica
Railway Regulatory Authority



Raport vjetor 2015





Të arriturat e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave gjatë vitit 2015

Të arriturat e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave gjatë vitit 2015

Përmbajtja

PËRMBAJTJA	3
0. SHKURTESAT	6
1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	8
2. KORNIZA LIGJORE	12
2.1. Baza ekzistuese ligjore që rregullon ARH-në dhe fusheveprimi i tij	12
2.2. Përmirësimi i bazës ligjore në periudhën raportuese	12
2.3. Vështirësitë ligjore që ka hasur ARH në përmbushjen e misionit të vet	13
3. PERSHKRIMI I INSTITUCIONIT	16
3.1. Misioni/Vizioni	16
3.2. Kompetencat e ARH-së sipas Ligjit	17
4. FUSHEVEPRIMI QE MBULON ARH	18
4.1. Struktura organizative e ARH-së	18
4.1.1. Bordi mbikëqyrës i ARH-së	20
4.1.1.1. Mandati	20
4.1.1.2. Kompetencat	20
4.1.1.3. Funksionalizimi	20
4.1.2. Ekzekutivi	21
4.1.2.1. Drejtori i Përgjithshëm i ARH-së	21
4.1.2.2. Menaxhmenti i mesëm	21
4.1.2.3. Burimet njerëzore	21
4.1.2.3.1. Numri i punëtorëve dhe nevojat për punëtor të rinj	21
4.2. Sistemi për menaxhim të cilësisë	23
4.2.1. Të përgjithshme	23
4.2.2. Politika e cilësisë	23
4.2.3. Manuali i cilësisë	23
4.3. Trajnimet	24
4.4. Asetet	25
4.4.1. Lokacioni i ARH-së	25
5. AKTIVITETET PËR PERIUDHËN RAPORTUESE	26
5.1. DEPARTAMENTI I LICENCIMI	26
5.1.1. Detyrat dhe përgjegjësitë	26
5.1.2. Aktivitetet e Departamentit të Licencimit	26
5.1.2.1. Licencimi i Makinistëve	26
5.1.2.2. Njohja e licencës së Railtrans-it	29
5.1.2.3. Regjistri i Licencave	30
5.1.2.4. Monitorimi i Licencave	31
5.2. DEPARTAMENTI LIGJOR	32
5.2.1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit Ligjor	32
5.2.2. Aktivitetet e Departamentit Ligjor	32
5.3. DEPARTAMENTI I SIGURISË	33
5.3.1. Detyrat dhe përgjegjësitë	33
5.3.2. Aktivitetet e Departamentit të Sigurisë	33
5.3.2.1. Mbikëqyrja e implementimit të Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë	34
5.3.2.2. Autorizimet për vendosje në shërbim	35
5.3.2.3. Përgatitja e Raportit Vjetor të Sigurisë	38
5.3.2.4. Inspektimi i mjeteve lëvizëse	40
5.3.2.4.1. Inspektimi i mjeteve të Ferronikel-it	40
5.3.2.4.2. Inspektimi i mjeteve të Trainkos-it	40
5.3.2.5. Inspektimi i linjave hekurudhore	41
5.4. DEPARTAMENTI PËR INTEROPERABILITETIN	42
5.4.1. Detyrat dhe përgjegjësitë	42
5.4.2. Aktivitetet e Departamentit të Interoperabilitetit	42

5.4.2.1.	Mjetet hekurudhore me pronësi të pa definuar.....	43
5.4.2.2.	Autorizimet për futje në shërbim për nënsistemet strukturale konform kërkesave për Interoprabilitet.....	44
5.4.2.3.	Regjistrimi i mjeteve lëvizëse.....	44
5.4.2.4.	Marrëveshjet kontraktuale.....	47
5.4.2.5.	Specifikimet Teknike për Interoperabilitet STI.....	48
5.4.2.6.	Inspektimi i Regjistrimit të mjeteve lëvizëse	54
5.4.2.7.	Shënimi i Numrit Evropian në Mjetin Lëvizës.....	56
5.4.3.	Synimet e Departamentit të Interoperabilitetit.....	56
5.5.	DEPARTAMENTI I RREGULLIMI TË TREGUT	58
5.5.1.	Detyrat dhe Përgjegjësitë.....	58
5.5.2.	Aktivitetet e Departamentit të Rregullimit Tregut.....	59
5.5.2.1.	Monitorimi i Tregut Hekurudhor.....	59
5.5.2.2.	Mbikëqyrja e implementimit të Ekspozeut të Rrjetit 2015.....	59
5.5.2.3.	Mbikëqyrja e Kontratës për Ofrimin e Shërbimeve Publike.....	60
5.5.2.4.	Mbikëqyrja e procesit të konsultimeve për Draft Ekspozeun e Rrjetit 2016 si dhe dhenja e rekomandimeve për nivelin e pagesave të qasjes në infrastrukturë.....	60
5.5.2.5.	Takime pune me menaxherin e infrastrukturës Infrakos.....	60
5.5.2.6.	Takim pune me ndërmarrjen hekurudhore Trainkos.....	60
5.5.2.7.	Hartimi i akteve nënligjore dhe formularëve për fushën e rregullit të tregut hekurudhor.....	61
5.5.2.8.	Aktivitetet Promovuese për të Drejtat e Udhëtarëve në Transportin Hekurudhor.....	61
5.5.2.9.	Numri i udhëtarëve që kanë përdorur trenin si mjet udhëtimi si dhe sasia e mallrave të transportuar përmes hekurudhave gjatë vitit 2015.....	63
5.6.	DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS	67
5.6.1.	Detyrat dhe përgjegjësitë.....	67
5.6.2.	Aktivitetet e Departamentit të Administratës.....	67
5.7.	DEPARTAMENTI I FINANCAVE	68
5.7.1.	Detyrat dhe përgjegjësitë.....	68
5.7.2.	Aktivitetet e Departamentit të Financave.....	68
5.7.2.1.	Pasqyrat financiare.....	68
5.7.2.2.	Detajet e Shpenzimeve nga kategoritë e Pagat, Mallra dhe Shërbime, Shpenzime Komunale dhe Shpenzime Kapitale për vitin 2015 (Janar- Dhjetor 2015).....	73
5.8.	DIVIZIONI I PROKURIMIT	76
5.8.1.	Detyrat dhe përgjegjësitë.....	76
5.8.2.	Aktivitetet e Divizionit të Prokurimit.....	76
5.9.	KOMUNIKIMI ME PUBLIKUN DHE QASJA NË DOKUMENTE PUBLIKE	78
6.	PUNA GJATE VITIT PARAPRAK 2016	79
6.1.	PLANI I PUNËS 2016.....	79
6.2.	PUNA GJATE VITIT PARAPRAK.....	82
6.3.	BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL DHE AKTIVITETE E ARH-SË NË RRAFSHIN VENDOR DHE NDËRKOMBËTAR.....	84
7.	RAPORTIMI RRETH ADRESIMIT TË REKOMANDIMEVE TË ZYRES SË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM	95
8.	SHTOJCAT	96
8.1.	SHTOJCË I	96
8.1.1.	Korniza ligjore e BE-së e aplikueshme për sektorin e Hekurudhave.....	96
8.2.	SHTOJCË II	97
8.2.1.	Përshkrimi mbi Hekurudhat e Kosovës.....	97
8.2.2.	Harta e Hekurudhave të Kosovës.....	98
8.3.	SHTOJCË III	95
8.3.1.	Raporti Mbikëqyrja e Implementimit të Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë (SMS) nga Infrakos.....	99
8.4.	SHTOJCË IV	105
8.4.1.	Raport Mbikëqyrja e Implementimit të Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë (SMS) nga Trainkos.....	105
8.5.	SHTOJCË V	111
8.5.1.	Raporti vjetor i sigurisë për vitin paraprak (2014) ashtu siç parashihet më Ligjin 04/L-063 dhe Direktivën 2004/49/EC.....	111
8.6.	SHTOJCË VI	



8.6.1. Raporti me rekomandime të sigurisë dërguar Ferronikelit.....	
8.7. SHTOJCË VII	159
8.7.1. Raporti me rekomandime të sigurisë dërguar Trainkos-it.....	159
8.8. SHTOJCË VIII	169
8.8.1. Raporti me rekomandime të sigurisë dërguar Infrakos-it.....	169
8.9. SHTOJCË IX	175
8.9.1. Raporti i regjistrimit të mjeteve me pronësi të pa definuar	175
8.10. SHTOJCË X	181
8.10.1. Raporti i Monitorimit të Tregut.....	181

Shkurtesat

ARH	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
MI	Ministria e Infrastrukturës
MF	Ministria e Financave
INFRAKOS	Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës
TRAINKOS	Operimi me Trena të Hekurudhave të Kosovës
SH.A	Shoqëria Aksionare
IRG-Rail	Indenpedent Regulatorys Group-Rail
BE	Bashkimi Evropian
ZBE	Zyra e Bashkimit Evropian
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
OB	Organizatrat Buxhetore
ERA	European Railway Agency (Agjensioni Evropian i Hekurudhave)
SEETO	South-East Europe Transport Observatory (Observatori i Transportit të Evropës Juglindore)
OTIF	Organisation intergouvernementale pour les Transports Internationaux Ferroviaires (Organizimi Qeveritar për Transportet Ndërkombëtare Hekurudhore)
IPA	Instrumenti për Ndihmën e Para-Anëtarësimit
SMS	Safety Managment Sistem (Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë)
NVR	National Vehicle Register (Regjistri Nacional i Mjeteve Lëvizëse)
UIC	International Union of Railway (Unioni Nderkombëtar i Hekurudhave)
ECM	Entity in Charge of Maintenance (Entiteti Përgjegjës për Mirembajtje)
CSM	Common Safety Method (Metodat e Përbashkëta të Sigurisë)
EC	European Comision (Komisioni Evropian)
TAIEX	Technical Assistance and Information Exchange instrument (Asistenca Teknike dhe Shkëmbimi i Informacionit)
TCDD	Türkiye Cumhuriyeti Devlet Demiryolları (Hekurudhat Shtetërore të Turqisë)
STI	Specifikimet Teknike për Interoperabilitet Türkiye Cumhuriyeti Devlet Demiryolları
CSI	Common Safety Indicator (Indikatorët e Përbashkëta të Sigurisë)
NSA	Nacional Safety Authority
KRPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
AQP	Agjensioni Qendror i prokurimit



OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
FOT	Zyrës Federale të Transportit,
RACO	Organit për Rregullimin e Tregut Hekurudhor (RACO) në Bernë-Zvicër.

1. Përmbledhje ekzekutive



Kam nderin që si Drejtor i Përgjithshëm, përmes Raportit Vjetor të punës 2015 t'i prezantoj para Kuvendit të Republikës së Kosovës aktivitetet e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave (ARH), që përfshijnë zhvillimet më të rëndësishme të ARH-së si një rregullator profesional dhe i fuqishëm në vend dhe rajon. Duke iu përgjigjur me profesionalizëm dhe ritëm të lartë pune për përparimin e sektorit të transportit hekurudhor, duke shënuar një hap drejt fuqizimit të ARH-së dhe sektorit të transportit hekurudhor në përgjithësi në Republikën e Kosovës.

ARH është organ i pavarur i themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës i cili është i ngarkuar për rregullimin, mbikëqyrjen, organizimin e sektorit hekurudhor në Republikën e Kosovës dhe vepron si organ për: Licencim, Siguri, Interoperabilitet dhe Rregullim të Tregut. ARH ofron shërbime cilësore të sigurt, transparente dhe jo diskriminuese për Ndërmarrjet Hekurudhore dhe Menaxherin e Infrastrukturës në sektorin hekurudhor në Republikën e Kosovës dhe kompetencave të tjera të cilat i jepen në bazë të Ligjit Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Republikës së Kosovës i cili është në përputhje të plotë me legjislacionin dhe direktivat në fuqi të BE-së.

Raporti Vjetor i punës për vitin 2015 ofron informacione përmbajtësore mbi progresin e angazhimeve dhe punëve të ARH-së në arritjen e objektivave dhe qëllimeve strategjike të saj, disa prej të cilave do të vazhdojnë edhe gjatë vitit 2016. Raporti gjithashtu përmbledhë dhe paraqet një pasqyrë të ngjarjeve dhe zhvillimeve më të rëndësishme për aktivitetet e realizuara në sektorin e transportit Hekurudhor në Republikën e Kosovës.

ARH gjatë vitit 2015 ka vazhduar të përforcojë funksionet e veta rregullatore në katër fusha kryesore:

Licencimi - Për herë të parë në Republikën e Kosovës, ARH ka bërë licencimin e makinistëve të ndërmarrjes hekurudhore Trainkos konform dispozitave ligjore në fuqi në Republikën e Kosovës dhe në BE. Licencimi i makinistëve ka qenë njëri ndër obligimet e domosdoshme ligjore për operimet në shërbimet hekurudhore i cili është realizuar me sukses. Pas dhënies së licencave për makinistët, ARH gjatë vitit 2015 ka monitoruar licencat e lëshuara, që policat vjetore të sigurimit për palët e treta të ripërtërihen, duke u siguruar kështu që ndërmarrja hekurudhore dhe menaxheri i infrastrukturës i kane plotësuar obligimet e përcaktuara me Ligjin e Hekurudhave.

Po ashtu është rishikuar validiteti i licencave dhe është azhurnuar regjistri i ndërmarrjeve hekurudhore dhe menaxherit të infrastrukturës, të licencuara në Republikën e Kosovës. Pas pranimit të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje

Administrative Nr. AA.Nr.216/2015, Departamenti i Licencimit me datë 12.11.2015 ka marrë vendim të njoh si valide licencën për transport hekurudhor të mallrave për kompaninë private RAILTRANS, të lëshuar me datë 10.03.2014 nga ARH.

Siguria - Ka përfunduar procesin e mbikëqyrjes së implementimit të Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë (SMS) nga ana e Operatorit me Trena Trainkos dhe Menaxherit të Infrastrukturës Infrakos. Qëllimi i këtij procesi të mbikëqyrjes së implementimit të SMS ka qenë që të sigurohemi se ky sistem plotëson kërkesat e sigurisë dhe përmban elementet të cilat kanë të bëjnë me sigurinë e sistemit hekurudhor në Republikën e Kosovës.

Është përgatitur Raporti Vjetor i Sigurisë për vitin 2014, raport i cili përgatitet nga departamenti i sigurisë në kuadër të ARH-së, në përputhje me ligjin 04/L-063 Neni 20 për Hekurudhat e Kosovës si dhe nenit 18 të Direktivës 2004/49/EC. Struktura e këtij raporti është në përputhje me rekomandimet (modelit dhe udhëzimit) e Agjensionit Evropian Hekurudhor (ERA).

Janë lëshuar autorizime për futjen në shërbim të mjeteve (pajisjeve) për mirëmbajtjen e infrastrukturës hekurudhore.

Janë kryer inspektimet e të gjitha linjave hekurudhore të cilat menaxhohen nga Infrakos si dhe inspektimet e të gjitha lokomotivave, vagonëve të udhëtarëve, vagonëve mallrave dhe trenave motorik të cilët janë në pronësi të Trainkos-it. Gjithashtu janë inspektuar të gjithë vagonët e mallrave të Feronikelit. Si rezultat janë përgatitur raportet me rekomandime të sigurisë për linjat dhe mjetet lëvizëse të inspektuara, të cilat iu janë dërguar kompanive përkatëse.

Interoperabiliteti - është përgjegjës për t'i përcaktuar kushtet të cilat duhet t'i plotësojë sistemi hekurudhor në Republikën e Kosovës për të arritur interoperabilitetin me sistemin hekurudhor të BE-së në drejtim të krijimit të hapësirës të interoperabilitetit Evropian, pjesë e së cilës dëshiron të jetë edhe Republika e Kosovës.

Gjithashtu ka parashikuar standardet e përbashkëta teknike të quajtura Specifikime Teknike për Interoperabilitet STI, që të aplikohen në të gjithë sistemin hekurudhor brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës. ARH-ja ka qenë përgjegjëse për të gjitha vlerësimet dhe analizat e Interoperabilitetit në Republikën e Kosovës dhe kërkesave të tjera të cilat kanë të bëjnë me futjen në shërbim, përmirësimin, renovimin dhe mirëmbajtjen e pjesëve të sistemit.

ARH gjatë vitit 2015 ka realizuar regjistrimin dhe ri-regjistrimin e mjeteve lëvizëse nga Menaxheri i Infrastrukturës dhe Ndërmarrja Hekurudhore. Është realizuar inspektimi i regjistrimit të mjeteve lëvizëse hekurudhore të cilat janë të regjistruara që nga 2012 deri në fund të 2015.

ARH gjatë vitit 2015 ka përfunduar raportin për regjistrim të mjeteve lëvizëse hekurudhore me pronësi të pa definuar të cilat gjinden brenda territorit të Republikës së Kosovës. Këtë raport e ka dërguar në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Ministrinë e Infrastrukturës, Infrakos, Trainkos dhe në Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Tregti, Industri dhe Infrastrukturë të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

ARH ka krijuar listën e marrëveshjeve ndërkufitare me të dhëna dhe informacione të ofruara nga palët nënshkruese. Lista përfshinë marrëveshjet ndërkufitare të finalizuara dhe të pa-finalizuara.

Rregullimi i Tregut - Është siguruar që Ekspozeu i Rrjetit të mos përmbajë klauzola diskriminuese jo transparente. Sigurimi që qasja në binarë, stacione, depot e operatorëve që plotësojnë kushtet e domosdoshme të jetë e drejtë transparente dhe jo diskriminuese. Puna dhe angazhimi i rregullimit të tregut ka qenë e fokusuar në gatishmërinë e vazhdueshme që të merren masa kur është e nevojshme për të arritur këtë.

Është organizuar dhe përfunduar me sukses fushata e vetëdijesimit për të drejtat e udhëtarëve në transportin hekurudhor në Republikën e Kosovës, ku përmes shpërndarjes së broshurave si dhe vendosjes së postierëve nëpër stacione kryesore të udhëtarëve dhe linjave hekurudhore, duke bashkëbiseduar me udhëtarët për të drejtat e tyre që ju garantohen me Ligjin për Hekurudhat dhe me standardet ndërkombëtare. Kemi arritur që në masë të madhe këtë fushatë ta bëjmë sa më atraktive dhe të pranueshme duke arritur kështu që të përçojmë mesazhin tek shfrytëzuesit e transportit hekurudhor për të drejtat e tyre. Gjithashtu kemi siguruar që kompanitë të plotësojnë nevojat e udhëtarëve dhe shfrytëzuesve të mallrave, duke ofruar shërbime të sigurt, efikase, transparente dhe jo diskriminuese për zhvillimin e sektorit hekurudhor. Po ashtu është përgatitur Raporti Vjetor i Monitorimit të Tregut dhe ky raport është dërguar në IRG-Rail.

Rregullimi i Tregut ka bashkëpunuar me organet e tjera rregullative të tregut hekurudhor veçmas sa i përket Marrëveshjes së Komunitetit të Transportit ndërmjet partnerëve të SEETO-së dhe IRG – Rail në mënyrë që të lehtësohen dhe koordinohen kushtet rregullative të tregut hekurudhor me vendet e tjera.

Në veprimtarinë dhe punën e saj vjetore ARH ka synuar në vazhdimësi zhvillimin dhe nxitjen e politikave rregullatore për vendosjen dhe forcimin e veprimtarisë së të gjithë operatorëve që operojnë në sektorin hekurudhor dhe menaxherit të infrastrukturës, brenda kuadrit ligjor dhe përmirësimin e shërbimeve ndaj shfrytëzuesve.

Puna e ARH-se gjatë vitit 2015 u fokusua kryesisht në arritjen e qëllimeve dhe objektivave strategjike të përcaktuara, duke përfshirë analizën e detajuar të dukurive më të rëndësishme në sektorin hekurudhor. Ka kontribuar në sigurimin e cilësisë së shërbimeve në fushat përgjegjëse për të siguruar një nivel të lartë të mbrojtjes së të drejtave të shfrytëzuesve në sektorin e transportit hekurudhor, nxitjen e konkurrencës së lirë si dhe ofrimin e shërbimeve si një nga parakushtet thelbësore për investime në sektorin hekurudhor.

ARH ka bashkëpunuar dhe përkrahur institucionet tjera përgjegjëse për sektorin hekurudhor në Republikën e Kosovës në mënyrë që i tërë sistemi rregullator dhe mbikëqyrës i hekurudhave të funksionojë i koordinuar dhe në përputhje me standardet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare. Kemi vazhduar bashkëpunimin me autoritetet hekurudhore homologe në rajon dhe më gjerë, si dhe shkëmbim të përvojave të stafit me autoritetet e shteteve fqinje si dhe shteteve anëtare të IRG – Rail.

ARH gjatë vitit 2015 ka përfituar tri projekte nga programet e asistencës teknike të përkrahura nga Komisioni Evropian përmes instrumentit TAIEX, një punëtor për të drejtat e udhëtarëve, një mision të eksperteve për të hyra dhe gjopa dhe misioni i eksperteve për dhënien e autorizimit për futje në shërbim të mjeteve lëvizëse dhe infrastrukturës, mirëpo këto tri projekte nuk janë realizuar për shkak të procedurave të Komisionit Evropian, priten të realizohen gjatë vitit 2016.

ARH, është shumë e interesuar të sigurojë mbështetje maksimale në zhvillimet e reja dhe sfidat në sektorin e transportit hekurudhor në Republikën e Kosovës, për ti përmirësuar dhe vazhduar proceset e zhvillimit dhe integritit në këtë sektor.

Zyra Ligjore, ka vazhduar që të sigurojë ligjshmërinë në zbatimin e Ligjit të Hekurudhave dhe gjitha akteve nënligjore të nxjerra nga ARH-ja, në mënyrë që sektori hekurudhore në Republikën e Kosovës të rregullohet dhe mbikëqyret konform praktikave më të mira rajonale dhe ato të BE-së.

Gjatë vitit 2015, ARH ka përfunduar të gjitha veprimet e nevojshme për ngritjen e Sistemit për Menaxhim të Cilësisë sipas Standardit ISO 9001:2008 duke përfshirë hartimin e Politikës së Cilësisë, të gjitha proceseve dhe procedurave të punës, hartimin dhe miratimin e Manualit të Cilësisë etj. Në gjashtë mujorin e parë të vitit 2016, synojmë certifikimin ndërkombëtar të ARH-së sipas Standardit të Cilësisë ISO 9001:2008.

Në qershor 2015 Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës (ZAP) ka publikuar Raportin e Auditimit për pasqyrat financiare të ARH-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014. Në raport thuhet se Menaxhmenti i ARH-së ka të dizajnuar sistem efektiv të kontrollit të brendshëm në të gjitha fushat e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe nuk ka vërejtur asnjë gjetje.

Buxheti fillestar i ARH-së për vitin 2015 ishte 325,421.00 €, mirëpo pas shkurtimit të buxhetit fillestar të vitit 2015 nga Ministria e Financave, Buxheti final i vitit fiskal 2015 ishte 245,814.00 €. Gjatë këtij viti ARH ka shpenzuar 237,902.86 € që do të thotë se është realizuar 97 % e buxhetit të miratuar, ndërsa gjatë vitit 2016 ARH pritet të realizojë edhe të hyra nga taksat dhe gjokat të parapara sipas ligjit të hekurudhave.

ARH do të vazhdojë të jetë një rregullator aktiv dhe shumë i rëndësishëm në zhvillimin e sektorit të transportit hekurudhor në vend, duke siguruar vazhdimësinë e angazhimeve të ARH-së edhe për vitet e ardhshme. Jemi të bindur se në sajë të përpjekjeve tona të përbashkëta, për vitin e ardhshëm do të kemi rezultate shumë më të mira në sektorin e transportit hekurudhor në Republikën e Kosovës.

Falënderoj të gjitha institucionet vendore dhe ndërkombëtare për bashkëpunimin dhe kontributin e dhënë në përmbushjen e shumë prej objektivave të përbashkëta në dobi të sektorit të transportit hekurudhor në Republikën e Kosovës.

Me respekt,
Mr. sc. Enis Berisha
Drejtor i Përgjithshëm

2. Korniza ligjore

ARH është organ i pavarur që rregullon dhe mbikëqyrë sektorin e hekurudhave në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë dhe me legjislacionin në fuqi të BE-së, të përshtatshëm për Kosovën në këtë sektor.

2.1. Baza ekzistuese ligjore që rregullon ARH-në dhe fushëveprimin e tij

- Ligji për Hekurudhat e Kosovës Nr. 04/L-063
- Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2012 për Licencimin e Ndërmarrjeve Hekurudhore
- Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2012 për Licencimin e Menaxherëve të Infrastrukturës
- Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2012 për Dhënien e Certifikatës dhe Autorizimit të Sigurisë për Ndërmarrjet Hekurudhore dhe Menaxherët e Infrastrukturës Hekurudhore
- Rregulloren Nr. 01/2012 për Licencimin e Menaxherëve dhe Ndërmarrjeve Hekurudhore
- Rregullore Nr. 03/2012 për Certifikatat e Sigurisë
- Rregullore Nr. 04/2012 për Autorizimin e Sigurisë
- Rregullore Nr. 05/ 2012 për Regjistrin Nacional të Mjeteve Lëvizëse Hekurudhore, dhe
- Rregullore Nr. 06/ 2012 për Regjistrimin e Infrastrukturës.
- Rregulloren Nr. 01/2013 për Ekspozeun e Rrjetit
- Rregulloren Nr. 02/2013 për Licencimin e Makinistëve.
- Rregullore Nr. 01/2014 për Modelin e Deklaratës së Konformitetit për Llojin e Autorizuar të Mjetit Hekurudhor.

SHTOJCË I Korniza ligjore e BE-së e aplikueshme për sektorin e Hekurudhave

2.2. Përmirësimi i bazës ligjore në periudhën raportuese

Gjatë vitit 2015 ARH ka draftuar këto Rregullore:

- Draft Rregullore për të Hyrat dhe Gjobat e ARH-së
- Draft Rregullore për të Drejtat e Udhëtarëve në Transportin Hekurudhor
- Draft Rregullore për Raportimin e Monitorimit të Tregut Hekurudhor

2.3. Vështirësitë ligjore që ka hasur ARH në përmbushjen e misionit të vet

ARH gjatë vitit 2015 ka pasur vështirësi ligjore në përmbushjen e misionit të vet, për faktin se edhe këtë vit ka pasur mungesë të Bordit Mbikëqyrës. Mbështetur në nenin 38 paragrafi 2 të Ligjit për Hekurudhat e Kosovës, Bordi i ARH-së i miraton të gjitha aktet nënligjore të institucionit. Menaxhmenti i ARH-së ka përgatitur disa draft Rregullore që ndërlidhem me punën profesionale të institucionit, të njëjtat nuk kanë hyrë në fuqi për shkak të mungesës së Bordit.

Për ARH-në miratimi dhe zbatimi i kornizës ligjore, e cila ka të bëjë me punën profesionale dhe përmbushjen e misionit të institucionit, pamundësohet në mungesë të Bordit.

ARH identifikon dhe raporton vështirësitë/normat ligjore për të cilat vlerëson se munde të ndikojnë në zbatimin e tyre në praktike. Kjo për faktin se pjesë të Ligjit të Hekurudhave kanë ndryshueshmëri **kompetencash/afatesh kohore** dhe **përgjegjësish** me Direktivat e BE-së për sektorin e hekurudhave në baze të të cilave vepron ARH.

Meqë ARH përballet me zbatimin e ligjit në baza ditore/javore/ dhe mujore propozon amandamentimin e Ligjit të Hekurudhave Nr. 04/L-063 në të paku këto pika të konkretizuara si me poshtë:

1. Nxjerrja e akteve nënligjore për departamentet profesionale (Licencim, Siguri, Interoperabilitet dhe Rregullim të Tregut Hekurudhor)
2. Amandamente në kapitullin që përfshinë pjesën e sigurisë, me konkretisht: Neni 20,111,143, për të cilat ARH vlerëson se duhen ri-përkufizime të cilat do të ishin në përputhshmëri me nenet relevante të Direktivës 2004/49/EC për Siguri hekurudhore. (shih më poshtë)

→ Ligji 04/L-063, Neni 20 Raporti vjetor

Organi Përgjegjës për Sigurinë Hekurudhore duhet të përpiloj raportin vjetor në lidhje me sigurinë të cilin ia paraqet ARH. Ky raport i dorëzohet ARH-së, deri në fund të janarit të vitit vijues.

Duhet të jetë:

- a. Organi Përgjegjës për Sigurinë Hekurudhore duhet të përpiloj raportin vjetor të punës të cilin ia paraqet ARH-së. Ky raport i dorëzohet ARH-së, deri në fund të janarit të vitit vijues.
- b. Secilin vit të gjithë menaxherët e infrastrukturës dhe ndërmarrjet hekurudhore duhet të paraqesin të autoriteti i sigurisë një raport vjetor të sigurisë para datës 30 Qershor, për vitin paraprak.
- c. Secilin vit autoriteti i sigurisë duhet të publikojë një raport vjetor të sigurisë lidhur me aktivitetet e tij për vitin paraprak dhe të dërgohet në Agjenci, më së largu deri me 30 Shtator.

{Direktiva 2004/49/EC, neni 18}

Secilin vit autoriteti i sigurisë duhet të publikojë një raport vjetor të sigurisë lidhur me aktivitetet e tij për vitin paraprak dhe të dërgohet në Agjenci, më së largu deri me 30 Shtator.

Direktiva 2004/49/EC, neni 9

Secilin vit të gjithë menaxherët e infrastrukturës dhe ndërmarrjet hekurudhore duhet të paraqesin të autoriteti i sigurisë një raport vjetor të sigurisë para datës 30 Qershor, për vitin paraprak.}

→ Neni 143, 04-L-063

Nuk është paraqitur raporti vjetor nga Autoriteti Nacional i Sigurisë deri më 30 qershor.

Duhet të jetë:

- a. Nuk është paraqitur raporti vjetor i menaxherit të infrastrukturës dhe operatorëve me trena tek Autoriteti Nacional i Sigurisë deri më 30 qershor (neni 20 paragrafi 1. i këtij ligji).
- b. Nuk është paraqitur raporti vjetor i sigurisë nga Autoriteti Nacional i Sigurisë deri më 30 Shtator (Directive 2004/49/EC, Article 18).

→ Ligji 04/L-063, Neni 111

Pas marrjes së autorizimit për futje në shërbim të nënsistemeve strukturore, menaxheri i infrastrukturës duhet të jete në gjendje të aplikojë për autorizim të tije të sigurisë.

Pas marrjes së autorizimit për futjen e mjeteve të transportit në shërbim, ndërmarrjet hekurudhore do të duheshin të jene në gjendje të aplikojnë për certificate të sigurisë.

Duhet të jetë:

- a. Pas marrjes së autorizimit të sigurisë, menaxheri i infrastrukturës duhet të jetë në gjendje të aplikojë për autorizim për futje në shërbim të nënsistemeve strukturore.
- b. Pas marrjes së certifikatës së sigurisë, ndërmarrjet hekurudhore do të duhet të jenë në gjendje të aplikojnë për autorizim të futjes në shërbim të mjeteve të transportit.

3. Amandamentim në kapitullin e Licencimit, Neni 22 paragrafi 1, për të cilin gjithashtu ARH vlerëson se duhet ri-përkufizim në përputhje me Direktivën e BE-së 2007/59 Neni 3 (a) rreth përcaktimit të Departamentit përgjegjës dhe kompetent për këtë aktivitet.

- Neni 22 paragrafi 1. Ky nen duhet të ndryshohet në pikën që parasheh përgjegjësin e licencimit të makinistëve. Bazuar në Direktivën e BE-së 2007/59 Neni 3 (a) kjo detyrë dhe përgjegjësi duhet të jetë me Departamentin e Sigurisë. Një konstatim dhe nevojë të tillë e mbështet edhe rekomandimit i ekspertëve Evropian që kanë qenë të angazhuar në ARH, përmes programeve të TAIEX-it.

Në këtë mënyrë Autoriteti do të kishte pavarësinë e plotë në ushtrimin dhe përmbushjen e kompetencave të veta ligjore si dhe Ligji i Hekurudhave do të për afrohej me legjislacionin e Bashkimit Evropian

Megjithëse jo i gjithë Ligji për hekurudha është implementuar deri në këtë periudhë kur edhe po raportohet, gjë që pamundëson konkretizimin e të gjitha vështirësive. Ndoshta në të ardhmen kur do ta rrugëtojmë në tersi këtë Ligj do të paraqiten vështirësi apo paqartësi për të cilat do të nevojiten apo kërkohen ndryshime/amandamente ligjore.

ARH raporton se deri në këtë periudhë nuk ka pasur ndonjë ndryshim në legjislacion të hekurudhave, e cila do të kishte ndikuar në rritjen apo zvogëlimin e efikasitetit të institucionit të ARH-së.

3. Përshkrimi i institucionit

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave është themeluar në bazë të Ligjit Nr. 03/L-076 dhe ka filluar të funksionoj nga prilli i vitit 2010, ndërsa tani ARH funksionon sipas Ligjit Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Republikës së Kosovës. ARH -ja është organ i pavarur që rregullon dhe mbikëqyrë sektorin e hekurudhave në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë dhe me legjislacionin në fuqi të BE-së, të përshtatshëm për Kosovën në këtë sektor. Ky Ligj zbatohet për funksionimin, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e Hekurudhave të Kosovës dhe infrastrukturës së saj, si dhe për të gjitha operimet e trenave që shfrytëzojnë këtë infrastrukturë.

SHTOJCË II Përshkrimi i hekurudhave të Kosovës

3.1. Misioni/Vizioni

MISIONI

Misioni i ARH-së është rregullimi, mbikëqyrja dhe organizimi i sektorit hekurudhor në Republikën e Kosovës në këto fusha: Licencim, Siguri, Interoperabilitet dhe Rregullim të Tregut dhe kompetencave të tjera të cilat i jepen në bazë të këtij ligji.

VIZIONI

Vizioni i ARH-së është që të ofroj shërbime cilësore dhe të sigurta transparente dhe jo diskriminuese për Ndërmarrjet Hekurudhore dhe Menaxherin e Infrastrukturës në sektorin hekurudhor në Republikën e Kosovës.



3.2. Kompetencat e ARH sipas Ligjit

Sipas Ligjit për Hekurudha, Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave rregullon dhe mbikëqyrë këto fusha:

- Licencimin
- Sigurinë
- Interoperabilitetin dhe
- Rregullimin e Tregut

4. Fushëveprimi që mbulon ARH

4.1. Struktura organizative e ARH-së


Më 12 nëntor 2013 ARH ka nxjerr Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e brendshëm dhe sistemimin e vendeve të punës.

Struktura organizative e ARH-së përbëhet nga:

- a) Bordi Mbikëqyrës
- b) Drejtori i Përgjithshëm
- c) Departamenti i Ligjor/Licencim
- d) Departamenti i Sigurisë
- e) Departamenti i Interoperabilitetit
- f) Departamenti i Rregullimit Tregut
- g) Departamenti i Administratës
- h) Departamenti i Financave
- i) Divizioni i Prokurimit

Në vazhdim është paraqitur skema organizative e ARH-së, në përputhje me Rregulloren e brendshme.

Skema organizative e ARH-së



4.1.1. Bordi mbikëqyrës i ARH-së

Veprimtaria e ARH-së mbikëqyret nga Bordi mbikëqyrës i cili është Bord jo ekzekutiv. Bordi ARH-së përbëhet prej pesë (5) anëtarëve dhe njëri prej tyre zgjidhet kryesues, anëtari i pestë i Bordit është Drejtori i Përgjithshëm i ARH-së.

Bordi vepron me orar jo të plotë, takimet e Bordit do të drejtohen në pajtim me procedurat e brendshme të miratuara nga Bordi dhe së paku një (1) herë në çdo muaj. Mbledhjet e Bordit nuk mund të zhvillohen nëse nuk janë të pranishëm tre (3) prej anëtarëve të tij, përfshirë Drejtorin e Përgjithshëm që duhet të jetë gjithmonë i pranishëm në mbledhjet e Bordit.

Vendimet e Bordit merren me shumicën e votave. Çdo anëtar i Bordit ka një (1) votë për çdo zgjidhje dhe kur numri i votave në favor të zgjidhjes është i barabartë me numrin e votave kundër, vota e kryesuesit është vendimtare.

Drejtori i Përgjithshëm i ARH-së i dorëzon Bordit mbikëqyrës raportin gjithëpërfshirës të punës çdo muaj dhe raportin vjetor në fund të çdo viti kalendarik.

4.1.1.1. Mandati

Kuvendi i emëron katër (4) anëtarë, njëri prej të cilëve emërohet kryesuesi i Bordit të cilët propozohen nga Qeveria me rekomandim të Ministrisë. Çdo anëtar i Bordit emërohet për një mandat pesë vjeçar (5), i cili mund të emërohen më se shumti edhe për një (1) mandat. Me 31.03.2014 Bordit Mbikëqyrës ju ka skaduar mandati, prandaj prej 01/04/2014 ARH-ja është pa Bord mbikëqyrës.

4.1.1.2. Kompetencat

Bordi mbikëqyrës nuk ka kompetenca ekzekutive, por është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe shqyrtimin e aktiviteteve dhe vendimeve të ARH-së mbi çështjet administrative, ekzekutive, rregullatore dhe të licencimit dhe aspekteve të menaxhimit financiar, të hyrave dhe shpenzimeve të ARH-së.

4.1.1.3. Funksionalizimi

Për shkak të skadimit të mandatit, Bordi mbikëqyrës i ARH-së nuk është funksional që nga muaji prill i vitit 2014.

4.1.2. Ekzekutivi

ARH, ka Drejtorin e përgjithshëm i cili është Kryeshef Ekzekutiv i Autoritetit dhe si organi më i lartë i drejtimit ekzekutiv dhe administrativ. Ai ushtron detyrat dhe funksionet të përcaktuara nga Ligji i Hekurudhave dhe në përputhje me ligjet tjera në fuqi, të cilat rregullojnë veprimtarinë e institucioneve publike, përfshirë këtu menaxhimin dhe raportimin e rregullt financiar të Bordi Mbikëqyrës dhe në Kuvendin e Republikës së Kosovës lidhur me përputhshmërinë e ARH-së me politikat e autoritetit si dhe të gjitha ligjet dhe standardet e zbatueshme në Republikën e Kosovës.

4.1.2.1. Drejtori i Përgjithshëm i ARH-së

Drejtori i Përgjithshëm është zyrtar i ARH-së cili është përgjegjës për menaxhimin dhe drejtimin e punëve të përditshme dhe vendimmarrjen e ARH-së, në pajtim me politikat dhe udhëzimet e nxjerra nga ARH.

Drejtori i Përgjithshëm zgjidhet nga Bordi Mbikëqyrës në përputhje me legjislacionin në fuqi për shërbimin civil. Ai që nuk ka të drejtë të shërbejë në Bord nuk do të ketë të drejtë të emërohet as Drejtor i Përgjithshëm.

4.1.2.2. Menaxhmenti i mesëm

Menaxhmenti i mesëm i ARH-së, përbëhet nga Kryesuesit e Departamenteve dhe menaxherët e zyrave, të cilët janë përgjegjës për veprimtarinë e tyre brenda fushëveprimit dhe kompetencave të tyre të përshkruara në përshkrimet e punës. Drejtori i Përgjithshëm i ngarkon strukturat udhëheqëse me kompetenca të përshkruara sipas rregullores së brendshme, Drejtori i Përgjithshëm mund t'ia delegojë kompetencat e tij apo kompetencat e ARH-së një strukture apo punonjësi jashtë fushëveprimit të detyrave të kësaj strukture, nëse ai e sheh të nevojshme. Zyrtaret që përbëjnë strukturën të ARH-së mbajnë Akte Emërimi me kohë të pacaktuar, ndërsa lloji i emërimit është i karrierës.

4.1.2.3. Burimet njerëzore

4.1.2.3.1. Numri i punëtorëve dhe nevojat për punëtorë të rinj

ARH-ja ka 17 punëtorë shërbyes civil të gjithë me Akte Emërimi të karrierës. Për shkak të mungesës të pozitës si zyrtar i teknologjisë informative, po mbulohet përkohësisht nga Drejtori i Përgjithshëm. ARH nuk ka nevojë për punëtorë të rinj.



Fig.1 Stafi i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave

4.2. Sistemi për menaxhim të cilësisë

4.2.1. Të përgjithshme

Gjatë vitit 2015, ARH-ja ka përfunduar të gjitha veprimet e nevojshme për ngritjen e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë, sipas Standardit ISO 9001:2008. Veprimet kryesore në këtë drejtim kanë qenë hartimi i politikës së cilësisë, hartimi dhe miratimi i Manualit të Cilësisë, proceseve të brendshme të punës, procedurave të cilësisë për të gjitha departamentet si dhe mbajtja e auditimit të brendshëm për kontrollë të cilësisë në ARH. Në kuadër të ngritjes së Sistemit për Menaxhim të Cilësisë, ARH ka përpiluar politikën e cilësisë që i përshtatet institucionit dhe i përmbushë kërkesat e parashtruara në ISO 9001:2008. Kjo politike transmetohet kudo në organizatë. Strukturat udhëheqëse janë përgjegjëse për t'u siguruar se të gjithë punëtorët e kuptojnë këtë politikë. Për t'u siguruar se politika jonë mbetet e përshtatshme ajo do të rishikohet më së paku një herë në vit më një nga mbledhjet tona të Rishikimit të Menaxhmentit

4.2.2. Politika e Cilësisë

Është politikë e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave të Republikës së Kosovës (ARH) që të krijojë, zbatojë dhe mirëmbajë një sistem për menaxhim të cilësisë brenda organizatës, përmes të cilit sigurohet realizimi i plotë i detyrave të ARH-së, me qëllim të garantimit të një ambienti të sigurt dhe konkurrues hekurudhor në Republikën e Kosovës. Për ne, shfrytëzuesit e shërbimeve tona janë shumë të rëndësishëm, prandaj ne përpiqemi që të ofrojmë shërbime sa më cilësore, duke matur kënaqshmërinë e tyre, duke përmirësuar vazhdimisht efektivitetin dhe efikasitetin e punës sonë, duke monitoruar performancën tonë kundrejt objektivave të vendosura dhe duke promovuar përfshirjen e punëtorëve në të gjitha proceset e punës.

Është obligim i menaxhmentit dhe i secilit zyrtar në ARH që gjatë gjithë kohës t'u përmbahen legjislacionit në fuqi dhe procedurave të dokumentuara të punës, të përshkruara në manualin e cilësisë dhe dokumentet tjera të ndërlidhura.

4.2.3. Manuali i cilësisë

Manuali i cilësisë është njëra ndër kërkesat kryesore të Standardit ISO 9001:2008. Qëllimi i këtij manuali është të vendosë dhe të theksojë politikat e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë në ARH. Këto politika definojnë angazhimet e menaxhmentit për menaxhimin e veprimeve dhe aktivitetëve në pajtueshmëri me ISO 9001:2008. Këto politika të nivelit më

të lartë, përfaqësojnë planet ose protokollet për të garantuar zbatimin e detyrimeve të përcaktuara me kornizën ligjore dhe rregullatore të aplikueshme, si dhe për të mundësuar pranimin e shërbimeve kualitative dhe kënaqshmërinë e klientëve. Sipas kërkesës, në manual është përshkruar mënyra se si në këtë autoritet janë rregulluar fusha të ndryshme të veprimtarisë, duke përfshirë edhe mënyrën e menaxhimit të organizatës, politikat e saj, si dhe kapacitetet dhe strukturën e saj organizative. Sistemi për Menaxhim të Cilësisë, i cili përshkruhet në këtë manual, është themeluar për të demonstruar kapacitetet tona për realizim të vazhdueshëm të detyrave në lëmin e sigurisë hekurudhore dhe mbikëqyrjes ekonomike në përmbushje të obligimeve tona si rregullator dhe për të vepruar me efikasitet dhe efektshmëri.

ARH-ja ka krijuar strukturë të tillë të dokumentacionit, ku secili departament në ARH ka krijuar një dokument, i cili përshkruan detajisht punët, proceset e punës, procedurat dhe të gjitha dokumentet tjera përcjellëse.

4.3. Trajnimet

Zyrtaret e ARH -së gjatë vitit 2015 kanë ndjekur trajnime dhe takime të financuara nga donatorët si dhe trajnime të financuara nga buxheti i ARH-së. ARH-ja investon në ngritjen profesionale dhe përditësimin e njohurive të specializuara të personelit të vet, në përputhje me standardet dhe praktikën e rekomanduara ndërkombëtare. Zyrtarët janë trajnuar kryesisht në qendrën trajnuese të Autoriteteve të Përbashkëta të Hekurudhave.

Konferencat, trajnimet, punëtoritë dhe vizitat studimore janë paraqitur në formë tabelore.

Tabela 1: Trajnimet jashtë vendit

Konferencat/ trajnimet/ punëtoritë dhe vizitat studimore	
1	Takim bilateral në mes ARH-së dhe Rregullatoreve të Sigurisë (FOT) dhe Rregullimit tregut (RACO) të Zvicrës.
2	International Congress on Advanced Railway Engineering, Stamboll, Turqi
3	IRG -Rail, Takim Plenare, Hagë, Holandë.
4	EurasiaRail 2015 5th International Rolling Stock, Infrastructure & Logistics Exhibition, Stamboll, Turqi
5	3rd UIC World Congress on Rail Training, Lisbon, Portugal.
6	SEETO working group railway and intermodality (regulatory and competition aspects, Podgoric, Mali i Zi.

7	SEETO working group railway and intermodality (regulatory and competition aspects, Podgoric, Mali i Zi.
8	UIC MERTCe “Carriage of Dangerous Goods The Legal Framework and Challenges for Employees’ Training, Eskisehir, Turqi.
9	Trajnim në UIC expertise development platform ERTMS/ETCS, Oslo, Norway
10	Takim ndërmjet ARH-së dhe Drejtorisë të Inspektimit Hekurudhor Republika e Shqipërisë dhe Institutin e Transportit të Shqipërisë.
11	Trajnim për Inspektim të Trenave dhe vagoneve të mallrave në Basel, Zvicër.
12	SEETO working group railway and intermodality (regulatory and competition aspects, Tirane, Shqipëri.
13	SEETO working group railway and intermodality (regulatory and competition aspects, Zagreb, Kroaci.
14	IRG -Rail, Takim Plenare, Rotterdam, Holandë.
15	Immorail 2015 Railway Infrastructure and Innovation in Europe, Budapest, Hungary.
16	IRG -Rail, Grupi Punues për Monitorimin e Tregut Hekurudhor, Riga, Lituani.

4.4.Asetet

ARH-ja ka ne përdorim 286 asete me vlere në blerje prej 106.572.95 €. Këto asete janë kryesisht automjete, orendi zyrash dhe pajisje teknologjike. Zhvlerësimi dhe vlerësimi i aseteve bëhet çdo fund vit sipas dispozitave të Rregullores MF-Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore dhe sipas Udhëzimit Nr. 01/2012 për Menaxhimin e Pasurisë së ARH-së. Sipas raportit të komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit vlera e aseteve në ARH për vitin 2015 sipas rregullave të parapara me rregulloren e lartcekur më larte është 74.610.72 €.

4.4.1. Lokacioni i ARH

Zyra e ARH-së është në Prishtinë në Rr. “Rrustem Statovci”. nr. 29. Hapësira fizike e institucionit të ARH-së është 250 m². ARH-ja në vazhdimësi bënë kërkesë në Ministrinë e Administratës Publike për t’iu siguruar një objekt qeveritar, meqë objekti i tanishëm është pronë private dhe paguhet me qira nga ARH-ja.

5. Aktivitetet për periudhën raportuese

5.1. DEPARTAMENTI I LICENCIMIT

5.1.1. Detyrat dhe përgjegjësitë

Bazuar në Ligjin për Hekurudhat e Kosovës Nr. 04/L-063 Departamenti i Licencimit është përgjegjës për:

- Licencimin e Menaxherëve të Infrastrukturës
- Licencimin e Ndërmarrjeve Hekurudhore
- Licencimin e Makinistëve, dhe
- Amandamentimin, Suspendimin dhe Revokimin e Licencave të lëshuara.

5.1.2. Aktivitetet e Departamentit të Licencimit

Gjatë vitit 2015 Departamenti i Licencimit pranë Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, duke u bazuar në Ligjin e Hekurudhave, akteve nënligjore si dhe planin vjetor të punës, ka pas disa prioritete. Këto prioritete kanë qenë: licencimi i makinistëve, monitorimin e Licencave të lëshuara për Menaxherin e Infrastrukturës INFRAKOS dhe Ndërmarrjen Hekurudhore TRAINKOS si dhe inspektimi dhe monitorimi i makinistëve të licencuar nga ARH-ja.

Departamenti i Licencimit për t'i përmbushur këto objekte, ka punuar një agjendë konkrete për realizimin tyre gjatë vitit 2015.

5.1.2.1. Licencimi i Makinistëve

Departamenti i Licencimit për t'i përmbushur këto objektiva ka punuar një agjendë konkrete për realizimin tyre gjatë vitit 2015. Pas hartimit të Rregullores për Licencimin e Makinistëve, në harmoni të plotë me Direktivën e BE-së 2007/59 dhe Rregulloren e BE-së 2010/36, në mënyrë që kjo Rregullore së bashku me Ligjin e Hekurudhave të gjejnë zbatim, janë përfunduar edhe obligimet tjera për realizimin e këtij obligimi ligjor, siç janë: përgatitja e formës së licencës për makinistë konformë kërkesave ligjore

në fuqi në Kosovë dhe BE, publikimi i dokumenteve të nevojshme dhe procedurave të aplikimit në ueb faqen e ARH-së dhe bashkëpunimi me palët e interesit Trainkos në këtë proces.

Tabela 2: Aplikacionet e makinistëve

Licenca të Makinistëve	Aplikacionet	Lëshuara	Refuzuara	Revokuara	Viti
TRAINKOS SH.A.	28	23	5	1	2015

Fig. 2 Forma e Licencës së makinistit

Departamenti i Licencimit ka vazhduar punën dhe hapat konkret në zbatimin e kësaj kornize rregullative ligjore, në mënyrë që sektori hekurudhore në Republikën e Kosovës të jetë i rregulluar konformë dispozitave ligjore në fuqi në Kosovë dhe atë të BE-së, kur janë të përshtatshme për këtë sektor.

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave me datë 29/01/2015 nga Trainkos-i ka pranuar 27 aplikacione me kërkesë për licencim të makinistëve. Pas shqyrtimit fillestar, ARH me datë 18/02/2015 ka kërkuar nga Trainkos dokumentacion plotësues. Si rezultat i kësaj kërkesë dhe pas disa takimeve konsultative dhe sqaruese mes palëve, Trainkos-i ka sjellë në ARH dokumentacionin plotësues të kërkuar, me datë 17/03/2015. Shqyrtimi i aplikacioneve nga ana e ARH-së është bërë konform procedurave dhe kërkesave ligjore në fuqi, të parapara me Ligjin për Hekurudhat e Kosovës si dhe Rregullores për Licencimin e Makinistëve Nr .02/2013.

ARH gjatë shqyrtimit të aplikacioneve është fokusuar në kushtet të cilat Ligji dhe Rregullorja i obligon që një makinist t'i përmbushë në mënyrë që të marrë licencë. Këto kushte kanë qenë: Certifikata e Makinistit e lëshuar nga ndërmarrja hekurudhore, ekzaminimi mjekësor konformë kërkesave të parapara në Ligj dhe Rregullore (veçanërisht Aneksi II i rregullores) si dhe kualifikimi shkollor. Në bazë të dokumentacionit të afruar, 22 makinist nga 27 sa kishin aplikuar i kanë plotësuar kriteret bazike për marrjen e licencës për makinistë. Përkundër faktit se Trainkos ka sjellë dokumentacion shtesë për shumicën e makinistëve për të cilët kanë aplikuar për licencim, për pesë (5) aplikant nuk janë sjellë dëshmi dhe dokumentacioni i kërkuar nga Ligji dhe Rregullorja për të marrë licencë. Për katër aplikant, arsyeja kryesore pse nuk i kanë plotësuar kushtet e parapara ligjore për të marrë licencë të makinistit është fakti se në raportet e mjekut të lëshuar nga Instituti i Mjekësisë së Punës në Kastriot (Obiliq), konkludohet sa nuk janë të aftë për profesionin e makinistit.

Plotësimi i kushtit i cili ka të bëjë me kërkesat mjekësore, neni 95.1.1 i Ligjit si dhe neni 8 dhe shtojca II e Rregullores, është esencial në vlerësimin se një kandidat nëse i plotëson kushtet e parapara me Ligj dhe Rregullore për të marrë licencën e makinistit. Dhe nëse ky kriter vihet në pikëpyetje nga ana e mjekut ose institucionit shëndetësor, atëherë në bazë të dispozitave ligjore në fuqi, ARH është e obliguar që të refuzojë kërkesën për licencë të makinistit. Në bazë të dokumentacionit të afruar nga Trainkos në ARH, katër makinistët e parë nuk e kanë përmbushur njërin nga kushtet kryesore ligjore për marrjen e licencës, siç është kushti mjekësor dhe për këtë arsye, ju refuzohet kërkesa për marrjen e licencës së makinistit.

Ndërsa, për njërin nga aplikantët për licencë të makinistit, arsyeja e refuzimit të licencës së makinistit është se, përkundër faktit se ARH ka kërkuar dokumentacion shtesë pas pranimit të aplikacioneve për makinistë, Trainkos nuk ka sjellë në ARH dëshmi për shkollën e mesme konform nenin 96. 3.1 të Ligjit dhe 8.3.1 të Rregullores për aplikantin në fjalë. Si rezultat i kësaj, i është refuzuar kërkesa për licencë të makinistit.



Më datë: 20/03/2015 Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave ka licencuar njëzetedy (22) makinistë.

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave me datë 13.10.2015 nga Trainkos-i ka pranuar aplikacion me kërkesë për licencimin e një makinisti. Shqyrtimi i aplikacionit nga ana e ARH-së është bërë konform procedurave dhe kërkesave ligjore në fuqi, të parapara me Ligjin për Hekurudhat e Kosovës si dhe Rregullores për Licencimin e Makinistëve Nr .02/2013. ARH gjatë shqyrtimit të aplikacioneve është fokusuar në kushtet të cilat Ligji dhe Rregullorja i obligon që një makinist t'i përmbushë në mënyrë që të marrë licencë.

Këto kushte kanë qenë: Certifikata e Makinistit e lëshuar nga ndërmarrja hekurudhore, ekzaminimi mjekësor konformë kërkesave të parapara në Ligj dhe Rregullorja Nr. 02/2013 për Licencimin e Makinistëve si dhe kualifikimi shkollor. Në bazë të dokumentacionit të afruar nga Trainkos, makinisti i lartpërmendur i ka plotësuar kriteret bazike për marrjen e licencës për makinistë.

5.1.2.2.Njohja e licencës së Railtrans-it

Në mbështetje të Ligjit për Hekurudhat e Kosovës Nr. 04/L-063, Nenet 10 paragrafi 1, 22 paragrafi 1, neni 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative, Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative Nr. A.nr.506/2014, të datës 08.06.2015, si dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative Nr. AA.nr.216/2015, të datës 12/11/2015, ARH merr vendim të njoh si valide licencën për transport hekurudhor të mallrave për ndërmarrjen RAILTRANS, të lëshuar me datë 10/03/2014 nga ARH. Railtrans me datë 19/12/2013 ka aplikuar për licencim në ARH. Pas shqyrtimit të aplikacionit, me datë 10/03/2014, brenda afatit të paraparë ligjor, ARH ka lëshuar licencë për transport hekurudhor të mallrave për ndërmarrjen RAILTRANS.

Më datë 19/03/2015 Trainkos ka parashtruar Ankesë në ARH, e cila ju ka drejtuar Bordit Mbikëqyrës të ARH-së, me pretendimet se kompania Railtrans nuk i plotëson kushtet e kërkuar për këtë licencë, siç janë: reputacioni i mirë, përshtatshmëria financiare, kompetenca profesionale dhe e sigurisë. Me datë 20/03/2015 Bordi i ARH-së ka shqyrtuar këtë Ankesë, ku kishte konstatuar se Railtrans në momentin e aplikimit kishte fshehur fakte që kanë të bëjë me reputacionin e mirë të kompanisë si njëri nga kushtet e licencimit. Gjithashtu, Bordi kishte rekomanduar Departamentit Ligjor/Licencim marrjen e një vendimi të ri lidhur me licencën e Railtransit. Departamenti në fjalë pas pranimit të fakteve të cilat kishin të bënin me reputacionin jo të mirë dhe kompetencën profesionale si dhe rekomandimit të Bordit, kishte përgatitur vendimin Nr. 02/2014 të datës 31/03/2014 për revokim të licencës. Në të gjitha procedurat dhe procesin e revokimit ka qenë në dijeni edhe Bordi, para se vendimi për revokimin e licencës të nënshkruhet.

Kundër vendimit për revokim të licencës Nr. 02/2014 të datë 31/03/2014, Railtrans kishte ushtruar padi në Gjykatën Themelore të Prishtinës-Departamenti për Çështje Administrative. ARH duke marrë parasysh padinë e ngritur nga Railtrans me shkresë të datës 02/12/2014 nga Gjykata Themelore e Republikës së Kosovës, Departamenti për Çështje Administrative, bazuar në nenin 37 të Ligjit për Konfliktet Administrative, lidhur me nenin 99 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka paraqitur përgjigje në padi me datë 24/12/2014, ku i kishte propozuar Gjykatës hedhjen poshtë në tërësi të padisë si të pa bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i ARH për revokim të licencës, i datës

31/03/2014. Pas shqyrtimit të çështjes, kjo Gjykatë me Aktgjykimin e datës 08.06.2015 nr. A.nr.506/2014, kishte anuluar Vendimin e ARH-së për revokim të licencës të datës 31/03/2014 dhe kishte kthyer çështjen në rishqyrtim dhe rivendosje tek ARH. Me datë 15/07/2015 ARH ka ushtruar Ankesë pranë Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative kundër aktgjykimit të datës 08/06/2015, me pretendimin se ky Aktgjykim ka: shkelje thelbësore të procedurës administrative, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, vërtetim të gabuar të së drejtës materiale. Me datë 04/12/2015 ARH ka pranuar Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit me nr. AA.nr.216/2015, të datës 12/11/2015, me anë të cilit konfirmohet Aktgjykimi i shkallës së parë i datës 08/06/2015 dhe obligon ARH-në që në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh të nxjerr vendim të ri lidhur me këtë çështje.

Bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe Aktgjykimin e shkallës së parë nr. A.nr.506/2014, të datës 08/06/2015, në lidhje me Aktgjykimin e apelit të shkallës së dytë AA.nr.216/2015, të datës 12/11/2015, të cilët kërkojnë që çështja të rivendoset në afat prej 30 ditësh dhe se gjatë rivendosjes, ARH të ketë parasysh vërejtjet e Gjykatës, kur të vendosë lidhur me këtë çështje dhe të mënjanojë të metat e caktuara të cilat kanë qenë në vendimin për revokimin e licencës dhe duke u bazuar në të dhënat e cekura më lartë, ARH në kuptimin e nenit 65 të ligjit për konfliktet administrative, Aktgjykimin e shkallës së parë dhe atë të apelit, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

5.1.2.3.Regjistri i Licencave

Ligji për Hekurudhat e Kosovës, neni 10.3, 23.4 dhe 92.23 e obligon Departamentin e Licencimit, që të krijoj dhe azhurnoj regjistrin e ndërmarrjeve hekurudhore dhe menaxherëve të infrastrukturës të licencuar në Republikën e Kosovës, dhe që ky regjistër të jetë i publikuar në ueb faqen e ARH-së. Departamenti i Licencimit ka krijuar dhe azhurnuar regjistrin e ndërmarrjeve hekurudhore dhe menaxherëve të infrastrukturës të licencuara në Republikën e Kosovës. Në këtë mënyrë, është respektuar ligji për hekurudhat e Kosovës, dhe gjithashtu çdo person fizik apo juridik i cili ka nevojë dhe interes të ketë informacione për sektorin hekurudhore në Kosovë, një gjë të tillë mund ta bëjë në mënyrë shumë të lehtë dhe praktike në ueb faqe të ARH-së. Po ashtu, Departamenti i Licencimit ka bërë kujdes të shtuar gjatë krijimit të regjistrit në fjalë. Fillimisht ky regjistër nuk përmban të dhëna konfidenciale të subjekteve të licencuara, të cilat mund të keqpërdoren nga rivalët biznesor dhe është konform standardeve ndërkombëtare të përdorura për llojin e këtyre regjistrave.

Tabela 3: Regjistri i Licencave

Nr	Emri dhe adresa e kompanive	Nr. i Licencës	Data e dhënies së Licencës	Llojet e shërbimeve	Territori	Afati i Licencës	Vërejtje
1	TRAINKOS sh. a. Sheshi i Lirisë p. n 12 000 Fushë Kosovë	KS 01/2012 0001	15.11.2012	Operimi me Trena	Republika e Kosovës	15.11.2012	
2	IINFRAKOS sh. a. Sheshi i Lirisë p. n 12 000 Fushë Kosovë	KS 02/2012 0001	15.11.2012	Menaxher i Infrastrukturës	Republika e Kosovës	15.11.2012	
3	Railtrans LLC Dardania BL9 LB4 p.n 10 000 Prishtinë	KS 01/2014 0001	10.03.2014	Operimi me Trena për Transport Hekurudhor të Mallrave	Republika e Kosovës	11.12.2015	

5.1.2.4. Monitorimi i Licencave

Është detyrë e Departamentit të Licencimit që të rishikoj validitetin e licencave të lëshuara në baza të rregullta së paku në çdo pesë (5) vite, duke u siguruar kështu se ndërmarrjet hekurudhore dhe menaxherët e infrastrukturës të licencuara i plotësojnë obligimet e përcaktuara me ligjin për hekurudhat e Kosovës. Departamenti i Licencimit gjatë vitit 2015 ka monitoruar licencat e lëshuara, në harmoni me dispozitat ligjore në fuqi. Kryesisht monitorimi i licencave për vitin 2015 ngjashëm sikurse vitet paraprake është fokusuar në sigurimin adekuat ndaj palëve të treta të subjekteve të licencuara. Në këtë mënyrë, ne kemi kërkuar nga Trainkos dhe Infrakos që policat e tyre të siguri të ripërtërihet, sepse ato janë me afat një (1) vjeçarë. Kjo kërkesë e ARH dhe njëkohësisht obligim ligjor është përmbushur nga ana e Infrakos-it dhe Trainkos-it. Ne këtë mënyrë Departamenti i Licencimit është i përkushtuar që ligji për hekurudhat e Kosovës të zbatohet me përpikëri dhe në raste të ndonjë aksidenti, ndërmarrja hekurudhore dhe menaxheri i infrastrukturës të jenë të mbuluara me siguri adekuat.

5.1.2.5. Inspektimi i Makinistëve gjatë vitit 2015

Në mbështetje të Ligjit për Hekurudhat e Kosovës Nr. 04/L-063, Departamenti Ligjor/Licencim, gjatë vitit 2015 ka inspektuar dhe verifikuar makinistët të cilët kanë drejtuar trenin e linjës Prishtinë-Pejë dhe Prishtinë-Hani Elezit.

Me datë 29/05/2015 është inspektuar linja Prishtinë-Pejë. Qëllimi i këtij inspektimi ka qenë monitorimi dhe verifikimi i makinistit që drejton trenin e linjës Prishtinë-Pejë, se a janë duke u drejtuar trenat nga makinistë të licencuar nga ARH me datë 20.03.2015, dhe se a kanë në pronësi makinistët dokumentet e lëshuara (licencën) sipas ligjit të hekurudhave.

Gjatë inspektimit ka rezultuar se treni i linjës Prishtinë-Pejë, me datë 29/05/2015 ka qenë duke u drejtuar nga makinisti i licencuar nga ARH, me Nr. Licence LM-17-2015. Po ashtu, nga ky inspektim ka rezultuar se makinisti në fjalë ka pasur me veti licencën të cilën e ka prezantuar para zyrtarëve të ARH-së.

Gjithashtu, me datë 22/09/2015 si ARH kemi kryer inspektim dhe monitorim të makinistëve në linjën hekurudhore Prishtinë-Hani Elezit. Gjatë inspektimit kemi parë se trenat kanë qenë duke u drejtuar nga makinistë të licencuar nga ARH, ashtu siç e kërkon edhe ligji i hekurudhave dhe aktet nënligjore në fuqi. Konkretisht njëri tren ka qenë duke u drejtuar nga makinisti me Nr. të licencës LIC 04-2015 i licencuar nga ARH me datë 20/03/2015. Ndërsa makinisti tjetër ka qenë makinisti me Nr. të licencës LM 21-2015 po ashtu i licencuar nga ARH. Gjatë inspektimit dhe monitorimi është vërejtur se makinistët kanë pasur me vete licencat përkatëse edhe në këtë rast.

5.2. DEPARTAMENTI LIGJOR

5.2.1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit Ligjore

Detyrat dhe përgjegjësitë themelore të Departamentit Ligjor janë:

- Mbështetja e të gjitha departamenteve të ARH-së në çështjet ligjore,
- Verifikimi i dokumenteve ligjore të lëshuara nga ARH-ja,
- Pjesëmarrje në grupe të ndryshme punuese për hartim të legjislacionit primar dhe sekondar në sektorin e transportit hekurudhor,
- Hartimi i akteve nënligjore në kuadër të ARH duke marrë parasysh legjislacionin e BE-së në fushën përkatëse, atëherë kur është e nevojshme dhe e mundur,
- Përfaqësimin e ARH-së në konteste gjyqësore, etj.

5.2.2. Aktivitetet e Departamentit Ligjor

Departamenti Ligjor për vitin 2015 ka përgatitur draft Rregulloren për të Hyrat e ARH-së, akt nënligjor ky i obligueshëm të përgatitet nga Ligji i Hekurudhave, si dhe angazhime tjera në nxjerrjen e akteve nënligjore nga ARH-ja, siç ka qenë draft Rregullorja për të Drejtat e Udhëtarëve në Transportin Hekurudhor. Një angazhim tjetër me rëndësi për Departamentin Ligjor gjatë viti 2015 ka qenë përfaqësimi i Autoritetit në Gjykatë lidhur me kontestet administrative që ARH ka pasuar.

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2015 ka përcjell me kujdes zbatimin e akteve nënligjore të mëposhtme, që ARH ka nxjerr gjatë vitit 2012, 2013 dhe 2014:

Departamenti Ligjorë do të vazhdojë përkushtimin maksimal që të sigurojë ligjshmërinë në zbatimin e gjitha akteve nënligjore të nxjerra nga ARH-ja, në mënyrë që sektori hekurudhor në Republikën e Kosovës të rregullohet dhe mbikëqyret konformë praktikave më të mira rajonale dhe ato të Bashkimit Evropian.

5.3. DEPARTAMENTI I SIGURISË

Bazuar në Ligjin për Hekurudhat e Kosovës Nr. 04/L-063 neni 20, Organi përgjegjës për sigurinë hekurudhore, respektivisht Departamenti i Sigurisë në kuadër të ARH-së, përpilon një raport vjetor në lidhje me sigurinë, ku përshkruhen të arriturat kryesore gjatë vitit paraparak.

5.3.1. Detyrat dhe përgjegjësitë

Sipas Ligjit për Hekurudha Nr. 04/L-06, Departamenti i Sigurisë është përgjegjës për:

- Autorizimin për futjen në shërbim të nën sistemeve strukturale,
- Mbikëqyrja nëse përbërësit e interoperabilitetit të nënsistemeve hekurudhore janë në përputhje me kërkesat esenciale të kërkuara nga direktivat për Interoperabilitet,
- Autorizimin e futjes në shërbim të mjeteve të reja lëvizëse,
- Lëshimin, përtëritjen, amendamentimin dhe revokimin e Certifikatave/Autorizimeve të Sigurisë,
- Monitorimi, promovimi, zbatimi dhe kur është e duhur bërja e propozimeve për të zhvilluar raporte të afërta pune me Ministrinë dhe pjesëmarrësit e tjerë të tregut,
- Mbikëqyrja se a janë të regjistruara mjetet lëvizëse dhe nëse informacioni që ka të bëjë me sigurinë në regjistrin nacional është i azhurnuar,
- Mbikëqyrja se a mbahet dhe azhurnohet rregullisht regjistri i pronarëve të mjeteve transportuese hekurudhore,
- Mbikëqyrja se a mbahet dhe azhurnohet rregullisht regjistri i infrastrukturës

5.3.2. Aktivitetet e Departamentit të Sigurisë

Gjatë vitit 2015 të arriturat kryesore të departamentit të sigurisë janë:

- Mbikëqyrja e implementimit të Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë (SMS) nga ana e Operatorit me Trena Trainkos datë: 12-15/05/2015.

- Mbikëqyrja e implementimit të Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë (SMS) nga ana e Menaxherit të Infrastrukturës Infrakos me datë: 18-22 /05/2015.
- Përgatitja e raportit vjetor të sigurisë të departamentit të sigurisë për vitin 2014, pas pranimit të raportit vjetor të sigurisë nga Infrakos dhe Trainkos,
- Autorizimi për futjen në shërbim
- Inspektimi i mjeteve lëvizëse
- Inspektimin e linjave hekurudhore të cilat janë në shfrytëzim,
- Inspektimin e linjave hekurudhore të cilat nuk janë në shfrytëzim,
- Inspektimin e të gjitha mjeteve lëvizëse të cilat janë të regjistruara në regjistrin nacional të mjeteve lëvizëse e që janë në pronësi të Trainkos,
- Përgatitjen e raportit me rekomandime të sigurisë për linjat e inspektuara,
- Përgatitjen e raportit me rekomandime të sigurisë për mjetet lëvizëse të inspektuara.

5.3.2.1. Mbikëqyrja e implementimit të Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë

Bazuar në ligjin Nr. 04/L-063, neni 94 paragrafi 3, neni 100 paragrafët 1,2,3,4 dhe neni 103 për hekurudhat në Republikën e Kosovës, Rregullores së ARH-së Nr. 03/2013 Metodat e Përgjithshme e Sigurisë për Mbikëqyrje nga Organi Përgjegjës i Sigurisë pas lëshimit të një Certificate apo Autorizimi të Sigurisë, Direktivës së sigurisë 2004/49/EC nenet 4, 9 dhe aneksi III, Departamenti i Sigurisë ka filluar procesin e mbikëqyrjes së implementimit të Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë (SMS) nga ana e Operatorit me Trena Trainkos datë: 12-15/05/2015.

Bazuar në Ligjin Nr. 04/L-063, neni 100 paragrafët 1,2,3,4 neni 103 dhe 104 paragrafi 2 për hekurudhat në Republikën e Kosovës, Rregullores së ARH-së Nr. 03/2013 Metodat e Përgjithshme e Sigurisë për Mbikëqyrje nga Organi Përgjegjës i Sigurisë pas lëshimit të një Certificate apo Autorizimi të Sigurisë, Direktivës së sigurisë 2004/49/EC nenet 4, 9 dhe aneksi III, Departamenti i Sigurisë ka filluar procesin e mbikëqyrjes së implementimit të SMS nga ana e Menaxherit të Infrastrukturës Infrakos me datë: 18-22/05/2015.

Qëllimi i këtij procesi të mbikëqyrjes së implementimit të SMS ka qenë që të sigurohemi se Trainkos dhe Infrakos e kanë vendosur Sistemin për Menaxhimin e Sigurisë dhe se ky sistem plotëson kërkesat e sigurisë dhe përmban elementet të cilat kanë të bëjnë me sigurinë e sistemit hekurudhor në Kosovë.

Ne gjatë mbikëqyrjes së implementimit të SMS kemi mbajtur takime me të gjithë personat përgjegjës nga departamentet përgjegjëse për mirëmbajtjen e sigurisë hekurudhore siç janë:

- Zyra e Auditimit të Brendshëm,
- Kontrollor i Brendshëm,
- Zyra për Standarde dhe Siguri (Zyrtari për Siguri),
- Sektori për Shkollim dhe Mbrojtje në Punë,
- Departamenti i Komunikacionit-Infrakos,
- Departamenti i Mirëmbajtjes së Linjave Hekurudhore-Infrakos,
- Departamenti i Elektroteknikës-Infrakos,
- Udhëheqësin e zyrës për Kontroll / Siguri dhe Kualitet-Trainkos,
- Zyrtarin e SMS-it-Trainkos,
- Drejtorin e Operimeve-Trainkos,
- Menaxherin e Transportit të Udhëtarëve-Trainkos,
- Menaxherin e Transportit të Mallrave-Trainkos,
- Menaxherin për Çështje Ligjore dhe Resurset Njerëzore-Trainkos,
- Menaxherin e Mirëmbajtjes-Trainkos,
- Shefin e Tërheqjes së Mjeteve Lëvizëse në Transportin e Udhëtarëve-Trainkos,
- Shefin e Tërheqjes së trenave në transportin e Mallrave-Trainkos.

Pas përfundimit të këtij procesi kemi përgatitur nga një raport të veçantë për të dy kompanitë dhe këto raporte i kemi dërguar në Infrakos dhe Trainkos të cilat i janë bashkangjitur këtij raporti.

SHTOJCË III Raporti Mbikëqyrja e Implementimit të Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë (SMS) nga Infrakos.

SHTOJCË IV Raport Mbikëqyrja e Implementimit të Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë (SMS) nga Trainkos.

5.3.2.2. Autorizimet për vendosje në shërbim

ARH është përgjegjëse për dhënien e autorizimit për futjen në shërbim të mjetit hekurudhor me kontributin e organit përgjegjës për sigurinë i cili është përgjegjës për kontrollin e pajtueshmërisë teknike ndërmjet nënsistemeve të mjeteve të transportit dhe integritetit të sigurt të tyre, pajtueshmërinë teknike ndërmjet mjeteve të transportit dhe rrjetit dhe pajtueshmërinë teknike me rregullat tjera nacionale.

Bazuar në Ligjin Nr. 04/L-063, për Hekurudhat e Kosovës, neni 18, paragrafi 3.1, 3.2, dhe 3.3, neni 109 dhe 110:

Neni 18 paragrafët:

3.1 autorizimi për futjen në shërbim të nënsistemeve strukturale që e përbëjnë sistemin hekurudhor dhe të kontrollimit që ato kanë operuar dhe janë mirëmbajtur në përputhje me kërkesat esenciale;

3.2. mbikëqyrja nëse përbërësit e interoperabilitetit të nënsistemeve hekurudhore janë në përputhje me kërkesat esenciale të kërkuara nga direktivat për ndëroperim;

3.3. autorizimi i futjes në punë të mjeteve të reja lëvizëse apo i atyre të modifikuara substancialisht;

Neni 109: Për futjen në shërbim të secilit nënsistem të hekurudhave, menaxheri i infrastrukturës apo ndërmarrja hekurudhore duhet të marrin një autorizim nga organi përgjegjës mbi sigurinë.

Neni 110: Para se të përdoret në rrjet, mjeti i transportit duhet të autorizohet që të futet në shërbim.

Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës INFRAKOS Sh.A. me datë 28/04/2015 ka aplikuar në ARH për marrjen e Autorizimit për futjen në shërbim për pajisjen "ATLAS 1404ZW".

Departamenti i Sigurisë në bashkëpunim me Departamentin e Interoperabilitetit kanë punuar së bashku në këtë proces, pas analizimit të aplikacionit konform dispozitave ligjore në fuqi, ka ardhur deri tek vlerësimi se të gjitha kërkesat ligjore janë përmbushur, dhe në këtë mënyrë bënë lëshimin e Autorizimit për futjen në shërbim për pajisjen "ATLAS 1404ZW".



Fig. 3. ATLAS 1404ZW

Më datën: 28-04-2015, Infrakos ka aplikuar për marrjen e Autorizimit për futjen në shërbim për pajisjen "ATLAS 1404ZW"

Më datën: 14-08-2015, departamenti i sigurisë ka dhënë Autorizimin për futjen në shërbim për pajisjen "ATLAS 1404ZW"

Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës INFRAKOS Sh.A. me datë 28.04.2015 ka aplikuar në ARH për marrjen e Autorizimit për futjen në shërbim për pajisjen "IVECO-DAILY, PALFINGER KRAN.

Departamenti i Sigurisë në bashkëpunim me Departamentin e Interoperabilitetit kanë punuar së bashku në këtë proces, pas analizimit të aplikacionit konform dispozitave ligjore në fuqi, ka ardhur deri tek vlerësimi se të gjitha kërkesat ligjore janë përmbushur dhe në këtë mënyrë bënë lëshimin e Autorizimit për futjen në shërbim për pajisjen "IVECO-DAILY, PALFINGER KRAN".



Fig.4 IVECO-DAILY,PALFINGER KRAN

Më datën: 28-04-2015, Infrakos ka aplikuar për marrjen e Autorizimit për futjen në shërbim për pajisjen “IVECO-DAILY, PALFINGER KRAN”

Më datën: 14-08-2015, departamenti i sigurisë ka dhënë Autorizimin për futjen në shërbim për pajisjen “IVECO-DAILY, PALFINGER KRAN”



Fig. 5. Plasser&Theurer “OBW 10 Sprinter”



Fig. 6. ATLAS 1404ZW

5.3.2.3. Përgatitja e raportit vjetor të sigurisë

Raporti vjetor i sigurisë për vitin 2014 është përgatitur dhe dorëzuar të Drejtori i përgjithshëm me datë 30 Shtator 2015. Ky raport mbulon aktivitetet e departamentit të Sigurisë gjatë vitit 2014 dhe është raporti i tretë me radhë të cilin e kemi paraqitur të drejtori i përgjithshëm dhe te bordi i ARH-së. Ky raport i sigurisë për vitin 2014 është punuar ashtu siq kërkohet me ligjin 04/L-063 nenin 20 si dhe në bazë të parimeve të Direkticës 2004/49/EC neni 18.

Struktura e këtij raporti është në përputhje me rekomandimet (modelit dhe udhëzimit) e Agjensionit Evropian Hekurudhor (ERA).

Ky raport i sigurisë është përgatitur në radhë të parë nga informacioni i siguruar nga aktivitetet e departamentit të sigurisë si dhe nga informatat e raporteve vjetore të ndërmarrjes hekurudhore (Trainkos) dhe menaxherit të Infrastrukturës (Infrakos). Trainkos ka marrë një certifikatë të vlefshme të sigurisë në Kosovë në vitin 2013, gjithashtu edhe Infrakos ka marrë një autorizim të vlefshëm të sigurisë në Kosovë në vitin 2013.

Ky raport i përshkruan aktivitetet e vitit paraparak me informacionet mbi:

- Zhvillimet e sigurisë hekurudhore duke përfshirë informacionin për Treguesit e Përbashkët të Sigurisë (TPS),
- Ndryshimet e rëndësishme në legjislacion dhe rregulloret në lidhje me sigurinë hekurudhore,
- Zhvillimin e Certifikatës së Sigurisë dhe Autorizimit të Sigurisë në Kosovë,
- Rezultatet dhe përvoja në lidhje me mbikëqyrjen e menaxherëve të infrastrukturës dhe të ndërmarrjeve hekurudhore,
- Përjashtimet të cilat nëse vendoset të bëhen nga Departamenti përgjegjës për Sigurinë hekurudhore lidhur me identifikimin dhe certifikimin e subjekteve përgjegjëse për mirëmbajtjen e mjeteve transportuese hekurudhore të regjistruara në vendet tjera jashtë Kosovës dhe të cilat mirëmbahen sipas ligjeve të këtyre vendeve.

ARH ka pranuar nga Infrakos si menaxher i infrastrukturës raportin vjetor me datë: 19/06/2015 si dhe raportin vjetor nga Trainkos si ndërmarrje hekurudhore me datë: 30/06/2015.

Më datën: 19/06/2015 Infrakos ka dorëzuar Raportin Vjetor të Sigurisë për vitin 2014

Më datën: 30/06/2014 Trainkos ka dorëzuar Raportin Vjetor të Sigurisë për vitin 2014

Bazuar në këto dy raporte si dhe nga aktivitetet dhe informatat tona, më datën: 30/09/2014 brenda afatit ligjor kemi dorëzuar raportin vjetor të sigurisë te Drejtori i Përgjithshëm i ARH-së.



Më datën: 30/09/2015 Departamenti i Sigurisë ka përgatitur Raportin Vjetor të Sigurisë për vitin 2014

Raporti është i bazuar në modelin e zhvilluar nga Agjencia Hekurudhore Evropiane (ERA) dhe përmban të gjitha çështjet e treguara në nenin 18 të Direktivës 2004/49/EC i cili i është bashkangjitur këtij raport.

SHTOJCË V Raporti vjetor i sigurisë për vitin paraprak (2014) ashtu siç parashihet më Ligjin 04/L-063 dhe Direktivën 2004/49/EC.



5.3.2.4. Inspektimi i mjeteve lëvizëse

5.3.2.4.1. Inspektimi i mjeteve të Ferronikel-it

Inspektimi i mjeteve lëvizëse (vagonëve të mallrave) në pronësi të Feronikelit është kryer me datë: 20/11/2015, kurse raporti i inspektimit me rekomandime është dërguar me datë: 09/12/2015. Gjithsejtë janë inspektuar 24 vagonë të mallrave të Feronikelit. Gjatë inspektimit të këtyre mjeteve lëvizëse kemi inspektuar këto parametra të sigurisë:

1. Fletëzimi i vagonëve (shenjëzimi),
2. dimensionet e rrotave,
3. Trashësia e rrotave,
4. Papuçet frenuese,
5. Lidhëset e ajrit, çengeli,
6. Hapja dhe mbyllja e vagonetave,
7. gjendja fizike e vagonëve etj.

Raporti me rekomandime të sigurisë për mjetet e Ferronikelit është i bashkangjitur në këtë raport.

[SHTOJCË VI Raporti me rekomandime të sigurisë dërguar Ferronikelit.](#)

5.3.2.4.2. Inspektimi i mjeteve të Trainkos-it

Departamenti i sigurisë me datë 17-25/12/2015 ka kryer inspektimin e të gjithë Lokomotivave, vagonëve të udhëtarëve, vagonëve mallrave dhe trenave motorik të cilët janë në pronësi të Trainkos-it. Pastaj kemi përgatitur dhe dërguar në Trainkos një raport me të gjeturat gjatë inspektimit si dhe kemi dërguar disa rekomandime të sigurisë. Ky raport është dërguar në Trainkos me datë: 28/12/2015.

Në këtë inspektim janë përfshirë:

- vagonëve të udhëtarëve (21 copë),
- vagonëve të mallrave (46 copë),
- trenat motorik (7 copë) si dhe
- lokomotivat (15 copë).

Gjatë inspektimit të këtyre mjeteve lëvizëse kemi inspektuar këto parametra të sigurisë:

- a. Karrocera,
- b. Sistemi i frenimit,
- c. Radiolidhja,

- d. Gjami i përparmë i lokomotivave dhe trenave motorik,
- e. Shpejtësi matësi,
- f. Fshesat e xhamave të cilat shërbejnë për pastrimin e gjamit të përparmë me qëllim të rritjes së dukshmërisë gjatë lëvizjes,
- g. Dorëza për frenim te vrullshëm,
- h. Dyert në mjetin lëvizës hapja dhe mbyllja e tyre,
- i. Dyshemeja,
- j. Shkallet të cilat shërbejnë për hipje dhe zbritje të makinistit dhe personelit të lokomotivës,
- k. Sistemi i ngrohjes,
- l. Sistemi i ndriçimit,
- m. Buria e cila paralajmëron të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion,
- n. Sistemi kundër zjarrit,
- o. Lidhëset e ajrit, etj.

SHTOJCË VII Raporti me rekomandime të sigurisë dërguar Trainkos-it.

5.3.2.5. Inspektimi i linjave hekurudhore

Inspektimin e infrastrukturës hekurudhore e kemi kryer në një periudhë me të gjatë kohore duke filluar prej datë: 09/09/2015 deri me 16/12/2015. Në këtë inspektim kemi përfshirë të gjithë infrastrukturën hekurudhore në pronësi të Infrakos-it e cila përfshinë: Stacionet, Urat, Tunelet, Sinjalizimin, Ndriçimin, Ndërrueset, Traversat, Balastin, Barrierat, Kalimet në nivel, Mirëmbajtja pranë vijës hekurudhore etj. Raporti me rekomandime të sigurisë është dërguar në Infrakos me datë: 28/12/2015

Gjatë inspektimit kemi kryer inspektimin e linjave të cilat janë në funksion siç janë::

1. Fushë Kosovë-Prishtinë,
2. Fushë Kosovë-Pejë,
3. Fushë Kosovë_Hani i Elezit,
4. Fushë Kosovë-Magurë,
5. Fushë Kosovë-Terminali i mallrave Miradi dhe
6. Klinë-Xërxë

Gjithashtu kemi inspektuar edhe linjat të cilat për momentin nuk janë funksionale siç janë:

1. Fushë Kosovë-Mitrovicë,
2. Prishtinë-Podujevë,
3. Xërxë-Prizre

SHTOJCË VIII Raporti me rekomandime të sigurisë dërguar Infrakos-it.

5.4. DEPARTAMENTI I INTEROPERABILITETIT

5.4.1. Detyrat dhe përgjegjësitë

Në përmbushjen e përgjegjësiave të veta, departamenti udhëhiqet nga korniza ligjore që është përcaktuar me Ligjin për Hekurudhat e Kosovës Nr. 04/L-63 dhe sipas Dispozitave të Direktivës 2008/57/EC për Interoperabilitet dhe Direktivës 2004/49/EC për Siguri.

Si Departament brenda ARH-së është përgjegjës për t'i përcaktuar kushtet të cilat duhet t'i plotësojë sistemi hekurudhor në Kosovë për të arritur interoperabilitetin me sistemin hekurudhor të BE-së në drejtim të krijimit të hapësirës të interoperabilitetit Evropian, pjesë e së cilës dëshiron të jetë edhe Kosova.

Kushtet në lidhje me interoperabilitetin përmbajnë dizajnin, rindërtimin, futjen në shërbim, modernizimin, përtëritjen, operimin dhe mirëmbajtjen e pjesëve të sistemit e gjithashtu edhe kualifikimeve profesionale dhe kushtet e shëndetit dhe sigurisë së stafit i cili kontribuon në operimet dhe mirëmbajtjen e tij.

Departamenti ka për detyrë të hartojë legjislacionin sekondar në fushën e Interoperabilitetit hekurudhor i cili duhet të jetë në përputhje me standardet dhe rregullat evropiane të përcaktuara nga Direktivat për Interoperabilitet

5.4.2. Aktivitetet e Departamentit të Interoperabilitetit

Legjislacioni në fuqi kërkon:

Harmonizimin e legjislacionit, rregullave dhe të standardeve në sektorin hekurudhor me ato të BE-së të përshtatshme për Kosovën.

Janë këto aktivitete të cilat paraqiten në mënyrë të detajuar në vazhdim të këtij raporti:

5.4.2.1.Mjetet hekurudhore me pronësi të pa definuar

Në vitin 2015 është realizuar regjistrimi i të gjitha mjeteve me pronësi të pa definuar të cilat gjenden brenda territorit të Republikës së Kosovës.

Paraprakisht në fund të vitit 2014 „mjetet lëvizëse hekurudhore të cilat nuk kanë pronësi të definuar dhe nuk janë pjesë e Regjistrimit Nacional të Mjeteve Lëvizëse NVR realizuar në vitin 2012,, janë trajtuar si çështje. Si rrjedhojë pas marrjes së informacionit të përgjithshëm rreth administrimit dhe përgjegjësisë ndaj këtyre mjeteve lëvizëse nga Infrakos dhe Trainkos, ARH kishte planifikuar regjistrimin e të gjitha mjeteve që janë pjesë e kësaj kategorie.

Me datë: 04/02/2015 Departamenti për interoperabilitet fillon me regjistrimin e të gjitha mjeteve lëvizëse hekurudhore me pronësi të pa definuar. Regjistrimi është realizuar nga grupi teknik i përbërë nga ARH , Infrakos dhe Trainkos i udhëhequr nga zyrtari i ARH përgjegjës për Interoperabilitet, ndërsa zyrtaret nga Infrakos dhe Trainkos kishin vetëm rol asistues.

ARH vlerëson se për qëllim të zbatimit të Ligjit për Hekurudha janë ndërmarrë hapa konkret në këtë drejtim realizuar përmes regjistrimit. Një numër aq i madh mjeteve hekurudhore (507) pa pronësi të definuar dhe pa përgjegjësi të kompanive kundrejt tyre, vlerësuar sipas ARH-së nuk reflekton siguri. Andaj realizimi i regjistrimit formal nga Departamenti përgjegjës për regjistrim brenda ARH-së do ta rris sigurinë dhe do të ndikojë në parandalimin e mundësisë se keqpërdorimit të këtyre mjeteve. Ishte regjistrim formal meqë regjistrimi i rregullt nuk do të mund të realizohej në këtë rast pa një përgjegjës dhe aplikues .

Me datë: 14/05/2015 përfundon regjistrimi i të gjitha mjeteve me pronësi të pa definuar të cilat gjenden në territorin e Republikës së Kosovës. Me të dhënat e regjistrimit ARH krijon dhe ka në dispozicion raportin dhe regjistrin e mjeteve për këtë kategori me informacione të mjaftueshme për ta identifikuar secilin mjet.

SHTOJCË IX Raporti i regjistrimit të mjeteve me pronësi të pa definuar

5.4.2.2. Autorizimet për futje në shërbim të nënsistemeve strukturale konform kërkesave për interoperabilitet

ARH-ja është përgjegjëse për të gjitha vlerësimet dhe analizat e Interoperabilitetit në Kosovë dhe kërkesave të tjera të cilat kanë të bëjnë me futjen në shërbim, përmirësimin, renovimin dhe mirëmbajtjen e pjesëve të sistemit.

Brenda vitit 2015 Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave ka shqyrtuar kërkesat nga Infrakos për autorizim për futje në shërbim për tri mjete të mirëmbajtjes; „Drezine e rënde me Kran,, e tipit „OBW10 Sprinter,, nga prodhuesi „Pllaser & Theurer,, Eskavator „ATLAS 1404ZW,, dhe Automjet i kombinuar rrugë/hekurudhë „INVECO DAILY,, nga Infrakos. Departamenti i Interoperabilitetit i thirrur për t'i definuar kushtet për interoperabilitet shyrton aplikacionet mjeteve të mirëmbajtjes për autorizim për futjen në shërbim për të vlerësuar nëse mjetet në fjalë janë konform kërkesave për Interoperabilitet. Brenda afatit kohor të përcaktuar me ligj ky departament ka zhvilluar shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacioneve për pjesën e Interoperabilitetit për mjetet e mirëmbajtjes në përputhje me Ligjin për Hekurudhat e Kosovës 04/L-63 dhe Direktivën 2008/57/EC për Interoperabilitet.

Një vlerësim ndërmjet mjeteve transportuese me kërkesat për interoperabilitet është një kontribut drejtë krijimit progresiv hekurudhorë në pajisje dhe shërbime që qojnë drejtë funksionimit të sistemit dhe nënsistemeve hekurudhore drejt interoperabilitetit.

5.4.2.3. Regjistrimi i mjeteve lëvizëse

Sipas Ligjit për Hekurudhat e Kosovës 04/L-063, neni 28 paragrafi 7, ARH respektivisht Organi për Interoperabilitet është përgjegjës për numërimin e mjeteve transportuese të cilat janë në shërbim të Kosovës dhe për mbajtjen e regjistrit ad hoc me të gjitha informatat e kërkuara siç janë përshkruar në ligj, sikurse neni 18 paragrafi 3.6 që obligon ARH për mbikëqyrje se a janë regjistruar mjetet lëvizëse dhe nëse informacioni që ka të bëjë me sigurinë në regjistrin nacional është i azhurnuar.

ARH brenda vitit 2014 ka realizuar regjistrimin e një numri të konsiderueshëm të mjeteve lëvizëse nga Menaxheri i Infrastrukturës Infrakos dhe Operatori me Trena Trainkos. Mjetet e regjistruara i janë bashkangjitur Regjistrit Nacional të Mjeteve Lëvizëse (NVR) realizuar në vitin 2012.

Me datë: 22/06/2015 në Departamentin e Interoperabilitetit janë pranuar aplikacionet për regjistrimin e tri mjeteve të mirëmbajtjes, Drezine e rënde me Kran, e tipit „OBW10 Sprinter, nga prodhuesi „Pllaser & Theurer, Eskavator „ATLAS 1404ZW, dhe Automjet i kombinuar rrugë/hekurudhë „INVECO DAILY, nga Infrakos. Pas shqyrtimit të aplikacioneve për regjistrim njoftohet zyrtarisht INFRAKOS se aplikimet e tyre për regjistrim të mjeteve të mirëmbajtjes me numra evropian : 99 00 9459 009-0 (OBW 10 Sprinter) 99 00 9800 010-4 (ATLAS 1404ZW) 99 00 9800 011-2 (INVECO DAILY) janë të pranueshme nga Departamenti i Interoperabilitetit dhe janë pjesë e Regjistrimit Nacional të Mjeteve Lëvizëse NVR. Regjistrimi i këtyre mjeteve është realizuar pas marrjes së autorizimit për futje në shërbim nga ARH.

Me datë: 30/11/2015 Infrakos aplikon për regjistrimin e 11 mjeteve të mirëmbajtjes. Meqë për shqyrtim kërkoheshin informacione shtesë konsiderojmë që regjistrimi për këto mjete mbetet në proces. Informacionet për këto mjete janë paraqitur në tabelën e më poshtme (tabela 4)

Regjistrimeve iu nënshtruan këto mjete hekurudhore të paraqitura në formë tabelore:

Tabela 4: Mjetet e mirëmbajtjes të regjistruara dhe ato në proces të regjistrimit

Nr.	Mjeti lëvizës	Viti i prodhimit	Numri paraprak	Numri evropian	Statusi
1	Drezine e rënde me Kran	2014	6207	99 00 9459 009-0	Regjistruar
2	Eskavator ATLAS 1404ZW	2014	241Z301910	99 00 9800 010-4	Regjistruar
3	INVECO DAILY	2014	ZCFC35A	99 00 9800 011-2	Regjistruar
4	Vagon sallon pune	//	80729300207-5	//	Në proces
5	Vagon Bot	//	25727068077-6	//	Në proces
6	Motor i Lehtë Hekurudhor	2002	//	//	Në proces
7	Motor i Lehtë Hekurudhor	2002	//	//	Në proces
8	Motor i Lehtë Hekurudhor	2002	//	//	Në proces
9	Motor i Lehtë Hekurudhor	2002	//	//	Në proces
10	Motor i Lehtë Hekurudhor	2002	//	//	Në proces
11	Vallter	2013	//	//	Në proces
12	Vallter	2015	//	//	Në proces



13	Vallter	2015	//	//	Në proces
14	Vallter	2015	//	//	Në proces

Gjithashtu brenda vitit 2015 në Departamentin e Interoperabilitetit janë pranuar aplikacionet për regjistrimin e tri mjeteve hekurudhore nga Operatori me Trena – Trainkos. Më datë: 09/12/2015 pranohen në ARH aplikacionet për regjistrimin e dy vagonëve të mallrave dhe një aplikacion për tërheqje nga komunikacioni për vagonin e mallrave me numër evropian **21 00 1503 033-6**. Më datë: 11/12/2015 i është konfirmuar Trainkos-it pranimi i aplikacioneve për mjetet për të cilat kanë aplikuar. Pas shqyrtimit të aplikacioneve më dt: 15/12/2015 njoftohet Trainkos se aplikimet për regjistrimin e vagonëve të mallrave me numra evropian **21 00 1501 047-8** dhe **21 00 1506 048-1** dhe tërheqjen e vagonit të mallrave me numër evropian **21 00 1503 033-6** janë të pranueshme në ARH. Informacionet për këto mjete janë paraqitur në tabelen e më poshtme (tabela 5)

Tabela 5: Vagonët e mallrave të regjistruar dhe tërhequr nga komunikacioni

Nr	Mjeti lëvizës	Viti i prodhimit	Numri paraprak	Numri evropian	Statusi
1	Vagonë i mallrave	//	//	21 00 1501 047-8	Regjistruar
2	Vagonë i mallrave	1972	21721501818-5	21 00 1506 048-1	Regjistruar
3	Vagonë i mallrave	1968	21741503950-2	21 00 1503 033-6	Tërhequr

Departamenti i Interoperabilitetit ka shqyrtuar të gjithë formularët e regjistrimit konform legjislacionit në fuqi dhe në afat kohor të përcaktuar në rregulloren e regjistrimit Nr. 05/2012.

Gjithashtu një bashkëpunim konstruktiv në mes ARH-se dhe kompanive (Trainkos dhe Infrakos) ka ndihmuar që i gjithë regjistrimi të realizohet me sukses, duke kontribuar që implementimi i Rregullores 05/2014 të realizohet në mase të kënaqshme e cila është hartuar në përputhje me legjislacionin e BE-së.

Regjistrimi i mjeteve lëvizëse duke përfshirë „regjistrimet,” dhe „tërheqjet,” rregullohet me Ligjin për Hekurudhat e Kosovës 04/L-063, Direktivën për Interoperabilitet 2008/57/EC dhe Rregulloren 05/2012 për Regjistrimin Nacional të Mjeteve Lëvizëse miratuar nga ARH.

5.4.2.4. Marrëveshjet kontraktuale

Departamenti për Interoperabilitet, në mënyrë që ti vlerësoj kushtet për interoperabilitet mbledhë informacione nga Menaxheri i Infrastrukturës dhe Operatori me Trena rreth marrëveshjeve kontraktuale mbi operimin dhe mirëmbajtjen brenda dhe jashtë vendit me institucionet/kompanitë tjera hekurudhore. Bazuar në këto të dhëna ARH ka krijuar listën e marrëveshjeve ndërkufitare me të dhëna dhe informacione të ofruara nga palët nënshkruese. Lista përfshinë marrëveshjet ndërkufitare **të finalizuara** dhe të **pa-finalizuara**. Informacione të detajuara mbi marrëveshjet gjenden në tabelën e më poshtme (tabela 3). Tabela përbëhet nga të dhënat e fundit ofruar nga Infrakos dhe Trainkos (datë: 16/03/2015 dhe datë:12/03/2015).

Tabela 6: Marrëveshjet ndërkufitare të finalizuara dhe të pa-finalizuara

NR.	MARRËVESHJET	PALËT NËNSHKRUESE	DATA E NËNSHKRIMIT
1	Marrëveshja e përkohshme ndërmjet NHT"BEograd" dhe HEKURUDHAT E UNMIK-ut	HEKURUDHAT E UNMIK-ut - NHT"BEograd"	31.05.2002 (nuk implementohet)
2	Marrëveshja ndërmjet , Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë mbi komunikacionin hekurudhor kufitar	Qeveria e Republikës së Kosovës - Qeveria e Republikës së Maqedonisë	15.09.2011
3	Marrëveshja për mirëmbajtje të binarit industrial	NEW CO FERRONIKELI COMPLEX LLC - "INFRAKOS" SH.A.	27.02.2012
4	Marrëveshja ndërkombëtare për kalimin ndërkufitar ndërmjet "INFRAKOS"SH.A. - Kosovë dhe H.M."INFRASTRUKTURA" - Maqedoni	"INFRAKOS"SH.A. - H.M."INFRASTRUKTUR	Pa-finalizuar
5	Marrëveshja ndërmjet TRAINKOS SH.A. dhe INFRAKOS SH.A. për shërbime të përbashkëta,	TRAINKOS SH.A. - INFRAKOS SH.A.	20.03.2013
6	Marrëveshja për qasjen në binarë "INFRAKOS"SH.A. dhe "TRAINKOS"SH.	TRAINKOS SH.A. - INFRAKOS SH.A.	Pa-finalizuar
7	Marrëveshja ndërmjet NEW CO FERRENKELIN COPEX LLC dhe Hekurudhat e Kosoves për bartjen e xeheve dhe thëngjillit e arritur me:	NEW CO FERRENKELIN COPEX LLC -Ish- Hekurudhat e Kosoves	14.06.2007
8	Marrëveshjen për mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse ndërmjet TRAINKOS SH.A. dhe	TRAINKOS SH.A. -NEW CO FERRENKELIN	17/04/2014

	NEW CO FERRENKELIN COPLEX LLC	COPLEX LLC	
9	Marrëveshja implementuese për ndërlidhjen e përbashkët të rrjeteve Hekurudhore ndërmjet Hekurudhave të Maqedonisë-Infrastruktura dhe Hekurudhave të Kosovës,	H.M. "INFRASTRUKTURA" - TRAINKOS SH.A.	Pa-finalizuar
10	Dispozitat e përbashkëta për rregullimin e Komunikacionit kufitar hekurudhor në linjën kufitare Vollkovë-Hani I Elezit	H.M. "INFRASTRUKTURA" - TRAINKOS SH.A.	Pa-finalizuar



ARH në vazhdimësi azhurnon listën e marrëveshjeve ndërkufitare përmes informacioneve zyrtare që ofrohen nga Menaxheri i Infrastrukturës Infrakos dhe Operatori me Trena Trainkos.

Nga të gjitha këto marrëveshje del që Menaxheri i Infrastrukturës-Infrakos dhe Operatori me Trena-Trainkos sa i përket operimit dhe mirëmbajtjes përveç marrëveshjeve me institucionet brenda vendit dhe me Maqedoninë nuk posedojnë marrëveshje kontraktuale të tilla me vende të tjera. Marrëveshjet me Maqedoninë të finalizuara apo ato në prag të finalizimit konsiderohen si rrjedhojë e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë mbi komunikacionin hekurudhor kufitar të nënshkruar më datë: 15/09/2011 dhe të ratifikuar nga Presidentja e Kosovës me datë 07/10/2011 .

5.4.2.5.Specifikimet Teknike për Interoperabilitet STI

Vendimit 2011/275/EU CR TSI „Infrastruktura „

Specifikacionet Teknike për Interoperabilitet janë përgatitur dhe lëshuar në nivel të BE-së, në mënyrë që të përgatitet Hapësira Unike Hekurudhore dhe si të tilla duhet të paraqesin bazën kryesore të sigurisë hekurudhore në Kosovë.

Sipas Ligjit për Hekurudha për secilin nënsistem hekurudhorë, Specifikacionet Teknike të Interoperabilitetit në Kosovë duhet të lëshohen nga ARH-ja dhe duhet t'i plotësojnë kërkesat esenciale e në veçanti kërkesat e sigurisë.

ARH përgjegjëse për fushën e Interoperabilitetit e obliguar për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të saj kundrejt Ligjit, brenda vitit 2014 dhe në fillim të vitit 2015 arrin që të jetë në fazën e fundit të procesit të Adoptimit të Vendimit 2011/275/EU CR STI për Infrastrukturë. Në mungesë të Bordit, ARH-ja nuk ka mundur të miratojë adoptimin e këtij Vendimi. STI do të ketë rol integruar të sistemit tonë hekurudhore në atë të BE-së, meqë lehtësojnë tranzicionin nga sistemet e vjetra kombëtare hekurudhore të integruara, të cilat qeveriseshin kryesisht nga rregulla kombëtare në një zonë hekurudhore të përbashkët Evropiane që qeveriset kryesisht nga rregullat e përbashkëta të BE-së. STI për infrastrukturë specifikon *'kushtet që duhen plotësuar për të arritur interoperabilitet'* dhe duhet konsideruar si një përkufizim i nivelit maksimal të harmonizimit teknik

Ne synojmë të jemi pjesë e BE-së, prandaj transpozimi i legjislacionit hekurudhorë të Bashkimit Evropian (STI) të përshtatshëm për sektorin e hekurudhave në Kosovë është një avantazh për ti përmbushur obligimet kundrejt Ligjit për Hekurudhat e Kosovës, njëkohësisht edhe obligimeve ndaj BE-së, si kusht për t'iu bashkuar familjes Evropiane.

Ne konsiderojmë që një veprim i tillë duke i vlerësuar rregulloret evropiane si model referimi, do të ndihmonte për ta vendosur sistemin hekurudhorë në një pozicion të qëndrueshëm dhe të sigurt.

Në forme tabelore do të paraqesim STI të miratuara dhe në proces të miratimit nga ARH dhe STI në nivel të BE-së (tabela 4):

Tabela 7: STI të miratuara nga ARH.

Statusi	Numri	Nënsistemi	Data e miratimit
Vendim	2011/291/EU	Lokomotiva & mj.pasagjer	11/12/2013
Vendim	2011/275/EU	Infrastruktura	Në proces

Vendimi 2011/275/EU CR TSI do të jetë i disponueshëm në ueb faqën e ARH-së (www.arh.ks.org) kur edhe do të jetë miratuar me qëllim që të ndihmojë akterët në zbatimin e kësaj STI.



Statusi i STI-së në nivel të BE-së (Janar 2015)

Tabela 8: STI strukturale dhe amendamentimet e tyre ndër vite

Viti	INF		ENE		STI SRT	STI PRM	RST				CCS		Viti
	HS STI INF	CR STI INF	HS STI ENE	CR STI ENE			HS STI RST	CR STI LOC&P AS	CR STI WAG	STI NOI	HIS STI CCS	SR STI CCS	
1999											<u>Vendim 1999/569</u>		1999
2000											Hyrja në fuqi 29/07/1999		2000
2001											<u>Vendim 2001/260</u>		2001
2002	<u>Vendim 2002/732</u>		<u>Vendim 2002/733</u>				<u>Vendim 2002/73</u> 5				<u>Vendim 2002/731</u>		2002
2003	HS INF STI		HS ENE STI				HS RST STI				HS CCS TSI		2003
2004	Hyrja në fuqi 30/11/2002		Hyrja në fuqi 30/11/2002				Hyrja në fuqi 30/11/2002		<u>Vendim 2004/44</u> 6	<u>Vendim 2004/44</u> 6 (vetëm CR)	<u>Vendim 2004/44</u> 7 (amendament Anex A)	<u>Vendim 2004/44</u> 7	2004
2005													2005
2006										<u>Vendim 2006/66</u> NOI TSI DtA: 28/9/2006	<u>Vendim 2006/860</u> (2 nd HS CCS TSI) DtA: 7/11/2006	<u>Vendim 2006/67</u> 2 nd CR CCS STI DtA: 28/9/2006	2006
2007											<u>Vendim 2007/153</u> (amendament Ann. A) DtA: 6/3/2007	<u>Vendim 2007/153</u> (amendament Ann. A) DtA: 7/3/2007	2007

2008	<u>Vendim</u> 2008/217		<u>Vendim</u> 2008/284		<u>Vendim</u> 2008/163	<u>Vendim</u> 2008/16	<u>Vendi</u> m 2008/23		<u>Vendim</u> 2008/386		<u>Vendim</u> 2008/386	<u>Vendim</u> 2008/386	2008
	HS INF TSI		HS ENE STI		SRT TSI	PRM TSI	HS RST TSI		CR WAG TSI		(amend ment Ann. A)	(amend ment Ann. A)	
	Hyrja në fuqi 21/12/2007		Hyrja në fuqi 6/3/2008		Hyrja në fuqi 21/12/2007	Hyrja në fuqi 27/12/2007	Hyrja në fuqi 21/2/2008		DtA: 31/01/2008		DtA: 1/6/2008	DtA: 1/6/2008	
2009	DtA: 1/7/2008		DtA: 1/10/2008		DtA: 1/7/2008	DtA: 1/7/2008	DtA: 1/9/2008					<u>Vendim</u> 2009/561	2009
											(amend me ch. 7)	DtA: 1/9/2009	
2010											<u>Vendim</u> 2010/79	<u>Vendim</u> 2010/79	2010
											(amend ment Ann A)	(amend ment Ann A)	
2011		<u>Vendim</u> 2011/275		<u>Vendim</u> 2011/274	<u>Vendim</u> 2011/291			<u>Vendim</u> 2011/29		<u>Vendim</u> 2011/229		DtA: 1/4/2010	2011
	CR INF TSI		(CR ENE TSI)		(amend ment)		LOC& PAS TSI			NOI TS)		DtA: 1/4/2010	
2012 *		DtA: 1/6/2011		DtA: 1/6/2011	DtA: 1/6/2011		DtA: 1/6/2011			(CR)	<u>Vendim</u> 2012/696	(amendment annexes A dhe G)	2012*
												DtA: 23/7/2012	
2013									Regullor 321/2013		<u>Vendim</u> 2012/463	<u>Vendim</u> 2012/463	2013
									CR WAG TSI		(amend ment)	amendm ent	
											DtA: 24/1/2013	DtA: 24/1/2013	
2014									Hyrja në fuqi 13/4/2013		<u>Vendim</u> 2012/88	(CCS TSI)	2014
									DtA: 1/1/2014			DtA: 1/1/2013	



2015	<u>Regulation 1299/2014</u> (INF TSI) Hyrja në fuqi dhe DtA: 1/1/2015	<u>Regulation 1301/2014</u> (ENE TSI) Hyrja në fuqi dhe DtA: 1/1/2015	<u>Regullor e 1303/2014</u> <u>4</u> (2nd PRM TSI) Hyrja në fuqi DtA: 1/1/2015	<u>Regulati on 1303/2014</u> <u>14</u> (STR TSI) Hyrja në fuqi dhe DtA: 1/1/2015	<u>Regullore 1302/2014</u> (RST TSI) Hyrja ne fuqi dhe DtA: 1/1/2015	<u>Regullor e 1236/2013</u> Hyrja në fuqi 4//12/2013 DtA :1/1/2014 Amend ament 2014			

*Vendimi 2012/464 amendamenton Vendimet 2006/861/EC, 2008/163/EC, 2008/164/EC, 2008/217/EC, 2008/231/EC, 2008/232/EC, 2008/284/EC, 2011/229/EC, 2011/274/EU, 2011/275/EU, 2011/291/EU dhe 2011/314/E



Tabela 9: STI funksionale dhe amendamentimet e tyre ndër vite (Dhjetor 2014).

Viti	TSI OPE		TA			
	HS TSI OPE	CR TSI OPE	CR TSI TAF	TSI TAP		
2002	<u>Vendim 2002/734 (HS OPE TSI)</u> Dt.A: 12/3/2003					
2003						
2004						
2005						
2006						
2007						
2008	<u>Vendim 2008/231 (HS OPE TSI)</u> Dt.A: 1/9/2008	<u>Vendim 2006/920 (CR OPE TSI)</u> Dt.A: 18/05/2007	<u>Vendim 2004/446 (në parametra bazik)</u> <u>Rregullore 62/2006 (TAF TSI)</u> Hyrja në fuqi: 19/1/2006			
2009						
2010	<u>Vendim 2010/640 (amendament)</u> Dt.A: 25/10/2010 dhe 1/1/2014**	<u>Vendim 2009/107 (amendament)</u> Dt.A: 1/7/2009		<u>Rregullore 454/2011 (TAP TSI)</u> Hyrja në fuqi: 13/5/2011		
2011		<u>Vendim 2010/640 (amendament)</u> Hyrja në fuqi: 25/10/2010 dhe 1/1/2014**				
2012		<u>Vendim 2011/314 (CR OPE TSI)</u> Dt.A: 1/1/2012				
*		Rregullore 328/2012 (amendament) Hyrja në fuqi: 8/5/2012			<u>Rregullore328/2012 (amendament)</u> Hyrja në fuqi: 8/5/2012	Rregullore 665/2012 (amendament) Hyrja në fuqi: 22/7/2012
2013					Regulation 280/2013 (amendment) EiF: 24/3/2013	Rregullore 1273/2013 (amendment) Hyrja në fuqi: 8/12/2013
2014	Vendim 2012/757 OPE: 2012 (OPE TSI) Dt.A: 1/1/2014					
2015	(version I ri i TSI)					
			<u>Rregullore 1305/2014 (TAF TSI)</u> Hyrja ne fuqi/Dt.A: 1/1/2015			

*Vendimi 2012/464 amendamentoi Vendimet 2008/231/EC an 2011/314/EU

**Dt.A: 1/1/2014 është vetëm për pikën 6, Annex I dhe pikën 5 of Annex II.

5.4.2.6. Inspektimi i regjistrit të mjeteve lëvizëse

Organi përgjegjës për çështjet e interoperabilitetit të hekurudhave duhet të jetë përgjegjës për numërimin e mjeteve transportuese të cilat janë në shërbim në Kosovë dhe për mbajtjen e regjistrit ad hoc me të gjitha informatat e kërkuara siç janë përshkruar në Ligjin për Hekurudhat e Kosovës (neni 28, paragrafi 7)

Përgjegjës për mbajtjen e Regjistrit Nacional të Mjeteve Lëvizëse Hekurudhore (NVR) është Departamenti i Interoperabilitetit i cili ka për detyrë të organizoj këtë regjistër dhe për t'i futur të gjitha mjetet lëvizëse hekurudhore që janë në shërbim në Kosovë.

Inspektimi i regjistrit të mjeteve lëvizëse të Infrakos është realizuar me datë: 27-28/12/2015

Inspektimi i regjistrit të mjeteve lëvizëse të Newco Ferronikeli është realizuar me datë: 26/11/2015

Inspektimi i regjistrit të mjeteve lëvizëse të Trainkos është realizuar me datë: 17-18/12/2015 dhe 21-22/12/2015

ARH në fund të vitit 2012 kishte arritur që me sukses të realizoj regjistrimin e të gjitha mjeteve lëvizëse hekurudhore që gjinden në territorin e Kosovës dhe duke krijuar Regjistrin Nacional të Mjeteve Lëvizëse NVR sipas standardeve evropiane.

NVR është krijuar në përputhje me Ligjin për Hekurudhat e Kosovës 04/L-063, Direktivën për Interoperabilitet 2008/57/EC, Rregulloren për Regjistrimin Nacional të mjeteve lëvizëse 05/2012 dhe Vendimin 2007/756/BE.

Meqenëse regjistri duhet vazhdimisht të azhurnohet me të dhëna dhe aplikime nga kompanitë, Departamenti për Interoperabilitet realizon inspektimin rreth përputhmërisë së mjeteve aktuale hekurudhore me NVR, me idenë për të parandaluar operimin me mjete të paregjistruara e cila do të ishte në kundërshtim me rregulloren 05/2012.

Në fund të vitit 2015 është realizuar inspektimi i regjistrimit të mjeteve lëvizëse hekurudhore të cilat janë të regjistruara që nga 2012 deri më 15 dhjetor të 2015.

Inspektimi është realizuar me sukses duke krahasuar përputhshmërinë e mjeteve të inspektuara me Regjistrin Nacional të Mjeteve Lëvizëse NVR krijuar në vitin 2012 i cili në vazhdimësi është azhurnuar nga ARH, kërkuar sipas Ligjit për Hekurudhat e Kosovës.

Inspektimit të regjistrimit të mjeteve lëvizëse iu nënshtruan mjetet e Infrakos-it (data e inspektimit 27-28/12/2015), mjetet e Trainkos-it (datat e inspektimit 17-18/12/2015 dhe 21-22/12/2015) si dhe mjetet e Newco Ferronikeli (data e inspektimit 26/11/2015).

Me rezultatet e dala nga inspektimi janë përgatitur raportet për tri kompanitë që kanë përfshirë të gjitha mjetet hekurudhore në pronësi dhe administrim të Infrakos, Trainkos dhe Newco Ferronikeli Complex.

Ky është raporti i dytë mbi Inspektimin e Regjistrin Nacional të Mjeteve Lëvizëse hekurudhore (NVR) i krijuar në vitin 2012 i cili në vazhdimësi është mbajtur dhe azhurnuar nga Departamenti i Interoperabilitetit me të dhëna dhe aplikime për regjistrime të reja dhe modifikuara nga kompanitë (Infrakos, Trainkos dhe Newco Ferronikeli Complex).

Në forme tabelore kemi paraqitur operatorët, mjetet e të cilëve janë përfshirë në inspektim (tabela 6).

Tabela 10: Operatorët hekurudhor mjetet lëvizëse të të cilëve janë në Regjistrin Nacional të Mjeteve Lëvizëse hekurudhore NVR.

OPERATORI HEKURUDHOR		STATUSI	Ueb-faqja
Infrastruktura Hekurudhore e Kosovë	INFRAKOS	Në përdorim	www.kosovorailway.com
Operimi me trena në Kosovë	TRAINKOS	Në përdorim	www.trainkos.com
Newco Ferronikeli Complex L.L.C	FERRO-NICKEL	Në përdorim	www.cunicoresources.com

5.4.2.7. Shënimi i numrit evropian në mjetin lëvizës

Që nga viti 2012 kur është realizuar regjistrimi i parë i mjeteve lëvizëse Infrakos dhe TRAINKOS kanë realizuar procesin e mbishkrimit të numrit evropian vetëm në disa mjete hekurudhore me të cilat operonin dhe janë pjesë e NVR-së, kryesisht ato të cilat kishin autorizim për futje në shërbim. Ferronikeli nuk kishte të shënuar numrin evropian në asnjërin mjet hekurudhorë që ishte pjesë e NVR-së. ARH për ta realizuar në tërësi këtë proces meqenëse jo të gjitha mjetet kanë të shënuar numrin evropian, e planifikon si aktivitet brenda vitit 2015. Për përmbushjen e këtij aktiviteti palët e përfshira njoftohet zyrtarisht me dt: 13/11/2015. Shënimi i numrit evropian në mjetin lëvizës kërkohet në Ligjin për hekurudhat e Kosovës 04/L-063, neni 110, paragrafi 8.1.

Me një mirëkuptim dhe bashkëpunim të ndërsjellët me kompanitë arrijmë që të përfundohet pothuajse me sukses ky aktivitet me rezultatet si me poshtë:

- Që nga 2012 Infrakos ka realizuar procesin e mbishkrimit të numrit evropian në disa mjete hekurudhore me të cilat operon dhe janë pjesë e NVR-së, megjithëse jo të gjitha mjetet kishin të shënuar numrin evropian. Si rezultat në vitin 2015 Infrakos ka përfunduar me mbishkrimin e numrit evropian në të gjitha mjetet funksionale të mirëmbajtjes.
- Që nga viti 2012 Trainkos kishte realizuar shënimin e numrit evropian kryesisht në mjetet të cilat ishin të pajisura me autorizim për futje në shërbim dhe ato të cilat iu nënshtruar riparimit të mesëm ose gjeneralë. Si rezultat në vitin 2015 Trainkos ka përfunduar me mbishkrimin e numrit evropian në të gjitha mjetet hekurudhore funksionale, përveç trenave motorik dhe është në proces të shënimit të numrit evropian në mjetet tjera të cilat nuk janë funksionale por që janë në regjistrin e NVR-së.
- Që nga viti 2012 numri evropian nuk gjendej në asnjërin mjet lëvizës në pronësi dhe administrim të Ferronikel-it që përbënin regjistrin NVR. Në vitin 2015 ka përfunduar me sukses shënimi i numrit evropian në të gjitha mjetet që janë pjesë e NVR-së. Si rezultat të gjithë vagonët e mallrave të kësaj kompanie e kanë të mbishkruar Numrin Evropian.

5.4.3. Synimet e Departamentit të Interoperabilitetit

Objektivi i përgjithshëm i Departamentit të Interoperabilitetit është që të mbështesë zbatimin e reformave në sektorin hekurudhor të Kosovës, përderisa si çështje specifike konsideron draftimin dhe implementimin e legjislacionit përkatës në fushën e interoperabilitetit hekurudhorë.

Ndjekja e këtij objektivi duhet të çojë në përcaktimin e një niveli optimal në harmonizimin teknik dhe të bëjë të mundur për të lehtësuar përmirësimin dhe zhvillimin e shërbimeve të transporti hekurudhor brenda dhe jashtë vendit.

Një përkufizim figurativ mbi synimet e Interoperabilitetit do të dukej sikur në figurën e mëposhtme:



Fig. 7. Synimet e Departamentit të Interoperabilitetit.

5.5. DEPARTAMENTI I RREGULLIMIT TË TREGUT

5.5.1. Detyrat dhe përgjegjësit

Departamenti i Rregullimit të Tregut Hekurudhor ka për detyrë që të bëjë sigurimin e kushteve për hapjen e tregut hekurudhor në Kosovë , në kuadër të kësaj parashtrohen një varg detyrash dhe përgjegjësisë ligjore siç janë:

- Sigurimi që pagesat e vendosura nga menaxheri i infrastrukturës apo organi i vendosjes së pagesës nuk janë diskriminuese.
- Sigurimi që qasja në binarë, qasja në stacione, qasja në depot e operatorëve që plotësojnë kushtet e domosdoshme të jetë e drejt, transparente dhe jo diskriminuese.
- Mbikëqyrja e negotimeve ndërmjet aplikuesve dhe menaxherëve të infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët në lidhje me nivelet e pagesës për infrastrukturë. Ato negociata duhet të lejohen vetëm nëse ato kryhen nën mbikëqyrjen e organit rregullativ të tregut hekurudhor.
- Intervenimi nëse negociatat e tilla kanë të ngjarë se do jenë në kundërshtim me kërkesat e këtij ligji.
- Sigurimi se a përmban ekspozitë i rrjetit klauzola diskriminuese apo krijon kompetenca diskriminuese për menaxherët e infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët, të cilat ata mund t'i shfrytëzojnë për t'i diskriminuar aplikantët.
- Analizimi dhe monitorimi i konkurrencës dhe kualitetit të shërbimeve në tregun e shërbimeve hekurudhore dhe në tregjet e brendshme dhe të jashtme konkurruese. E gjithë kjo të bëhet me iniciativën e tij dhe me qëllim të parandalimit të diskriminimit në mesin e aplikantëve.
- Vepron si organ për anketa për tregun hekurudhor, secili aplikant duhet të ketë të drejtë të ankohet nëse beson se ka qenë i trajtuar në mënyrë të padrejtë, i diskriminuar dhe në veçanti kundër vendimeve të miratuara nga menaxheri i infrastrukturës, operatori i pajisjeve për ofrimin e shërbimeve apo kur është e mundur edhe nga ndërmarrja hekurudhore në lidhje me:
- Monitorimi i tërë tregut hekurudhor në Kosovë, në këtë drejtim, departamenti i tregut hekurudhor duhet të përgatis raportin vjetor të cilin arh pas miratimit të tijë do ta paraqes në kuvendin e Kosovës.
- Dhënia e kontributit për politikën të cilat ofrojnë zhvillim të qëndrueshëm, shërbime mjedisore të transportit dhe kontribut në zbatimin e tij. Dhënia e kontributit për të zhvilluar sisteme të integruar të transportit të udhëtarëve dhe mallrave.



- Kontributi në lejin e procesit për të lejuar mbylljen e shërbimeve publike të udhëtarëve të interesit të përgjithshëm ekonomik, mbylljen e binarëve dhe stacioneve.

5.5.2. Aktivitete e Departamentit të Rregullimit të Tregut

Departamenti i Rregullimit të Tregut në kuadër të planit të punës dhe sipas detyrave dhe përgjegjësiave ligjore ka realizuar këto aktivitete përgjatë vitit 2015:

- Monitorimin e Tregut Hekurudhor;
- Mbikëqyrja e implementimit të Ekspozeut të Rrjetit 2015;
- Mbikëqyrja e Kontratës për Ofrimin e Shërbimeve Publike;
- Mbikëqyrja e procesit të konsultimeve për Draft Ekspozeun e Rrjetit 2016;
- Takime pune me menaxherin e infrastrukturës “Infrakos”
- Takime pune me ndërmarrjen hekurudhore “Trainkos”
- Hartimi i akteve nënligjore dhe formularëve për fushën e rregullimit të tregut hekurudhor;
- Aktivitete promovuese për të Drejtat e Udhëtarëve

5.5.2.1. Monitorimi i Tregut Hekurudhor

Në kuadër të kësaj ne kemi monitoruar sektorin hekurudhor në parametrat e zhvillimit të tij, për zhvillimin dhe funksionimin e tregut hekurudhor ne kemi përgatitur edhe raportin e monitorimit të tregut për vitin 2014 dhe si shtojcë të veçantë do ta paraqesim në shtojcën x të këtij raporti të punës.

[SHTOJCË X Raporti i Monitorimit të Tregut](#)

5.5.2.2. Mbikëqyrja e implementimit të Ekspozeut të Rrjetit 2015

Menaxheri i infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët pas konsultimeve me palët e interesit dhe Departamentin e Rregullimit të Tregut duhet të publikoj Ekspozeun e Rrjetit. Ky ekspoze duhet të përmbaj përshkrimin e infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët, rregullat e përgjithshme për aplikimin për trasetë e trenit, tarifat dhe qasjen në infrastrukturën hekurudhore, rregullat për alokimin e kapacitetit dhe informacionin tjetër esencial për raportet e punës ndërmjet menaxherit të infrastrukturës dhe ndërmarrjeve hekurudhore. Gjatë mbikëqyrjes së implementimit

ky Ekspoze nuk është zbatuar në nivelin e kënaqshëm pasi që ka munguar konkretizimi i “Marrëveshjes mbi Qasjen” si detyrim që del nga ky dokument.

5.5.2.3.Mbikëqyrja e Kontratës për Ofrimin e Shërbimeve Publike

Shërbimi hekurudhor në interes publik mund të blihet në çdo kohë nga autoritetet publike kompetente prej ndërmarrjeve hekurudhore në kornizat e kontratave të arritura ndërmjet autoriteteve të autorizuara dhe ndërmarrjeve hekurudhore. Ndërmarrja hekurudhore e cila kryen shërbime në interes të publikut duhet të ketë llogari të veçantë për ato shërbime dhe nuk i lejohet alokimi i fondeve publike të pranuar si pagesë për aktivitetet tjera nga ato shërbime përveç një profiti marginal të fituar. Departamenti i Rregullimit të Tregut ka mbikëqyrur këtë kontratë të arritur në mes të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Ndërmarrjes Operuese “Trainkos”

5.5.2.4.Mbikëqyrja e procesit të konsultimeve për Draft Ekspozeun e Rrjetit 2016 si dhe dhenja e rekomandimeve për nivelin e pagesave të qasjes në infrastrukturë.

Pas hartimit të Draftit të parë Menaxheri i infrastrukturës ka organizuar takimin konsultativ me palët e interesit. Departamenti i Rregullimit të Tregut sipas detyrës ligjore ka përgatitur procesverbalin e këtij takimi dhe sipas obligimit ligjor e ka dërguar tek të gjitha palët e interesit brenda afatit kohor. Pastaj, me kërkesën e Ministrisë së Infrastrukturës departamenti i Rregullimit të Tregut ka dhënë opinionin lidhur me nivelin e pagesave të qasjes në infrastrukturë .

5.5.2.5.Takime pune me menaxherin e infrastrukturës “Infrakos”

Kemi realizuar takime pune me tema të ndryshme tek zyrtaret përgjegjës të ‘Infrakosit’ si dhe monitoruar shërbimet që ofrohen në stacionet e udhëtarëve dhe terminalin e mallrave të menaxhuara nga “Infrakosi”.

5.5.2.6.Takime pune me ndërmarrjen hekurudhore “Trainkos”

Kemi realizuar takime pune për mbikëqyrjen e kontratës për shërbimet publike, shërbimet hekurudhore, respektimin e të drejtave të udhëtarëve, si dhe:

Kemi monitoruar në teren shërbimet që ofrohen në trenat e udhëtarëve në linjat operuese.

5.5.2.7. Hartimi i akteve nënligjore dhe formularëve për fushën e rregullimit të tregut hekurudhor.

Në kuadër të kësaj kemi përgatitur një Rregullore për të drejta e udhëtarëve në transportin hekurudhor dhe kemi iniciuar një tjetër për Raportimin e monitorimit të tregut hekurudhor sipas legjislacionit të BE-së.

Kemi përgatitur edhe një formular për ankesa të udhëtarëve.

5.5.2.8. Aktivitete Promovuese për të Drejtat e Udhëtarëve në Transportin Hekurudhor.

Qëllimi i kësaj fushate ishte njoftimi i udhëtarëve që shfrytëzojnë transportin hekurudhor për të drejtat e tyre si dhe adresimin e shkeljeve tek institucionet kompetente. Vlen të përmendët se materiali i përgatitur në formë të broshurës dhe posterit ka qenë në përputhje me Ligjin për Hekurudhat dhe me legjislacionin e BE-së. Realizimi i fushatës është bërë në bashkëpunim të ngushtë me stafin e ARH-së, po ashtu edhe në koordinim me Menaxherin e Infrastrukturës “Infrakos” si dhe me Operatorin Hekurudhor “Trainkos”



Fig. 8 Komunikata e ARH-së për media para fillimit të fushatës në teren.

Aktiviteti kryesor i kësaj fushate ishte aktiviteti i realizuar në teren, ku përmes shpërndarjes së broshurave si dhe vendosjes së posterave nëpër stacionet kryesor të udhëtarëve kemi arritur që në masë të madhe këtë fushatë ta bëjmë sa më atraktive dhe të pranueshme dhe kemi arritur që të përçojmë mesazhin tek përdoruesit e transportit hekurudhor për të drejtat e tyre.

Ky aktivitet është realizuar në mënyrë kronologjike dhe ka filluar me datë 02.10.2015, ku nga stacioni hekurudhor në Prishtinë stafi i ARH-së ka shpërndarë broshurat dhe ka vazhduar udhëtimin përgjatë relacionit Prishtinë-Pejë-Prishtinë duke shpërndarë broshura dhe duke bashkëbiseduar me udhëtarët për të drejtat e tyre që garantojnë me Ligjin për Hekurudhat dhe me standardet ndërkombëtare.

Gjithashtu, përgjatë një muaji të aktiviteteve zyrtare, Departamenti i Rregullimit të Tregut ka vazhduar me fushatën e vetëdijesimit në relacionin Han i Elezit - Fushë-Kosovë, Prishtinë – Pejë – Prishtinë , si dhe nëpër stacionet kryesore hekurudhore. Më poshtë po i paraqesim disa foto të realizuara gjatë aktiviteteve promovuese në teren, ku përmes tyre synojmë të dëshmojmë mbarëvajtjen e realizimit të këtij projekti.



Fig. 9 Prezantimi i Aktivitetit në Mediumin Publik RTK1



Fig. 10, Zyrtarët e ARH-ës duke shpërndarë broshura në Stacionin Hekurudhor të Prishtinës



Fig .11 Vendosi e Postierëve në Stacionin Kryesor të Fushë-Kosovës

5.5.2.9. Numri i udhëtarëve që kanë përdorur trenin si mjet udhëtimi si dhe sasia e mallrave të transportuar përmes hekurudhave gjatë vitit 2015

Departamenti i Rregullimit të Tregut gjatë Vitit 2015 në baza mujore është informuar nga Ndërmarrja Operuese me Trena "Trainkos" për numrin e udhëtarëve që kanë përdorur shërbimin e trenave të udhëtarëve si mjet transporti si dhe sasinë e mallrave të transportuara përmes shërbimit të transportit të mallrave.

Ne kemi bërë përlllogaritjen e tyre në baza mujore ku në formë tabelore si dhe me diagrame i kemi paraqitur në këtë raport.

Tabela 11: Numri i udhëtarëve në linjat operuese.

Relacioni i linjave operuese	Gjithsej numri i udhëtarëve në vit	Përqindja
Fushë Kosovë – Han i Elezit – Fushë Kosovë	82,846	30.88%
Prishtinë - Shkup - Prishtinë	34,302	12.78%
Prishtinë - Pejë - Prishtinë	151,129	56.33%
Totali	268,277	100%




Fig. 12 Paraqitja grafike e numrit të udhëtarëve në linjat operuese gjatë vitit 2014

Tabela 12: Numri i udhëtarëve gjatë vitit 2015

Muajt	Subjekti	Nr. udhëtarëve	Përqindja
Janar		23,357	8.70%
Shkurt		20,151	7.50%
Mars		23,108	8.60%
Prill		23,167	8.63%
Maj		23,773	8.86%
Qershor		23,687	8.80%
Korrik		22,755	8.48%
Gusht		21,096	7.86%
Shtator		21,168	8.10%
Tetor		22,071	8.20%
Nëntor		21,954	8.18%
Dhjetor		21,990	8.19%
Totali		268,277	100%




Fig. 13 Numri i udhëtarëve në muaj

Tabela 13: Sasia e mallrave të transportuara gjatë vitit 2015

Muajt	Subjekti	Sasia e mallrave	Përqindja
Janar		70,988.89	9.55%
Shkurt		68,559.19	9.20%
Mars		66,423.37	8.90%
Prill		67,165.64	9.20%
Maj		73,810.28	9.90%
Qershor		63,666.24	8.55%
Korrik		61,770.76	8.40%
Gusht		62,668.30	8.50%
Shtator		48,354.09	6.50%
Tetor		70,716.96	9.50%
Nëntor		60,284.58	8.10%
Dhjetor		28,031.10	3.70%
Totali		742,439.4	100%




Fig. 14 Sasia e ton/mallrave në muaj

5.6. DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS

5.6.1. Detyrat dhe përgjegjësitë

Departamenti i Administratës ofron mbështetje të gjithanshme për personelin e ARH-së duke përfshirë menaxhimin e burimeve njerëzore.

5.6.2. Aktivitetet e Departamentit të Administratës

Departamenti i Administratës është përgjegjës për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e stafit administrativ të ARH-së. Në mënyrë efektive duhet menaxhuar administrimin e aktiviteteve të burimeve njerëzore siç janë: administrimi i kohës dhe prezencës në punë, rekrutimi, vendosja e shpalljeve për punë, vlerësimet e punës së stafit në kuadër të Departamentit, etj. Departamenti i Administratës duhet të ofroj përkrahje administrative sipas nevojës zyrës së Drejtorit të Përgjithshëm dhe Departamenteve të ARH-së.

5.7. DEPARTAMENTI I FINANCE

5.7.1. Detyrat dhe përgjegjësitë

Duke njohur nevojën për përmirësimin e shpenzimeve buxhetore, kapitale dhe operative, menaxhimit financiar, kontabilitetit, përgjegjësiwe buxhetore dhe sistemit të raportimit financiar, Departamenti i Financave në ARH vepron dhe operon në bazë të: Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

5.7.2. Aktivitetet e Departamentit të Financave

5.7.2.1. Pasqyrat financiare

Në formë tabelore janë paraqitur pasqyrat financiare dhe rrjedhshmëria e transaksioneve financiare të ARH-së sipas kategorive buxhetore.

Tabela 14. Pasqyrat financiare për vitin 2015

Përshkrimi	Buxheti i aprovuar-fillestar	Buxheti i aprovuar-final	Shpenzimet	Shpenzimet %
Paga dhe mëditje	189789.00	119735.00	123269.94	102.95
Mallra dhe shërbime	123732.00	114179.00	108659.24	95.16
Shpenzime komunale	11900.00	11900.00	5973.68	50.19
Gjithsej	325421.00	245814.00	237902.86	96.78

Për një sqarim të përgjithshëm do të japim një gjendje të përgjithshme financiare dhe një ndarje krahasuese për të gjitha kategoritë buxhetore duke paraqitur të dhënat e vitit paraprak të cilat na japim një pasqyrë më të mirë, më të qartë dhe më me vizion për të ardhmen e ARH-se.

Ndarjet buxhetore në Total nga të gjitha Kategoritë Buxhetore, Varianca dhe Krahasset

		A	B	C	D=C-B	E	F
	Shënime	€	€	€	€	€	€
Hyrja e parasë së gatshme në llogari të Thesarit							
Tatimet	14						
Të hyrat vetanake	15						
Donacionet	16						
Pranimet kapitale	17						
Fondi i Privatizimit	18						
Huazimet	19						
Tjera	20						
Pranimet totale të mbledhura për FKK-në		-	-	-	-	-	-
Daljet e parasë së gatshme nga llogaritë e Thesarit							
Pagat dhe mëditjet	21	189,789.00	123,269.94	123,269.94	-	117,641.47	136,104.24
Mallrat dhe shërbimet	22	123,732.00	114,179.00	108,659.24	5,519.76	124,747.74	145,383.28
Shërbimet komunale	23	11,900.00	5,973.68	5,973.68	-	5,673.57	4,926.39
Transferet dhe subvencionet	24				-		
Shpenzimet kapitale	25	-	-	-	-	-	19,480.00
Fondi i privatizimit	26						
Kthimi i huazimeve							
Tjerat	27						
Totali i pagesave të bërë nga BRK nëpërmes LIVTh		325,421.00	243,422.62	237,902.86	5,519.76	248,062.78	305,893.91

Vëmendje:1/Ndryshimet buxhetore finale nga këto fillestare janë si rezultat i ndryshimeve buxhetore nga niveli qendror në procesin e rishikimit ku ne si OB kemi pasur shkurtime si nga kategoria e Pagave dhe Mëditjeve (-70.054.00 euro) po ashtu edhe nga Kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve (-9.553.00 euro), ndërsa tek kategoria e Shpenzimeve Komunale nuk ka pasur ndonjë shkurtime (gjendje e njëjtë).

Paga: Kemi një realizim të buxhetit prej **100.00 %**

Përshkrimi	2015				2014	2013
	GQ €	THV €	GPD €	Totali €	€	€
Pagesat						
Neto pagat		104,701.08	-	104,701.08	99,944.59	114,984.61
Pagesat për sindikata -0.10% te 0.50%						
Pagesa neto për punë jashtë orarit						
Pagesa për punë me orar të shkurtuar						
Pagesa për punë në ndërrim të natës						
Pagesa neto për pushim të lehonisë						
Mëditjet e delegatëve dhe komisioneve						
Punëtorët me kontratë						
Tatimi në të ardhura personale		6,828.38	-	6,828.38	6,492.24	8,157.35
Pagesa e kontributit pensional nga punëdhënësi		5,870.24	-	5,870.24	5,602.32	6,481.14
Pagesa e kontributit pensional nga i punësuar		5,870.24	-	5,870.24	5,602.32	6,481.14
Shujtat						
Gjithsej Pagesat	-	123,269.94	-	123,269.94	117,641.47	136,104.24

Mallra dhe Shërbime:Kemi një realizim të buxhetit prej **95.16 %**

Përshkrimi	2015				2014	2013
	GQ €	THV €	GPD €	Totali €	€	€
Pagesat						
Shpenzimet e udhëtimit	28,469.72			28,469.72	35,179.57	38,666.59
Shërbimet e telekomunikimit	5,611.00			5,611.00	5,300.00	9,345.00
Shpenzimet për shërbime	11,114.94			11,114.94	17,902.48	17,823.31
Mobiljet dhe pajisjet nën 1000 Euro	40.37			40.37	5,876.11	13,785.91
Mobiljet dhe pajisjet tjera 1000 - 5000 Euro						
Blerje tjera të mallrave dhe shërbimeve	10,804.50			10,804.50	13,426.59	10,811.10
Derivatet dhe lëndët djegëse	7,826.53			7,826.53	8,249.40	6,988.25
Shërbimet financiare						
Shërbimet e regjistrimit dhe sigurimeve	6,865.00			6,865.00	9,432.38	11,179.71
Mungesa në arkë-kthimet						
Mirëmbajtja	10,796.70			10,796.70	6,913.71	7,121.94
Qiraja	21,125.00			21,125.00	19,500.00	24,375.00
Shpenzimet e marketingut	1,226.30			1,226.30	1,843.50	2,307.60
Shpenzimet e përfaqësimit	1,470.30			1,470.30	1,124.00	2,978.87
Vendimet e gjykatave	3,308.88			3,308.88		
Tatimi						
Servisimi i borxhit						
Gjithsej Pagesat	108,659.24	-	-	108,659.24	124,747.74	145,383.28

Shpenzime Komunale:Kemi një realizim të buxhetit prej 100.00 %

Përshkrimi	2015				2014	2013
	GQ €	THV €	GPD €	Totali €	€	€
Rryma	2,982.48			2,982.48	2,044.22	2,486.14
Uji						
Telefon	2,991.20			2,991.20	3,629.35	2,440.25
Gjithsej Pagesat	5,973.68	-	-	5,973.68	5,673.57	4,926.39

Të hyrat vetanake

Përshkrimi	2015			2014		2013		% e ndryshimit nga 2010
	Shënime	€	€	€	€	€	% e totalit	
Të hyrat nga taksat 1 të ARH-së							%	%
Të hyrat nga taksat 2 të ARH-së							%	%
Të hyrat nga dënimet-gjobat 1 të ARH-së							%	%
Të hyrat nga dënimet-gjobat 2 të ARH-së							%	%
Të hyrat nga licencat 1 të ARH-së							%	%
Të hyrat nga licencat 2 të ARH-së							%	%
Të hyrat nga shitja e pasurisë dhe shërbimeve							%	%
Të hyrat nga inspektimi							%	%
Të hyrat nga interesi bankar							%	%
Të hyrat nga ndryshimet e pozicionit të kursit							%	%
Tarifa për akreditim							%	%
Të hyrat nga pasuria e ARH-së							%	%
Pranimet tjera të ARH-së							%	%
Totali		0	0	0	0%	0%		

ARH ende nuk ka filluar inkasimin e mjeteve përmes Taksave,Gjobave ,Licencave ,Lejeve të Sigurisë dhe pranimet tjera si të Hyra Institucionale.

Subvencione dhe Transfere

Përshkrimi	2015				2014	2013
	GQ €	THV €	GPD €	Totali €	€	€
Pagesat						
Subvencionet për entitetet publike						
Subvencionet për entitetet kulturore						
Subvencionet për entitetet jo-publike						
Transfere për qeveri tjera						
Pagesat për përfituesit individualë						
Pensionet bazë						
Pensionet invalidore						
Pensionet ose ndihmat sociale						
Pensionet e TMK-së						
Pensionet e kategorisë I (anëtarët e familjes)						
Pensionet e kategorisë II (anëtarët e familjes)						
Pagesat për invalidët e luftës						
Pagesat për invalidët civilë						
Pagesat për familjet e viktimave të luftës						
Pensionet e përkohshme të Trepçës						
Vendimet gjyqësore						
Gjithsej Pagesat	-	-	-	-	-	-

Gjatë këtij viti nga kjo kategori nuk kemi pasur ndonjë përkrahje apo subvencion as nga Qeveria as nga Donatorët apo ndonjë nivel tjetër.

Shpenzimet Kapitale

Përshkrimi	2015				2014	2013
	GQ €	THV €	GPD €	Totali €	€	€
Pagesat						
Ndërtesat					-	-
Ndërtimi i rrugëve					-	-
Kanalizimi					-	-
Ujësjetësi					-	-
Energjia, gjenerimi, bartja dhe furnizimi					-	-
Pajisje mbi 1000 Euro					-	-
Automjete transporti						
Makineria-Blerja e veturës zyrtare		-		-	-	19,480
Kapitalet tjera					-	-
Toka						
Pasuritë e paprekshme						
Transferet kapitale për entitetet publike						
Transferet kapitale për entitetet jopublike						
Vendimet gjyqësore						
Gjithsej Pagesat	-	-	-	-	-	19,480

5.7.2.2. Detajet e shpenzimeve nga kategoritë e Pagave, Mallrave dhe Shërbimeve, Shpenzimeve Komunale dhe Shpenzimeve Kapitale për vitin 2015 (Janar-Dhjetor 2015)

Ordinary Income/Expense	Planifikimi/Ndarja fillestare	Realizimi
Expense		
6-11000 · PAGAT & MEDITJET		
6-11110 · Paga Bruto Përmes Payr		104,701.08
6-11115-Pagesa për sindikata		0.00
6-11500-Tat.i ndaluar ne te ardhura personale		6,828.38
6-11600 · Kontributi pensional nga punëtori		5,870.24
6-11170-Kontributi për pension nga punëdhënësi		5,870.24
Total 6-11000 · PAGAT & MEDITJET	189,789.00	123,269.94
6-13000 · MALLRAT & SHERBIMET		
6-13100 · Shpenzimet e Udhëtimit	35,165.00	
6-13143 · Shpenz.e udhet.jashte vendit		8,868.04
6-13133 · Shpenz.tjera udhet.zyratar mbre		0.00
6-13142 · Akomodim gjate udhetimit zyrtar		6,182.15
6-13141 · Meditjet e udhetimit zyrtar		13,109.58
6-13140 · Sh. Udhëtimit Jasht Ven		309.95
Total 6-13100 · Shpenzimet e Udhëtimit		
71706 kthim i mjeteve(avansi)		0.00
71041 kthim i mjeteve(avans regj Pr NLB)		0.00
6-13300 · Sherbimet e Telekomunikimit	11,000.00	0.00
6-13310 · Interneti	3,000.00	0.00
6-13320 · Shpenzimet Tjera Telefo	8,000.00	5,611.00
6-1320A · Mbushje		
6-1320B · Roaming		
Total 6-13320 · Shpenzimet Tjera Telefo		0.00
6-13330 · Komunikimet Tjera		
6-13330 - Dergesat postare		
Total 6-13330 · Komunikimet Tjera		
Total 6-13300 · Sherbimet e Telekomunikimit		
6-13400 · Sherbimet Kontraktuese	46,054.00	
6-13480-Shpenzimet per antarsim		
6-13460 · Sherb.tjera kontr.	8,054.00	1,100.73
6-13450- Sherbime shtypje-jomarketing		921.68
6-13410 · Sh. Arsimit & Trajnimit	30,000.00	4,564.08
6-13430 · Sh.Ndryshme Shendetesor		
6-13440 · Sh.Ndryshme intel,keshilldh	8,000.00	3,835.00
6-13470 · Sherbimet Teknike		693.45
Total 6-13400 · Sherbimet Kontraktuese		

6-13500 · Blerja e Mobilie. >1000			
6-13501 · Mobilie			0.00
6-13502 · Tel mobil			0.00
6-13503 · Kompjuter			0.00
6-13509 · Paisje Tjera			40.37
Total 6-13500 · Blerja e Mobilie. >1000			0.00
6-13600 · Blerje Tjera	15,513.00		
6-13660 · Akomodim			
6-13610 · Furnizime per Zyre		11,900.00	3,979.30
6-13620 · Furnizim me ushqim & pi			4,088.20
6-13640 · Furnizime Pastrimi		3,613.00	
6-13650 · Furnizime me veshmbathj			2,737.00
Total 6-13600 · Blerje Tjera			
6-13700 · Derivate & Lend djegese	16,000.00		
6-13780 · Karburant per Vetura			3,892.65
6-13770 · Karburant per gjenerator			
6-13720 · Nafte per ngrohje			3,933.88
Total 6-13700 · Derivate & Lend djegese			
6-13800 · Llogarit e Avansit			
6-13820 · A. per udhetime zyrtare			
Total 6-13800 · Llogarit e Avansit			
6-13900 · Sherbimet Financiare			
6-13950 · Rexhistrimi i automjeteve			332.50
6-13952 · Taksa komunale e regjistrimit			51.00
6-13951 · Sigurimi i Automjeteve			1,555.54
6-13953 · Sigurimi I Nderesave dhe tjera			4,925.96
Total 6-13900 · Sherbimet Financiare			
6-14000 · Mirembajtja			
6-14031 · Mirembajtja e rrugeve regional			
6-14010 · Mir.&Riparimi Autmjeteve			1,921.10
6-14020 · Mir. e Nderesave			4,448.39
6-14030 · Mir. Infrastruktures Rr			
6-14040 · Mir. Teknologjis Inform			4,190.00
6-14050 · Mir. Mobilive & Paisjev			237.21
Total 6-14000 · Mirembajtja			
6-14100 · Qiraja			
6-14110 · Nderesat			21,125.00
Total 6-14100 · Qiraja			
6-14200 · Shpenzimet e Marketingu			
6-14230 · Shpenz.per informim publik			723.30
6-14210 · Reklama dhe Konkurse			503.00
6-14220 · Botime dhe Publikime			
Total 6-14200 · Shpenzimet e Marketingu			

6-14300 · Shpenzimet e Perfaqesim 6-14310 · Drekat Zyrtare Total 6-14300 · Shpenzimet e Perfaqesim		1,470.30
6-14400 · Shpenzimet per vendim dhe gjyka 6-14410 · Shpenzimet per vendim te gjykat Total 6-14400		3,308.88
Total 6-13000 · MALLRAT & SHERBIMET	123,732.00	108,659.24
6-13200 · SHPENZIMET KOMUNALE 6-13210 · Rryma 6-13220 · Uji 6-13230 · Mbeturinat 6-13240 · Ngrohja Qendrore 6-13250 · Telefoni PTK Total 6-13200 · SHPENZIMET KOMUNALE	11,900.00	5,973.68
6-20000 · Subvencionet&Transferet 6-21110 · Su. per Entitetet Publi 6-22200 · Pag. Perfitues Individu Total 6-20000 · Subvencionet&Transferet		
6-30000 · SHPENZIMET KAPITALE 6-31210 · Ndertimi i Autostrade 6-31230 · Ndertimi i rrugeve lokale 6-31220 · Ndertimi i rrugeve regjionale 6-31700 · Vetura zyrtare 6-31910 · Avanc per Investime Total 6-30000 · SHPENZIMET KAPITALE	0.00	0.00
Total Expense	325,421.00	237,902.86

5.8. DIVIZIONI I PROKURIMIT

5.8.1. Detyrat dhe përgjegjësitë

Divizioni i Prokurimit në ARH është përgjegjës për planifikimin e aktiviteteve të prokurimit si dhe zhvillimin dhe implementimin e procedurave të Prokurimit për blerjen e mallrave, shërbimeve dhe punëve në bazë të kërkesave të pranuar nga të gjitha departamentet apo njësitë e kërkesës së ARH-së, sipas Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës Nr. 04/L-042 si dhe të rregulloreve të miratuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Divizioni i Prokurimit të ARH-së në mënyrë të vazhdueshme ka pas një bashkëpunim të ngushtë dhe efikas me KRPP, Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik dhe me Agjencinë Qendrore të Prokurimit.

5.8.2. Aktivitetet e Divizionit të Prokurimit

Tabela në vijim paraqet aktivitetet e prokurimit të ARH-së për periudhën Janar – Dhjetor 2015

Tabela 15: Aktivitetet e prokurimit

Titulli i aktiviteteve të realizuara të prokurimit	Emri i Operatorit Ekonomik të cilit i është dhënë kontrata	Data e nënshkrimit të kontratës	Vlera e kontratës
Sigurimi fizik I objektit të ARH-së	N.T.Sh. SFK – Securit	02/03/2015	5,869.20 €
Mirëmbajtja dhe pastrimi i objektit të ARH-së	Shërbimi Sh.P.K	16/02/2015	4,740.00 €
Shërbime të përkthimit (nga gjuha Shqipe në gjuhën Serbe), për nevojat e ARH-së	AG Translation	20/03/2015	990.00 €
Shtypja dhe lidhja e Raportit Vjetor të punës 2014 të ARH-së	N.T.G. BLENDI	18.05.2015	391.68 €
Sigurimi i veturave zyrtare të	SIGAL Uniqa Group Austria	10.06.2015	1,555.54 €

Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave			
Ngritja e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë në ARH sipas Standardit ISO 9001:2008	Management Development Associates – MDA	12.10.2015	3,835.00 €
Dizajnimi dhe mirëmbajtja e Ueb Fages së ARH-së	N.SH. DataProgNet	13.10.2015	5,400.00 €
Shtypja kolor e Broshurave dhe Posterave	N.T.G. BLENDI	09.09.2015	530.00 €
Furnizim me Veshmbathje për stafin e ARH-së	N.Z.T. Kemi Tex	13.11.2015	2,737.00 €
Mirëmbajtja dhe servisimi i veturave zyrtare të ARH-së	HYUNDAI AUTO sh.p.k.	20.11.2015	2,595.00 € (për të gjitha njësitë)
Furnizim me material zyrtar të shtypur për nevojat e ARH-së	NTG BLENDI	16/11/2015	3,650.00 €
Ngritja (Upgrade) e Sistemeve Operative të Serverëve në Windows 2012 R2	TQ Enginnering	24.11.2015	950.00 €

5.9. KOMUNIKIMI ME PUBLIKUN DHE QASJA NË DOKUMENTE PUBLIKE

Me qëllim të planifikimit dhe koordinimit të Komunikimit me Publikun përmes bashkërendimit të planeve të komunikimit me planin vjetor të punës së Departamenteve të ARH-së, zbatimit të plotë të Ligjit 03/L-215, për Qasje në Dokumente Publike dhe Rregullores nr. 03/2011, për shërbimin e komunikimit qeveritar me publikun, ARH është e hapur me transparencë të plotë, gatishmëri për bashkëpunim me çdo mekanizëm, institucion apo organizatë që për qëllim ka ngritjen e nivelit të përgjegjësisë në Institucionet Publike.

Të dhënat lidhur me kërkesat:

Tabela 16: Numri i kërkesave të pranuara

Numri i kërkesave të pranuara			
Kërkesat	Qasja e lejuar	E refuzuar	E pjesshme
1	1	0	0

6. Puna gjatë vitit paraprak

6.1. Plani i punës 2016

Plani i Punës 2016 shërben për koordinimin e aktiviteteve të ARH-se dhe departamenteve përkatëse të tij, në mënyrë që të mundësohet përmbushja efikase dhe me kohë e synimeve dhe objektivave të përcaktuara. Prioritetet dhe synimet operative të përcaktuara me këtë plan janë në konsistencë me misionin e ARH-se dhe objektivat strategjike të tij që dalin nga autorizimet dhe përgjegjësitë ligjore të ARH-se të përcaktuara me ligjin e hekurudhave të Kosovës.

Objektivat strategjike të ARH-së janë përcaktuar me qëllim të arritjes së përmbushjes së planit, këto objektiva përfshijnë:

Tabela 17: Plani i punës 2016

Nr.	Veprimet (e planifikuara)	Periudha
1	Rregullorja për Metodat e përbashkëta të Sigurisë	K I
2	Finalizimi i draft-rregullores „Nënsistemet hekurudhore dhe kërkesat esenciale,,	
3	Përgatitja e pasqyrave financiare vjetore në bazë të LMFP-së	
4	Rregullore për Raportimin dhe monitorimin e tregut hekurudhorë	
5	Përgatitja dhe hartimi i Akteve nënligjore të nevojshme të ARH-së sipas ligjit të hekurudhave në pajtim me parimet e Direktivës të BE-së	K I - K IV
6	Shqyrtimi i aplikacioneve për licenca të makinistëve dhe aplikacioneve Licencë për operime për kompani ekzistuese dhe të reja	
7	Inspektimi i makinistëve të licencuar dhe përgatitja e raporteve të inspektimit të makinistëve	
8	Rregullat Nacionale të Sigurisë	
9	Shqyrtimi i aplikacioneve për certifikata/autorizime, autorizime për futje në shërbim për kompani ekzistuese dhe të reja	

10	Mbikëqyrja e implementimit të rekomandimeve nga inspektimi i mjeteve lëvizëse dhe infrastruktura hekurudhore gjatë vitit 2015	
11	Mbikëqyrja e implementimit të inspektimit të infrastrukturës hekurudhore pasi janë dhënë raportet me rekomandim për vitin 2015	
12	Pjesëmarrja në rastet e jashtëzakonshme departamenti i sigurisë në kuadër të ARH-së	
13	Autorizimet për futje në shërbim të mjeteve për mirëmbajtje sipas kërkesave për Interoperabilitet	
14	Regjistrimet e mjeteve të reja për mirëmbajtje pas marrjes së autorizimit për futje në shërbim	
15	Shqyrtimin e ankesave për tregun hekurudhor në transportin e mallrave si dhe për Të drejtat e udhëtareve	
16	Monitorimi i marrëveshjes për kompensimin e “Obligimeve të Shërbimeve Publike	
17	Monitorimi dhe kontrollimi i “Marrëveshjes mbi qasjes” në mese të Sh.a.Infrakos, dhe Sh.a. Trainkos	
18	Bashkëpunimi dhe koordinimi i të gjitha marrëveshjeve të nënshkruara me rregullator vendor dhe ndërkombëtar e në veçanti me IRG-Rail të Evropës	
19	Përgatitja e Barazimeve vjetore si dhe Përgatitja dhe dorëzimi i Qarkores buxhetore	K II
20	Zhvillimi dhe menaxhimi i procedurave të prokurimit për të gjitha nevojat e ARH-së, sipas planifikimit të prokurimit	
21	Azhurnimi i Regjistrimit të Makinistëve të Licencuar	
22	Përgatitja e broshurës për vendkalime	
23	Rregullore për të hyra dhe gjoba	
24	Mbikëqyrja e performancës së sigurisë për MI dhe NH	
25	Mbikëqyrja e implementimit të SMS- Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë-Infrakos-Trainkos	
26	Rregullorja për Caqet e përbashkëta të Sigurisë	
27	Finalizimi i Specifikacioneve Teknike për Interoperabilitet për Infrastrukturë 2011/275/EU	
28	Specifikacionet teknike për Interoperabilitet „Operimi dhe Menaxhimi i Trafikut,, për hekurudhe	

29	Përgatitja e dokumentit,, Libri i rregullave për makinistë,,	
30	Përgatitja e dokumentit „Libri i rrugëve,,	
31	Monitorimin e tregut hekurudhor në Kosovë, dhe përgatitjen e raportit te monitorimit të tregut Hekurudhor	
32	Inspektimi i te gjitha kalimeve ne nivel dhe vlerësimi i parametrave të sigurisë	K II - K III
33	Rregullorja për Autorizimin për futje ne shërbim te Infrastrukturës	K II - K IV
34	Inspektimi i infrastrukturës hekurudhore	
35	Sigurimin se pagesat e vendosura nga Menaxheri i Infrastrukturës janë transparente dhe jo diskriminuese	
36	Përgatitja e raportit vjetor të sigurisë	K III
37	Inspektimi i Sinjalizimeve në të gjitha linjat ekzistuese hekurudhore të cilat janë në përdorim dhe vlerësimi i parametrave të sigurisë	
38	Listimi i marrëveshjeve kontraktuale për operim dhe mirëmbajtje te kompanive hekurudhore me kompani brenda dhe jashtë vendit	
39	Monitorimi i Licencave të lëshuar TRAINKOS-it, NFRAKOS-it, RAILTRANS-it nga ARH, në veçanti sigurimet e kompanive	K IV
40	Inspektimi i mjeteve lëvizëse dhe vlerësimi i parametrave të sigurisë	
41	Përgatitja e raporteve të inspektimeve, dërgimi në Infrakos dhe Trainkos	
42	Organizimi i një workshopi ndërkombëtar për kalimet në nivel ose sinjalizimin	
43	Udhëzues për Implementimin e Specifikacioneve Teknike për Interoperabilitet për Lokomotiva dhe mjetet për pasagjerë	
44	Shënjimi i VKM ne numrit evropian ne mjetin lëvizës për mjetet e INFRAKOS-it, TRAINKOS-it dhe FERRONIKEL-it	
45	Inspektimi i regjistrimit nacional të mjeteve lëvizëse (përputhshmëria e mjeteve lëvizëse operuese me regjistrin nacional të mjeteve lëvizëse)	

6.2. Puna gjatë vitit paraprak

Gjatë vitit për të cilin është duke u raportuar ARH ka zhvilluar aktivitete të planifikuara në planin e punës 2015, detyra dhe kompetenca që parashihen në Ligjin për Hekurudhat e Kosovës 04/L-063 dhe punë të tjera që kanë rrjedhur gjatë vitit.

Tabela 18: Puna gjate vitit paraprak

REALIZIMI I PLANIT TË PUNËS PËR VITIN 2015							
Aktivitetet e planifikuara		Periudha				Statusi	Përfunduar Në Proces Pa Përfunduar
		K I	K II	K III	K IV		
1	Monitorimi i "Ekspozitës të Rrjetit 2015 dhe fillimi i procesit të konsultimeve për "Ekspozitën e Rrjetit 2016	KI	KII	KIII	KIV	E përfunduar	
2	Licencimi i Makinistëve. ARH ka përfunduar të gjitha obligimet ligjore për fillimin e këtij procesi, i cili kërkohet nga ligji i hekurudhave.	KI				E përfunduar	
3	Rregullat Nacionale të Sigurisë					Në proces	
4	Regjistrimi i mjeteve hekurudhore me pronësi të pa definuar të cilat gjenden në territorin e Republikës së Kosovës.	KI				E përfunduar	
5	Monitorimin e tregut hekurudhor në Kosovë.	KI	KII	KIII	KIV	E përfunduar	
6	Regjistrimet e mjeteve të reja hekurudhore dhe atyre të modifikuara	KI		KIII	KIV	E përfunduar	
7	Inspektimi i makinistëve		K II		KIV	E përfunduar	
8	Kryerjen e inspektimeve të Certifikatave të Sigurisë, si dhe Autorizimeve të Sigurisë		K II			E përfunduar	
9	Sigurimin se pagesat e vendosura nga INFRAKOS nuk janë diskriminuese.	KI	KII	KIII	KIV	E përfunduar	
10	Pergaditja e akteve nenligjore nga Departamentet profesionale konform Ligjit për Hekurudha dhe Direktivave të BE-së	K I				E përfunduar	

11	Specifikacionet teknike për Interoperabilitet „Operimi dhe Menaxhimi i Trafikut,					Pa përfunduar
12	Përgatitja e raportit vjetor të sigurisë			K III		E përfunduar
13	Përgatitja e raportit vjetor të monitorimit tregut		K II			E përfunduar
14	Mbikëqyrja e implementimit të rekomandimeve nga raporti i inspektimeve për vitin paraprak (Infrakos dhe Trainkos)	K I	K II	K III	K IV	E përfunduar
15	Organizimi i një workshopi ndërkombëtar për kalimet në nivel ose sinjalizimin			K III		E përfunduar
16	Inspektimi i regjistrimit nacional të mjeteve lëvizëse (përputhshmëria e mjeteve lëvizëse operuese me regjistrin nacional të mjeteve lëvizëse).				K IV	E përfunduar
17	Monitorimi i Licencave të lëshuar TRAINKOS-it dhe INFRAKOS-it nga ARH-, në veçanti sigurimet e kompanive etj. Një gjë e tillë kërkohet nga ligji i hekurudhave neni 22 paragrafi 1.					E përfunduar
18	Inspektimi i Mjeteve lëvizëse hekurudhore, vlerësimi i Sigurisë së tyre (Trainkos, Feronikel)			K III	K IV	E përfunduar
19	Inspektimi i infrastrukturës në menaxhim të Infrakos			K III	K IV	E përfunduar

6.3. Bashkëpunimi ndërinstytucional dhe aktivitetet e ARH-së në rrafshin vendor dhe ndërkombëtar

ARH ka bashkëpunuar ngushtë me institucionet tjera përgjegjëse vendore dhe ndërkombëtare për transportin hekurudhor në Republikën e Kosovës dhe ka ofruar përkrahje profesionale në mënyrë që i tërë sistemi rregullator dhe mbikëqyrës i shtetit të funksionojë i koordinuar dhe në përputhje me standardet dhe praktikrat më të mira ndërkombëtare.

Me datë 05-07/03/2015 ARH, ka marr pjesë në eveniment të rëndësishëm me ftesë nga EurasiaRail 2015, Mjetet Lëvizëse, Infrastrukturë dhe Logjistikë në Stamboll të Turqisë, ku kishim disa takime shumë të rëndësishme me përfaqësues të fushës së sektorit transportit hekurudhor të kompanive të shteteve nga vende të ndryshme pjesëmarrëse siç janë: Ministria e Transportit- Drejtoria e Përgjithshme e Rregullatorit të Hekurudhave



Fig.15 EurasiaRail 2015, Mjetet Lëvizëse, Infrastrukturë dhe Logjistikë

të Turqisë, TCDD, TFC- Rumani, Gredelj- Kroaci, Emre Ray- Turqi, Schwihog-Zvicër, Türolmas- Turqi, Tüdemsas- Turqi, Tüvasas- Turqi etj.

Në takimin të cilin e zhvilluam me Ministrinë e Transportit- Drejtoria e Përgjithshme e Hekurudhave të Turqisë dhe TCDD, biseda kryesisht u zhvillua në paraqitjen e gjendjes aktuale në të dy institucionet për punën e bërë, si dhe u paraqitën sukseset dhe të arriturat gjatë viteve të fundit, përkushtimin e ARH si Rregullator i këtij sektori në plotësimin e legjislacionit dhe të akteve nën ligjore si dhe një përshkrim i gjendjes nga hekurudhat e Kosovës nga ARH dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Hekurudhave të Turqisë.

Një takim i rëndësishëm ishte edhe me Drejtorin e Agjencisë së Hekurudhave të Bullgarisë, ku u diskutua rreth aktiviteteve të dy institucioneve dhe nevojës për bashkëpunim.

Në takime të ndryshme janë diskutuar tema të ndryshme nga përfaqësues shtetesh dhe kompani të ndryshme hekurudhore për zhvillimet në hekurudhat botërore, projektet kombëtare hekurudhore, përvojat në sistemin hekurudhor urban, problemet në transportin hekurudhor të udhëtarëve dhe mallrave dhe zhvillimet legislative hekurudhore.

Me datë 20/03/2015 ARH përmes një ceremonie zyrtare të organizuar ka bërë licencimin e 22 makinistëve të ndërmarrjes hekurudhore për operim me trena Trainkos Sh.A. Në këtë ceremoni zyrtare të pranishëm ishin: Përfaqësues nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, Komisioni Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, Ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Republikën e Kosovës; Kryeshefi Ekzekutiv i ndërmarrjes hekurudhore Trainkos si dhe përfaqësues të tjerë nga ARH, Trainkos, Ministria e Infrastrukturës, etj.



Fig.16 Ceremonia e Licencimit të makinistëve

Drejtori i Përgjithshëm i ARH-së, bëri një prezantim të punëve dhe të arriturve të ARH-së, pastaj kjo ditë u cilësua si ditë e rëndësishme për të gjithë makinistët të cilët u licencuan e sidomos për ndërmarrjen hekurudhore Trainkos pasi që për herë të parë në Kosovë po ndodh që të kryhet një proces i licencimit të makinistëve. Më tej, Drejtori i Përgjithshëm i ARH-së i përgëzoi të gjithë makinistët të cilët nga sot do të jenë të pajisur

me licenca për ushtrimin e profesionit të tyre ashtu siç parashihet në Ligjin për Hekurudhat e Kosovës dhe Rregulloren për Licencimin e Makinistëve.

Fjalë rasti gjatë kësaj ceremonie mbajti Ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar, ku foli për angazhimet e vendit të cilin ai përfaqëson për të dhënë kontribut në zhvillimin e sektorit hekurudhor në Kosovë, duke shprehur gatishmërinë për mbështetjen e pa rezervë për tërheqjen e investimeve për këtë sektor i cili ka rol të rëndësishëm edhe në zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Fjalë rasti mbajti edhe Përfaqësuesi i Kuvendit të Republikës së Kosovës, ku uroj makinistët për marrjen e licencave. Kurse anëtari i Bordit Drejtues të Trainkos-it, gjatë fjalimit të tij shprehi falënderimin në emër të Trainkos-it për ARH-në për angazhimin dhe përkushtimin maksimal si dhe bashkëpunimin korrekt që kanë treguar gjatë këtij procesi për licencimin e makinistëve. Ceremonia e licencimit të makinistëve përfundoi me shpërndarjen e licencave për makinistët nga Drejtori i Përgjithshëm i ARH-së dhe Ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar.

Me datë 23/03/2015 Drejtori i Përgjithshëm i ARH së bashku me disa zyrtar tjerë të ARH-së, kanë zhvilluar një takim bilateral në mes të ARH-së dhe Zyrës Federale të Transportit (FOT) dhe Organit për Rregullimin e Tregut Hekurudhor (RACO) në Bernë-Zvicër.



Fig.17 Takim bilateral ne mes ARH dhe FOT/RACO

Në këtë takim është diskutuar për organizimin dhe veprimtarin e institucionit të ARH-së detyrat e përgjegjësitë për Siguri dhe Rregullim të Tregut, legjislacionin në fuqi, rregulloret, udhëzimet administrative të cilat jemi duke i shfrytëzuar. Gjithashtu është diskutuar për infrastrukturën hekurudhore të Republikës së Kosovës, linjat të cilat

janë funksionale, linjat të cilat priten të funksionalizohen, mundësitë që ka sistemi hekurudhor i Kosovës për lidhje të sistemit hekurudhore me vendet e tjera të rajonit, gjatë prezantimit po ashtu është diskutuar dhe për të arriturat e institucionit të ARH-së konkretisht punët të cilat kanë përfunduar deri me tani dhe sfidat për të ardhme. Pastaj prezantimin e detajuar të punës dhe detyrave të FOT e bëri shefi i sektorit, i cili dha një historik të punës së Zyrës Federale të Transportit, aktiviteteve dhe obligimeve të cilat janë paraparë me ligjin për transport hekurudhor në Zvicër. Përshkrimin e aktiviteteve dhe procesit të mbikëqyrjes nga ana e FOT, i cili sqaroi në mënyrë të detajuar këtë proces, për lëshimin e certifikatave dhe autorizimeve të sigurisë bazuar në sistemin për menaxhimin e sigurisë, ku pati sqarime se si FOT procedon gjatë marrjes dhe vlerësimit të aplikimit për certifikatë dhe autorizim të sigurisë.

Ndërsa me Komisionin e Arbitrazhit Hekurudhor (Railway Arbitration Commission-RACO) është diskutuar rreth qasjes së hapur dhe jo diskriminuese në sektorin e hekurudhave, me detyrën për të vepruar si një gjykatë e specializuar për te vendosur mbi ankesat dhe llogaritjen e çmimit, mbrojtjen e interesave të qytetarëve dhe aktereve të tregut hekurudhor. Gjithashtu për monitorimin dhe sigurimin e qasjes jodiskriminuese në rrjetin hekurudhor nëpërmjet apelimeve dhe ankesave ligjore.

Po ashtu kemi kryer inspektimin e vagonëve të mallrave i cili inspektim u krye në portin e Baselit, aty u njoftuam në mënyrë detale për metodat e inspektimit, formën e përzgjedhjes së vagonëve që do të inspektohen si dhe masat e ndërmarra pas inspektimit. Kjo ishte një përvojë shumë e vlefshme për ne pasi që marrë parasysh se edhe ne jemi përgjegjës për inspektimin e vagonëve të mallrave morëm një përvojë e cila do të na shërbejë për avancimin e punës tonë në teren si dhe ndikon direkt në ngritjen e kualitetit të inspektimit.



Fig.18 Inspektimi i vagonëve të mallrave

Me datë 14-15/04/2015 ARH ka marrë pjesë në takimin plenar të IRG-Rail (Independent Regulatory Group - Rail) në Hagë Holandë.

Në këtë takim u diskutuar lidhur me udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e rregullatorëve dhe mjeteve lëvizëse si dhe u diskutua për paketën e katërt hekurudhore. Gjithashtu u diskutua gjerësisht lidhur me tarifat dhe praktikën e tarifimit si dhe roli i organeve rregullative në këtë proces, si dhe lidhur me aktet ligjore që do të përgatiten për aplikimin e kostove direkte. Pas kësaj u diskutua lidhur me aktivitetet e grupit për metodat e tarifimit për shërbimet e mirëmbajtjes të cilat ofrohen si dhe lidhur me mundësinë e harmonizimit të këtyre tarifave.

Në vazhdim u diskutua edhe për raportin e tretë të monitorimit të tregut si dhe u paraqiten rezultatet për të dhënat e ofruara nga secili shtet anëtar i IRG-Rail.

Temë tjetër e takimit ishte edhe kooperimi ndërmjet rregullatorëve hekurudhorë të cilat janë diskutuar me Komisionin Evropian.

Po ashtu u paraqitën të arriturat dhe aktivitetet e secilit shtet veç e veç prej takimit të fundit plenarë e deri në këtë takim, ne paraqitëm aktivitetet e ARH-së respektivisht të rregullimit të tregut në Kosovë, me theks të posaçëm u ndalëm në sqarimin se janë nënshkruar PSO kontratat, është bërë monitorimi i implementimit të Ekspozitës të rrjetit, është përgatitur raporti vjetor për monitorimin e tregut, jemi në proces të organizimit të një Punëtorie për të drejtat e udhëtarëve.

Pas këtyre diskutimeve kishte diskutime edhe me disa përfaqësues të menaxherëve të infrastrukturës dhe operatorëve me trena të cilët i paraqitën qëndrimet e tyre lidhur me aplikimin e PSO kontratave, përgatitjen e qasjes në rrjet aplikimin e shpenzimeve direkte etj.

Pas kësaj paraqitje të këtyre personave nga kompanitë hekurudhore kishte shumë pyetje dhe përgjigje lidhur me temat e diskutuara në takimin e parë plenarë të IRG-së për vitin 2015.



Fig.19 Takimi plenar i IRG-Rail

Me datë 07-08/05/2015 Podgoricë, Mali i Zi, me datë 18-19/06/2015 Tiranë, Shqipëri dhe me datë 15-16/10/2015 Zagreb, Kroaci, janë mbajtur takimet SEETO-së, grupit punues të hekurudhave, ku agjenda ishte formulimi i strategjisë për krijimin e një zone të vetme Evropiane hekurudhore sipas Ligjeve dhe Direktivave të BE-së, në kuadër të kësaj agjende u prezantua nga ana e eksperteve të SEETO-s si dhe prezantimet e përfaqësuesve të shteteve pjesëmarrëse. Në këto takime u diskutua për llogaritjet dhe mbikëqyrja e kostos direkte sipas legjislacionit më të ri Evropian, mbikëqyrja e cilësisë së kontratave të shërbimeve publike sipas përvojave të disa regjioneve të Gjermanisë, regjistrimet dhe mbikëqyrjet e marrëveshjeve ndërkufitare në transportin hekurudhor, si dhe u diskutua për disa aktivitete të Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Evropën (UNECE) në transportin hekurudhor.



Fig.20 Takimet e SEETO-s

Në këto takime ishin përfaqësuesit e të gjitha vendeve të rajonit, përkatësisht anëtarët e SEETO-s siç janë: Kosova, Shqipëria, Bosnje Hercegovina, Maqedonia, Mali i zi, Serbia dhe Kroacia si dhe Ekspert ndërkombëtar në fushën e hekurudhave.

Me datë 28/08/2015, Takim me Institutin e Transportit të Shqipërisë, ku jemi takuar me përfaqësuesit e këtij institucioni të cilët janë përgjegjës për përgatitjen e projekteve dhe studimeve në fushën e transportit duke përfshirë edhe atë të transportit hekurudhor. Në takim u bisedua për ngritjen e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve relevante për rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional me qëllim avancimin e punës dhe të sektorit në përgjithësi.

ARH prezantoi gjendjen e sektorit hekurudhor në tërësi siç janë: Punët të cilat ARH i ka kryer deri me tani në Siguri, Interoperabilitet, Rregullim të Tregut dhe Licencim, si dhe paraqiti një histori të shkurtër të Hekurudhave të Kosovës që nga themelimi e deri me tani, u tregua procesi i ndarjes së Hekurudhave të Kosovës në dy kompani Infrakos dhe Trainkos, u tregua se si e kemi bërë Licencimin e kompanive, procesin e dhënies së Autorizimit të Sigurisë dhe Certifikatës së Sigurisë, Regjistrimin e Infrastrukturës, Regjistrimin e Mjeteve Lëvizëse, Autorizimin për Futjen në Shërbim, shpjeguar edhe rrjedhën e procesit të aprovimit të Ekspozeut të Rrjetit etj.

Me datë 29/08/2015, Takim me Drejtorinë e Inspektoratit hekurudhor DIH në Durrës, Gjithashtu edhe në këtë takim u bisedua për ngritjen e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve relevante ARH dhe DIH.

Drejtori i Inspektoriatit bëri një përshkrim të shkurtër të punës së Drejtorisë së Inspektimit Hekurudhor të Republikës së Shqipërisë, ku tregoi për detyrat dhe obligimet të cilat i ka ky institucion: kontrollin e zbatimit të dispozitave të Kodit Hekurudhor. Drejtoria e cila është në vartësi të ministrisë që mbulon transportet, ka për detyrë kontrollin e zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore si dhe garantimin e zbatimit të rregullave për mbrojtjen, mirëmbajtjen, remontin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës hekurudhore, lëvizjen e sigurve të trenave, kontrollin teknik të mjeteve lëvizëse gjatë shfrytëzimit të tyre si dhe të gjitha procedurat e ndjekura gjatë pranimit për shfrytëzim të mjeteve hekurudhore. Drejtori i përgjithshëm i ARH bëri një prezantim të punës së ARH si dhe paraqiti gjendjen e sektorit hekurudhor në tërësi. Takimi ishte shumë interaktiv me shumë pyetje nga të dy palët për rrjedhën e proceseve, sfidave në të kaluarën si dhe ato të së ardhmes. Po ashtu u realizuar një vizitë në stacionin hekurudhor në Elbasan ku patëm mundësi të njihemi më për se afërmi me gjendjen në stacion si atë të infrastrukturës: sinjalizimit, ndërueseve, binarëve, balastit, traversave si dhe me qendrën e kontrollit.



Fig.21 Takim me Institutin e Transportit të Shqipërisë

Ky takim ishte një rast i mirë për të ndarë përvojat praktike dhe legislative në fushën e sektorit hekurudhorë ndërmjet dy institucioneve relevante dhe u tregua një gatishmëri e të dy institucioneve që të bashkëpunojnë në këtë sektor duke i ofruar njëra tjetrës gjithë mbështetjen e nevojshme për sfidat që mund të paraqiten në të ardhmen.

Me datë 24-25/09/2015 Takim i Grupit punues i Sektorit për Zhvillimin e Ekspertizave Hekurudhore në Akademinë Norvegjeze të Hekurudhave (Director of the Norwegian



Fig.22 Takim i Grupit punues i Sektorit për Zhvillimin e Ekspertizave Hekurudhore në Akademinë Norvegjeze të Hekurudhave

Rail Academy) të përkrahur nga UIC (Unioni Internacional i Hekurudhave Botërore). Në këtë takim u diskutua për ERTMS (European Rail Transport Management System)/ETCS (European Train Control System), nga Autoritetet Hekurudhore Norvegjeze, Gjermane, Franceze Angleze, Italiane, Portugale, Polake, Spanjolle, Austriake, Holandeze dhe Kosovare dhe janë paraqitur sfidat me të cilat janë ballafaquar gjatë implementimit. Në vazhdim u krijuan disa grupe të vogla punuese të cilat zhvilluan një trajnim për: Shërbimet ndaj Konsumatorëve dhe simulimi në Simulator për vozitës të trenave (makinist), ERTMS/ETCS.

Akademia Norvegjeze e Hekurudhave na ofroi një vizitë në qendrën Simuluese (voztës trenave dhe sinjalizimi) si dhe u dhanë sqarime praktike për ERTMS, ATC dhe EL-Craft

simulimi, gjithashtu u njoftuam edhe me sistemin e sinjalizimit i cili ishte një trajnim praktik.

Në vazhdim u mbajtën dy trajnime paralele njëra për ERTMS/ETCS-trajnim në qendrën simuluese, pra simulimi i vozitjes së trenave si në kushte reale, si dhe kultura e sigurisë hekurudhore dhe trajnimi, u diskutuan disa raste reale.

Nga ekspertët e Akademisë së hekurudhave Norvegjeze u prezantua tema Siguria dhe komunikimi dhe sinjalizuesit, kontrolli i kualitetit, devijimi nga proceset menaxhuese dhe përmirësimi i vazhdueshëm në Akademinë Norvegjeze të hekurudhave.

Me datë 04-06/11/2015 Kemi marrë pjesë në takim ekspertesh të organizuar Zyra Federale e Transportit (Federal Office of Transport-FOT) të Zvicrës, në këtë takim morën pjesë ekspert nga: Zvicra, Kosova, Gjermania, Franca, Italia, Belgjika, Luksemburgu dhe



Fig.23 Takim me Zyrën Federale të Transportit të Zvicrës

Holanda. Fillimisht u prezantua një historik i punës së Zyrës Federale të Transportit, aktiviteteve dhe obligimeve të cilat janë paraparë me ligjin për transport hekurudhor në Zvicër. Kontrollimi i mjeteve lëvizëse nga ana e FOT, i cili e sqaroi në mënyrë të detajuar këtë proces. Pastaj u prezantuan aktivitetet nga SBB Cargo AG “Kualiteti, Siguria dhe Mbrojtja e Natyrës”, ku pati sqarime se si SBB Cargo procedon gjatë kontrollit të vagonëve të mallrave.

Nga ARH, u prezantua gjendja e Infrastrukturës të hekurudhave të Kosovës si dhe procesin e mirëmbajtjes të mjeteve lëvizëse, planet e zhvillimit të sektorit hekurudhore për vitet 2016-2020, ku sqaruam se parashikohet që gjatë këtyre viteve të kemi një

investim më të madhe në modernizimin dhe shtimin e linjave hekurudhore, si dhe prezantimet tjera nga ekspertet e vendeve pjesëmarrëse në këtë takim.

Gjithashtu të gjithë pjesëmarrësit morën pjesë edhe në inspektimin e vagonëve të mallrave i cili inspektim u krye në portin e Bazelit (Muttentz), aty u njoftuam në mënyrë të detajuar për metodat e inspektimit, formën e përzgjedhjes së vagonëve që do të inspektohen si dhe masat e ndërmarra pas inspektimit. Gjithashtu nga shefi i ndërrimit të mirëmbajtjes u njoftuam se si klasifikohen vagonët e mallrave dhe cilat janë procedurat të cilat ndiqen gjatë mirëmbajtjes- riparimit. Kjo ishte një përvojë shumë e vlefshme për ne pasi që marrë parasysh se edhe ne jemi përgjegjës për inspektimin e vagonëve të mallrave morëm një përvojë e cila do të na shërbejë për avancimin e punës tonë në teren si dhe ndikon direkt në ngritjen e kualitetit të inspektimit.

Me datë 11-12/11/2015 ARH ka marrë pjesë në takimin plenar të IRG-Rail (Independent Regulatory Group - Rail) në Rotterdam të Holandës.

Në këtë takim u prezantua dhe diskutua lidhur me udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e rregullatorëve dhe mjeteve lëvizëse si dhe u diskutua për paketën e katërt hekurudhore.



Fig.24 Takim plenar IRG-Rail

Gjithashtu u diskutua gjerësisht lidhur me prezantimin e procedurave për marrjen e vendimeve nga ana e rregullatorëve hekurudhore.

Takimi vazhdoi me diskutimin për Rregulloren për korridorin e mallrave Rregullore 913/2010, ku edhe u votua propozimi. Në vazhdim u diskutua lidhur me mbikqyrjen e transportit ndërkombëtar të udhëtarve dhe ketë për distanca të gjata.

Prezantimi në vazhdim ishte nga nëngrupi për monitorim të tregut ku u paraqit udhëzimi për ketë monitorim dhe u votua. Temë tjetër e takimit ishte edhe metoda e tarifimit si dhe adoptimi i raportit, si dhe principet e pagesave për stacionet e udhëtarëve. Gjithashtu një temë me rendësi ishte edhe tarifimi i tarifave të shërbimeve të mirëmbajtjes ku edhe u votua raporti. Në ditën e dytë u paraqitën të arriturat dhe aktivitetet e secilit shtet veç e veç prej takimit të fundit plenarë, ne paraqitëm aktivitetet e ARH-së respektivisht të rregullimit të tregut në Kosovë. Në ketë takim u votua edhe për zgjedhjen e zëvendësit të kryesuesit për vitin 2016, ku u zgjodh përfaqësuesi nga Franca.

7. Raportimi rreth adresimit të rekomandimeve të zyrës së auditorit të përgjithshëm

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) ka kryer auditimin e pasqyrave vjetore financiare të ARH-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014. Ky auditim është fokusuar në pasqyrat vjetore financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm (duke përfshirë menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit). Në raportin e ZAP, në konkluzionin e përgjithshëm, thuhet se Menaxhmenti i ARH-së kishte dizajnuar një sistem të mirë të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar. Kontrollet efektive kanë siguruar që menaxhimi i buxhetit të behët në pajtueshmëri me parimet e mirëfillta të menaxhimit financiar. Adresimi i rekomandimeve ishte në një nivel të mirë. Kjo tregon gatishmërinë e menaxhmentit për të përmirësuar kontrollet në vazhdimësi.

Për vitin 2015 buxheti fillestar i ARH-së ishte 325,421.00 €, mirëpo pas shkurtimit të buxheti final nga Ministria e Financave buxheti final për vitin 2015 ishte 245,814.00 €, ndërsa realizimi buxhetor ishte 237,902.86 €, realizimi i buxhetit në përqindje ishte 97%.

8. Shtojcat

8.1. SHTOJCË I

8.1.1. Korniza ligjore e BE-së e aplikueshme për sektorin e Hekurudhave

Licencimi:

- Direktiva e BE-së 91/440 për Zhvillimin e Hekurudhave të BE-së,
- Direktiva e BE-së 95/18 për Licencimin e Ndërmarrjeve Hekurudhore,
- Direktiva e BE-së 2007/59 për Licencimin dhe Certifikimin e Makinistëve.

Siguria:

- Direktiva e BE-së 2004/49 për Sigurinë e Hekurudhave,
- Rregullorja e BE-së 653/2017 për Procedurat e Marrjes së Certifikatës së Sigurisë.

Rregullimi i Tregut:

- Direktiva e BE-së 2011/14 për Çmimet dhe Qasjen në Binarë,
- Direktiva e BE-së 2012/34 për Krijimin e Hapësirën Unike Evropiane të Transportit Hekurudhor,
- Rregullorja e BE-së 1370/2007 për Kontratën e Shërbimeve Publike.

Interoperabiliteti:

- Direktiva e BE-së 2008/57 për Interoperabilitet,
- Specifikacionet Teknike për Interoperabilitet STI.

8.2. SHTOJCË II

8.2.1. Përshkrimi i Hekurudhave të Kosovës

Hekurudhat e Kosovës shtrihen në tërë territorin e Kosovës me një gjatësi prej 333,451 km. Në këtë gjatësi nuk përfshihen vijat industriale të cilat kapin gjatësinë prej 103,4 km. Vija e parë hekurudhore në Kosovë është ndërtuar në vitin 1874 në relacionin Hani i Elezit – Fushë Kosovë – Mitrovicë. Më vonë ka filluar dhe është kryer ndërtimi i rrjetit ekzistues hekurudhor nëpër tërë territorin e Kosovës. Vijat hekurudhore bëjnë lidhjen e të gjitha qendrave më të rëndësishme të Kosovës, përveç Gjakovës dhe Gjilanit. Vijat e hekurudhave të Kosovës kanë lidhje të drejtpërdrejt edhe me shtetet fqinje si me Maqedoninë e Serbinë dhe përmes tyre edhe me shtetet e tjera.

Hekurudhat e Kosovës kryesisht ndahen në dy linja:

Linja Veri - Jug:

Që përshkon vendin nga kufiri me Serbinë (Stacioni Leshak) deri në kufirin me Maqedoninë (Stacioni Hani i Elezit), me gjithsejtë 148 km në linjën bazike hekurudhore 10 të SEETO-s. (Linjë funksionale).

Linja Verilindje deri në Perëndim:

Që përbëhet nga tri degë:

- **Linja Lindore** nga kufiri me Serbinë (Stacioni Podujevë) deri në Fushë Kosovë me gjithsejtë 45 km gjatësi,
 - Fushë Kosovë – Bardhosh 15 km (Linjë funksionale),
 - Bardhosh-Podujevë 30 km (Linjë jo -funksionale),
- **Linja Perëndimore** nga Fushë Kosova deri në Pejë me gjithsejtë 81 km gjatësi (Linjë funksionale),
- **Linja Jug- Perëndim** nga Klina deri në Prizren me gjithsej 58 km gjatësi,
 - Klinë – Xërxe 35 (Linjë funksionale),
 - Xërxe – Prizren 32.5 (Linjë jo-funksionale).

Që nga 01/09/2011 Hekurudhat e Kosovës veprojnë ndaras si dy kompani publike


- Infrastrukturën e Hekurudhave të Kosovës- INFRAKOS dhe
- Operimin me Trena të Hekurudhave të Kosovës TRAINKOS.

8.2.2. Harta e Hekurudhave të Kosovës



8.3. SHTOJCË III

8.3.1. Raporti Mbikëqyrja e Implementimit të Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë (SMS) nga Infrakos.



Afrim Mehmetaj

Datë: 10/06/2015

Përmbledhje:

Bazuar në ligjin Nr. 04/L-063, neni 100 paragrafët 1,2,3,4, neni 103 dhe neni 104 paragrafi 2 për hekurudhat në Republikën e Kosovës, Rregullores së ARH-së Nr. 03/2013 Metodën e Përgjithshme të Sigurisë për Mbikëqyrje nga Organi Përgjegjës i Sigurisë pas lëshimit të një Certificate apo Autorizimi të Sigurisë, Direktivës së sigurisë 2004/49/EC nenet 4, 9 dhe aneksi III. Departamenti i Sigurisë ka filluar procesin e mbikëqyrjes së implementimit të Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë (SMS) nga ana e Menaxherit të Infrastrukturës Infrakos datë: (18-22).05.2015.

Qëllimi i këtij procesi të mbikëqyrjes së implementimit të SMS ka qenë që të sigurohemi se Infrakos e ka vendosur Sistemin për Menaxhimin e Sigurisë dhe ky sistem plotëson kërkesat e sigurisë dhe përmban elementet të cilat kanë të bëjnë me sigurinë e sistemit hekurudhor në Kosovë.

Ne gjatë mbikëqyrjes së implementimit të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë (SMS) kemi mbajtur takime me të gjithë personat përgjegjës nga departamentet të cilët janë përgjegjës për mirëmbajtjen e sigurisë hekurudhore siç janë:

- Zyra e Auditimit të Brendshëm,
- Kontrollor i Brendshëm,
- Zyra për Standarde dhe Siguri (Zyrtari për Siguri),
- Sektori për Shkollim dhe Mbrojtje në Punë,
- Departamenti i Komunikacionit,
- Departamenti i Mirëmbajtjes së Linjave Hekurudhore dhe
- Departamenti i Elektroteknikës.

▪ ZYRA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Sipas zyrtarit për Auditim të brendshëm në Infrakos, kjo zyre bazuar në detyrat e punës të cilat i ka të përshkruara nuk janë përgjegjëse për auditimin e sigurisë por kjo zyre është përgjegjëse për kontrollin e blerjeve, punë kjo që hyn në pjesën e SMS për kontrollin e furnizuesve dhe nën kontraktorve. Kjo zyre gjatë vitit 2014 ka kryer auditivin e pesë (5) blerjeve nga furnitor të ndryshëm. Në mesin e blerjeve të audituara janë: furnizimi me traversa, furnizimi me kamionët të kombinuar e cila lëvizë në rrugë dhe hekurudhë, furnizimi me balast, eskavator dhe riparimi i tunelit në Prishtinë. Nga kjo zyre morëm një propozim që të ketë një zyrtar i cili do të merrej me monitorimin (auditimin) e sigurisë.

▪ KONTROLLOR I BRENDSHËM

Kontrollori i brendshëm i përgjigjet direkt kryeshefit ekzekutiv të Infrakos-it, merr detyra dhe raportin të kryeshefi lidhur me zhvillimet në fushën e sigurisë. Gjatë vitit të kaluar kontrollori i brendshëm ka kryer disa kontrole të linjave, sinjalizimit, bazamentit të hekurudhës, ndërrueseve, traversave, shenjat hektometrike dhe kilometrike, vendkalimet ilegale, gjendjes nëpër stacione, ndriçimit në stacione etj, këto raporte në formë të shkruar i dërgohen kryeshefit ekzekutiv, raportet dorëzohen në baza ditore, javore, mujore dhe vjetore. Sipas Kontrollorit të brendshëm ka një neglizhim të ndarja e përgjegjësi dhe e llogaridhënies sa i përket sigurisë, gjithashtu raportet për ngjarjet e jashtëzakonshme nuk shkojnë edhe të kontrollori i brendshëm. Sa i përket implementimit të Manualit të Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë (SMS) dhe Deklaratave të Konformitetit (DK) nga ana e Kontrollorit të brendshëm ato pjesërisht janë të implementuara, nuk ka pasur ndonjë trajnim shtesë në mënyrë që të njoftohet me SMS dhe DK.

▪ ZYRA PËR STANDARDE DHE SIGURI (ZYRTARI PËR SIGURI)

Zyra për Standarde dhe Siguri gjatë vitit 2014 ka kryer inspektimin e linjave, përgatitur raportin vjetor të sigurisë për vitin 2013, përgatitjen e posterëve si dhe ka marrë pjesë në kampanjën e vetëdijesimit të qytetarëve për sigurinë në komunikacionin hekurudhor. Në pyetjen se cilat janë jo konformitetet të cilat ai i ka vërejtur gjatë punës ai thotë: Te formularët kemi mangësi të plotësimit të formularëve psh. Përdoren shkurtime fjalish dhe shkrimi i dobët (nganjëherë edhe i pa lexueshëm), mungesa e rekomandimeve të sigurisë nga operatori me trenat Trainkos, mungesa e komunikimit me Trainkos për çështje të sigurisë, mungesa e një personi përgjegjës për siguri nëpër departamente. Ka mungesë të shpërndarjes së informacionit, mungesë të trajnimit të kuadrove të reja për hulumtimin e aksidenteve. Sektori për Standarde i merr raportet e rregullta mujore për ngjarjet e jashtëzakonshme. Duhet të ketë një ngritje të vetëdijesimit për çështje të sigurisë dhe mbrojtjes në punë, pra të ndryshojë qasja e menaxhmentit dhe e personelit të Infrakos ndaj SMS dhe DK. Sektori për Standarde dhe Siguri ka informata të mira sa i përket SMS dhe DK, sipas tyre SMS dhe DK janë shpërndarë me kohë të udhëheqësit e sektorëve dhe departamenteve.

▪ SEKTORI PËR SHKOLLIM DHE MBROJTJE NË PUNË

Sektori për shkollim dhe mbrojtje në punë janë themeluar në shtator të vitit 2014 dhe ende nuk janë kompletuar me staf ka mungesë të një zyrtari për mbrojtjen në punë, pra janë një sektor i ri por i cili ka përgjegjësi të cilat lidhen me shkollimin, mbrojtjen në punë dhe kujdesin shëndetësor të punëtorëve. Ky sektor ka mbajtur trajnimin (shkollimin) për 64 drejtues trenash, 32 ndërrues të binarëve dhe 6 rojtar të vendkalimeve të pa mbrojtura. Gjatë punës së tyre iu referohen udhëzimit për shkollim dhe rregullores për kontroll shëndetësor. Sa i përket

procedurave për lëndime ne punë ekziston një procedure e tillë ne rast se punëtori lëndohet në vendin e punës, kutit e ndihmës se pare ekzistojnë ne të gjitha stacionet, alarmi kundër zjarrit nuk është funksionale ne asnjë objekt, sa i përket planeve emergjente kompania posedon një plan të tillë, shenjat për dalje nga objektet ne raste të jashtëzakonshme nuk ekzistojnë, nuk ka asnjë njoftim për detyrat e secilit ne raste të jashtëzakonshme, ka një procedure ne fuqi për sëmundje dhe lëndime në punë. Lidhur me njohuritë e menaxhmentit nga ky sektor për SMS dhe DK ato janë sipërfaqësore, si dhe nuk kanë pasur ndonjë trajnim për SMS dhe DK. Sektori për shkollim dhe mbrojtje në punë duhet të ketë njohuri për SMS dhe DK, sepse në deklaratën FO_DK_14 është e specifikuar se ekzistojnë procedura për programet e trajnimit dhe sistemi për të siguruar se ruhet kompetenca e personelit dhe detyrat të cilat duhet të kryhen në përputhje me rrethanat.

▪ DEPARTAMENTI I KOMUNIKACIONIT

Ne departamentin e komunikacionit janë kryer disa trajnime për CTC, gjithashtu më herët rreth 112 punëtor janë trajnuar nga ky departament, por nuk ka pasur trajnime shtesë për shkak te mungesës se kuadrove profesionale. Sipas menaxherëve të departamentit ka mungesë të stafit si p.sh. manovrues të ndërrueseve, drejtues të trenave etj. Sa i përket punëtorëve te cilët marrinë pjese drejtpërsëdrejti ne sigurinë hekurudhore ka disa mangësi sa i përket pajisjeve për mbrojtje në punë. Nuk ka pasur ndonjë iniciativë qe të bëhet matja e sasisë së alkoolit në gjak të personat përgjegjës për sigurinë, pasi qe ky është njëri nder parametrat që mundëson zhvillimin e sigurt të komunikacionit hekurudhorë. Sa i përket disa vendkalimeve disa nga to edhe pse janë te rrezikshme nuk janë të siguruara, po ashtu gjendje aspak e mire nuk qëndron as te sistemi i sinjalizimit. Sa i përket njohurive për SMS dhe DK nga ky departament kanë njohuri të përgjithshme dhe thonë se janë të njoftuar dhe se ketë e kanë shpërndarë edhe të stafi tjetër brenda departamentit. Departamenti i Komunikacionit duhet qe të rrisë vetëdijen të punëtorët e vet për nevojën e përdorimit të pajisjeve për mbrojtje në punë.

▪ DEPARTAMENTI I MIRËMBAJTJES SË LINJAVE HEKURUDHORE

Departamenti i MLH është themeluar në vitin 2013, brenda departamentit ekzistojnë dy shërbime ai i shërbimi i mirëmbajtjes si dhe shërbimi i mekanizimit, si dhe 5 njësi duke përfshirë edhe Leposaviqin. Departamenti i mirëmbajtjes ka plane ditore, javore dhe mujore, punët te cilat i kryen departamenti i mirëmbajtjes janë: ndërrimi i traversave, pastrimi i profileve, rregullimi i binarit etj, sa i përket kontrolleve vizuale ato bëhen me mjete lëvizëse dhe kane te bëjnë me drejtimin, ramjet e hekurudhës, gjerësinë, stabilitetin të gjitha këto të dhëna ruhen ne vagonët matës, po ashtu ne vazhden e aktiviteteve të mirëmbajtjes bëhet edhe kontrollimet e urave dy here ne vit. Në kuadër të DMLH janë të angazhuar 117 punëtorë duke përfshirë edhe ata sezonal. Trajnim (shkollim) për SMS dhe DK ky departament nuk ka pasur, si dhe njohuritë për SMS dhe DK janë sipërfaqësore, marrë parasysh se është departament i ri i

themeluar duhet qe sektori për shkollim dhe mbrojtje në punë në bashkëpunim me kontrollorin e brendshëm dhe sektorin për standarde dhe siguri të organizojnë trajnime për SMS. Departamenti i Mirëmbajtjes së Linjave Hekurudhore gjithashtu duhet qe të rrisë vetëdijen të punëtorët e vet për nevojën e përdorimit të pajisjeve për mbrojtje në punë.

▪ DEPARTAMENTI I ELEKTROTEKNIKËS

Departamenti i Elektroteknikës ka 22 punëtor përgjegjës për ofrimin e shërbimeve të sigurisë në transportin hekurudhor. Departamenti i elektroteknikes ofron shërbim te sigurisë, siç është bartja e informatave prej dy kanaleve alternative, realizimi i komandave te cilat janë te inkorporuar në një sistem. Secili stacioni ka ne shfrytëzim katër lidhje telefonike, lidhjen e hapur, lidhjen e mbyllur, lidhjen në mes të stacioneve si dhe lidhjen konferenciale e cila bën te mundur qe komunikimi të bëhet me të gjitha stacionet. Sa i përket mirëmbajtjes se radiolidhjeve të lokomotivave ato mirëmbahen nga Infrakosi konkretisht nga departamenti i elektroteknikes, trajnim për përdorim te radiolidhjes nuk ka pasur. Sa i përket trafostacioneve dhe ndriçimit në stacione ekzistojnë 14 trafo stacione, ne Mitrovicë dhe Gurëz ka një tension me të ulet të energjisë elektrike. Kurse për ndriçimin në stacioneve vlen te theksohet se stacioni në Miradi nuk ka ndriçim për shkak të defektit në kabllon kryesore. Ky departament ka bërë kërkesë për blerjen e pajisjeve për sigurimin e 10 vendkalimeve, kjo deri me tani nuk është realizuar. Sipas tyre nuk ka një shpërndarje të buxhetit sipas prioriteteve sepse shumë projekte të tyre nuk kanë gjetur përkrahjen e duhur. Kanë pasur disa herë kërkesa për trajnimin e stafit profesional, këto kërkesa nuk kanë gjetur përkrahjen e duhur nga ana e menaxhmentit. Departamenti i Elektroteknikës duhet që të rrisë vëmendjen për mbrojtjen në punë të punëtorëve, duke e ditur natyrën e punës brenda departamentit, vendet me rrezikshmëri të lartë nga tensioni duhet gjithsesi të jenë të shënuara në vende të dukshme. Departamenti i Elektroteknikës ka informata për SMS dhe DK, janë të njoftuar me detyrat dhe obligimet e sigurisë që rrjedhin nga manuali i SMS dhe DK, por këto informata duhet të përcillen edhe te stafi tjetër përgjegjës për sigurinë.

Rekomandim:

Rekomandimet e më poshtme vlejné pothuajse për të gjithë sektorët dhe të gjitha nivelet e menaxhmentit të Infrakos-it, ne nuk kemi paraqitur në mënyrë specifike se cilat departamente apo sektor qëndrojnë me mirë apo me keq, por në një farë mënyrë nivelin e implementimit të manualit të SMS dhe DK e kemi sqaruar më lartë për secilin departament veç e veç.

1. Menaxhmenti i Infrakos-it duhet të jetë i përkushtuar që politikat e sigurisë, SMS dhe DK të implementohen në tërësi ashtu siç janë paraparë në Manualin e SMS,
2. Sistemi i menaxhimit të sigurisë duhet të dokumentohet në të gjitha pjesët relevante dhe duhet të përshkruaj ndarjen e rolit dhe përgjegjësiive, llojin e shërbimeve, vlerësimin e rrezikut etj. siç e keni paraqitur në deklaratën FO_DK_05,

3. Shpërndarja e përgjegjësi të bëhet tek të gjithë personat përgjegjës për siguri ashtu siç e keni paraqitur në deklaratën FO_DK_06,
4. Sigurimi i kontrollit në të gjitha nivelet e menaxhmentit të bëhet ashtu siç e keni paraparë në deklaratë FO_DK_07,
5. Politika e sigurisë e duhet të shpërndahet të i gjithë stafi përgjegjës për siguri ashtu siç është paraparë në FO_DK_10,
6. Ka pasur një monitorim (auditim) të pjesshëm të sigurisë, monitorimi duhet të kryhet dhe të dokumentohet në baza të rregullta ashtu siç e keni paraparë në deklaratën e konformitetit FO_DK_19,
7. Organizimi i trajnimit (shkollimit) për SMS dhe DK në të gjitha nivelet e Infrakos-it përgjegjëse për siguri, ku personat përgjegjës për shkollim së bashku me menaxherët e secilit sektor do të organizonin trajnimin për stafin e tyre, por gjithmonë me pjesëmarrjen e kontrollorit të brendshëm dhe sektorit për standarde dhe siguri,
8. Të ketë një rritje të komunikimit dhe koordinim me të mirë ndërmjet Departamenti të Komunikacionit, mirëmbajtjes së linjave hekurudhore, elektroteknikës me kontrollorin e brendshëm dhe sektorin për standarde dhe siguri,
9. Raportet për rastet e jashtëzakonshme do të duhej të dërgohen edhe të kontrollori i brendshëm dhe sektori për standarde dhe siguri,
10. Secili departament apo sektor duhet të ketë të emëruar një person përgjegjës për siguri,
11. Zbatimi i me rigoroz i rregullores për mbrojtjen në punë.

Konkluzion:

Mbikëqyrja e implementimit të manualit të SMS dhe Deklaratave të Konformitetit është një proces i cili mund të bëhet në çdo kohë, atëherë kur ne e shohim të nevojshme dhe të arsyeshme, ju informojmë se Menaxhmenti i Infrakos-it duhet ti merr parasysh rekomandimet e më sipërme. Nëse gjatë mbikëqyrjes së radhës të gjeturat do të jenë të njëjta ne do të jemi të detyruar që të fillojmë me aplikimin e nenit 143 paragrafi 1 (1.11) dhe paragrafi 3 (3.7), të ligjit 04/L-063, për hekurudhat në Republikën e Kosovës i cili thotë se:

1. Personi juridik për kundërvajtje (shkelje administrative) gjobitet prej tremijë (3.000) deri tetëmijë (8.000) Euro nëse:
 - 1.11. sistemet e vendosura për menaxhimin e sigurisë nuk përmbajnë elementet bazike (neni 103 paragrafi 5. i këtij ligji),
3. Personi juridik për kundërvajtje (shkelje administrative) dënohet me gjobë prej pesëmijë (5.000) deri në dhjetëmijë (10.000) euro nëse:
 - 3.7. sistemet e vendosura për menaxhimin e sigurisë nuk përmbajnë elementet të cilat kanë të bëjnë me sigurinë e sistemit hekurudhor neni 103 paragrafi 2. dhe 3. i këtij ligji).

8.4. SHTOJCË IV

8.4.1. Raport Mbikëqyrja e Implementimit të Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë (SMS) nga Trainkos.



Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
 Regulativni Autoritet Železnica
 Railway Regulatory Authority



**DEPARTAMENTI
I SIGURISË**

**RAPORT- MBIKËQYRJA E
IMPLEMENTIMIT TË
SISTEMIT PËR MENAXHIMIN E
SIGURISË (SMS)
IMPLEMENTIMI I SMS NGA
TRAINKOS**

Afrim Mehmetaj

Datë: 10.06.2015

Përmbledhje:

Bazuar në ligjin Nr. 04/L-063, neni 94 paragrafi 3, neni 100 paragrafët 1,2,3,4 dhe neni 103 për hekurudhat në Republikën e Kosovës, Rregullores së ARH-së Nr. 03/2013 Metodën e Përgjithshme e Sigurisë për Mbikëqyrje nga Organi Përgjegjës i Sigurisë pas lëshimit të një Certificate apo Autorizimi të Sigurisë, Direktivës së sigurisë 2004/49/EC nenet 4, 9 dhe aneksi III. Departamenti i Sigurisë ka filluar procesin e mbikëqyrjes së implementimit të Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë (SMS) nga ana e Operatorit me Trena Trainkos datë: (12-15).05.2015.

Qëllimi i këtij procesi të mbikëqyrjes së implementimit të SMS ka qenë që të sigurohemi se Trainkos e ka vendosur Sistemin për Menaxhimin e Sigurisë dhe ky sistem plotëson kërkesat e sigurisë dhe përmban elementet të cilat kanë të bëjnë me sigurinë e sistemit hekurudhor në Kosovë.

Ne gjatë mbikëqyrjes së implementimit të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë (SMS) kemi mbajtur takime me të gjithë personat përgjegjës nga departamentet të cilët janë përgjegjës për mirëmbajtjen e sigurisë hekurudhore siç janë:

- Udhëheqësin e zyrës për Kontroll / Siguri dhe Kualitet,
 - Zyrtarin e SMS-it,
 - Drejtorin e Operimeve,
 - Menaxherin e Transportit të Udhëtarëve,
 - Menaxherin e Transportit të Mallrave,
 - Menaxherin për Çështje Ligjore dhe Resurset Njerëzore,
 - Menaxherin e Mirëmbajtjes,
 - Shefin e Tërheqjes së Mjeteve Lëvizëse në Transportin e Udhëtarëve,
 - Shefin e Tërheqjes së trenave në transportin e Mallrave.
-
- ZYRA PËR KONTROLL / SIGURI DHE KUALITET

Zyra për Kontroll/ Siguri dhe Kualitet i përgjigjet direkt Kryeshefit Ekzekutiv të Trainkos-it, informatat për siguri i merr nga Kryeshefi dhe i shpërndan të stafi përgjegjës për siguri. Në kuadër të zyre janë të punësuar katër persona përgjegjës për siguri siç janë: udhëheqësi i zyrës për kontroll/siguri dhe kualitet, zyrtari i SMS, Zyrtari për Kontrollin e Mirëmbajtjes së Mjeteve Lëvizëse (ZKMML) dhe Zyrtari për Kontrollin e Mjeteve Lëvizëse (ZKML).

Udhëheqësi i zyrës për kontroll/siguri dhe kualitet informatat lidhur me aktivitetet e sigurisë nga terreni i merr nga zyrtarët e cekur më lartë dhe këto aktivitete i raporton të Kryeshefit Ekzekutiv.

Kryesisht kontrolli i rrezikut dhe aktivitetet monitorohet nga zyrtarët e cekur ZKMML dhe ZKML, të cilët janë përgjegjës për monitorimin e mirëmbajtjes së mjeteve lëvizëse dhe monitorimin e sigurisë së mjeteve lëvizëse.

Sa i përket implementimit të SMS dhe Deklaratave të Konformitetit (DK) të pranuar nga Trainkos me rastin e aplikimit për marrjen e certifikatës së sigurisë mund të themi se ky departament (udhëheqësi i zyrës për kontroll/siguri dhe kualitet, zyrtari i SMS) kanë informata të përgjithshme dhe e njohin në përgjithësi SMS dhe DK, kurse sa i përket dy zyrtarëve tjerë ata nuk e njohin dhe nuk kanë informata lidhur me SMS dhe DK. Sa i përket raportimit të ngjarjeve të jashtëzakonshme kjo zyrë nuk merr informata direkte lidhur me ngjarjet e jashtëzakonshme, si dhe raportet për ngjarjet e jashtëzakonshme nuk shkojnë të zyra për kontroll/siguri dhe kualitet.

- ZYRTARI I SMS-it

Sipas zyrtarit të SMS ai me kohë në formë elektronike dhe në kopje fizike e ka shpërndarë SMS të menaxhmenti dhe personat përgjegjës për siguri në kuadër të Trainkos-it. Prej marrjes së certifikatës së sigurisë (janar 2013) e deri me tash nuk ka pasur një fushatë informuese brenda Trainkos-it lidhur me SMS dhe DK, si dhe nuk kanë pasur ndonjë trajnim për SMS si dhe nuk ka pasur as kërkesë për trajnim. Monitorim (Auditim) të sigurisë nuk ka pasur qysh prej vitit 2013. Sa i përket azhurnimit të SMS është biseduar por nuk ka ndonjë hap konkret edhe pse ka pasur disa ndryshime në strukturën menaxhuese të Trainkos-it.

- DREJTORI I OPERIMEVE

Kjo drejtori është përgjegjëse për mbarëvajtjen e transportit të mallrave dhe udhëtarëve, mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse etj. Në vazhdimësi merr informata lidhur me sigurinë nga personat përgjegjës brenda sektorit që e mbulon, si dhe këto informata shpërndahen të personat përgjegjës sipas hierarkisë.

Sipas drejtorit të operimeve ai është i njoftuar me SMS dhe DK në përgjithësi por nuk i ka përpunuar në detaje SMS dhe DK. Sipas drejtorit të operimeve stafi i tij nuk kanë parashtruar ndonjë kërkesë sa i përket trajnimit për siguri pra SMS dhe DK çka do të thotë se stafi me i ulët në pozitë nuk kanë informata të mjaftueshme lidhur me SMS.

- MENAXHERI I TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE

Ndër detyrat e këtij menaxheri janë: Përgatitja e raporteve ditore, javore, mujore, orari i lëvizjes së trenave (OLT) etj. Sa i përket SMS dhe DK ka disa informata të përgjithshme të cilat informata sipas tij janë shpërndarë të stafi përgjegjës e deri të punëtorët në pozita me të ulëta. Sipas zyrtarit në fjalë transporti i udhëtarëve funksionon pa problem, vagonët janë të pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme të sigurisë si pajisjet e zjarrit, ngrohja në vagonë, ndriçimi, sistemi i frenimit funksional. Po ashtu edhe sipas këtij menaxheri që nga 2013 nuk ka pasur ndonjë kërkesë nga stafi për trajnim për siguri dhe SMS, por as ndonjë iniciativë nga menaxhmenti që të mbahen trajnime për SMS me çka na jep të nënkuptojmë se stafi me pozitë me të ulët menaxhuese nuk kanë njohuri ose kanë njohuri të pjesshme për SMS dhe DK.

- MENAXHERI I TRANSPORTIT TË MALLRAVE

Sipas Menaxherit për transportin e mallrave SMS dhe DK, janë shpërndarë të stafi dhe ata janë të njoftuar për detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga SMS, por nuk ka një informatë kthyes nga punëtorët për këtë. Problem sipas menaxherit mbetet jo stabiliteti i linjave, shpejtësia jo adekuate dhe vjetërsia e mjeteve lëvizëse. Sipas Menaxherit për transportin e mallrave nuk kanë një inspektim (monitorim) të shkruar të sigurisë dhe mungon qasja adekuate e menaxhmentit me qëllim rritjen e sigurisë. Ky menaxher ka disa vërejtje po ashtu edhe për makinistët sepse në disa raste ka mosrespektim të shpejtësisë së lëvizjes. Gjithashtu as në këtë sektor nuk ka pasur një shkollim (trajnim) për siguri.

- MENAXHERI PËR ÇËSHTJE LIGJORE DHE RESURSET NJERËZORE

Sipas këtij menaxheri SMS dhe DK janë shpërndarë me kohë të stafi përgjegjës për siguri- te menaxherët dhe shefat e sektorëve.

Për këtë menaxher problem i vazhdueshëm mbetet rekrutimi i stafit profesional, mbrojtja në punë, kontrollimet sistematike mjekësore, trajnimet për siguri etj. Sipas tij punëtorët janë të pajisur me të gjitha mjetet e mbrojtjes në punë. Po ashtu edhe sipas këtij menaxheri nuk ka pasur kërkesa për trajnim (shkollim) për siguri nga ana e stafit e sidomos nuk ka pasur kërkesë për sqarimin e SMS dhe DK.

- MENAXHERI I MIRËMBAJTJES

Sa i përket njohurive të SMS dhe DK edhe në këtë sektor ka informata të përgjithshme por jo të mjaftueshme pasi që menaxheri deri diku e njeh SMS dhe DK por stafi nuk ka njohuri për këtë. Ky sektor kryen riparime sipas kërkesës së njësisë së tërheqjes së trenave. Në sektorin e mirëmbajtjes nuk kanë pasur ndonjë trajnim për siguri qysh prej vitit 2011. Në raste të caktuara lokomotiva nuk dorëzohet në punëtori nga personat e njësisë të tërheqjes së trenave si të transportit të udhëtareve ashtu edhe të transportit të mallrave përgjegjës për këtë punë. Përgjegjësia në punë sipas përgjegjësit të sektorit të mirëmbajtjes nuk është në nivelin e duhur sa i përket sigurisë sepse ka ndodhur që lokomotiva ka ardhur në punëtori me sistemi të sigurisë të bllokuar (zifë e bllokuar) për çka edhe janë njoftuar personat përgjegjës. As nga ky sektor nuk është përgatitur ndonjë rekomandim i sigurisë për menaxhmentin. Gjatë riparimit të lokomotivave në të shumtën e rasteve mungon personi përgjegjës i njësisë të tërheqjes së trenave si të transportit të udhëtareve ashtu edhe të transportit të mallrave cili bënë mbikëqyrjen e riparimit. Sipas tyre duhet të ketë një zbatim me rigoroz të rregullave të sigurisë etj.

- SHEFI I TËRHEQJES SE MJETEVE LËVIZËSE NE TRANSPORTIN E UDHËTARËVE

Sa i përket njohurive të SMS dhe DK, janë të pakta kurse makinistët nuk janë fare të informuar për SMS dhe DK. Sipas menaxherit shkollimi i personelit përgjegjës për siguri nuk është duke u kryer në shkallën e duhur, kurse shkollimi për udhëheqës të trenave është kryer vitin e kaluar. Kontrollat shëndetësore të makinistëve kryhen më rregull ashtu siç është paraparë me rregullore.

- SHEFI I TËRHEQJES SË TRENAVE NË TRANSPORTIN E MALLRAVE

Te ky sektor ashtu si edhe të tjerët e përshkruar më lartë njohuritë për SMS dhe DK nuk janë në nivelin e kënaqshëm si te stafi menaxhues po ashtu edhe të ai ekzekutiv, në kuadër të këtij departamenti janë 7 makinistë, 12 ndihmës makinistë. Sa i përket trajnimit apo shkollimit për SMS dhe DK nuk kanë pasur ndonjë trajnim qe nga 2013. Makinistët dhe ndihmës makinistë janë të informuar për detyrat dhe përgjegjësitë e tyre sa i përket sigurisë, por njohuri për SMS e dorëzuar nga Trainkos me rastin e aplikimit për certifikatë të sigurisë makinistët nuk kanë. Gjithashtu as në këtë sektor si në sektorët e tjerë nuk kanë pasur kërkesa për trajnim për siguri.

Rekomandim:

Rekomandimet e më poshtme vlejné pothuajse për të gjithë sektorët dhe të gjitha nivelet e menaxhmentit të Trainkos-it, ne nuk kemi paraqitur në mënyrë specifike se cilat departamente apo sektor qëndrojnë me mirë apo me keq, por në një farë mënyrë nivelin e implementimit të manualit të SMS dhe DK e kemi sqaruar më lartë për secilin departament veç e veç.

12. Menaxhmenti i Trainkos-it duhet të jetë i përkushtuar që politikat e sigurisë, SMS dhe DK të implementohen në tërësi ashtu siç janë paraparë në Manualin e SMS,
13. Sistemi i menaxhimit të sigurisë duhet të dokumentohet në të gjitha pjesët relevante dhe duhet të përshkruaj ndarjen e rolit dhe përgjegjësi, llojin e shërbimeve, vlerësimin e rrezikut etj. siç e keni paraqitur në deklaratën FO_DC_05,
14. Shpërndarja e përgjegjësi të bëhet tek të gjithë personat përgjegjës për siguri ashtu siç e keni paraqitur në deklaratën FO_DC_06,
15. Sigurimi i kontrollit në të gjitha nivelet e menaxhmentit të bëhet ashtu siç e keni paraparë në deklaratë FO_DC_07,
16. Politika e sigurisë e duhet të shpërndahet të i gjithë stafi përgjegjës për siguri ashtu siç është paraparë në FO_DC_10,
17. Ka pasur monitorim (auditim) të pjesshëm të sigurisë, monitorimi duhet të kryhet dhe të dokumentohet në baza të rregullta ashtu siç e keni paraparë në deklaratën e konformitetit FO_DC_19,
18. Organizimi i trajnimit (shkollimit) për SMS dhe DK në të gjitha nivelet e Trainkos-it përgjegjëse për siguri, ku personat përgjegjës për shkollim së bashku me menaxherët e secilit sektor do të organizonin trajnimin për stafin e tyre, por gjithmonë me pjesëmarrjen aktive të Zyrës për Kontroll/Siguri dhe Kualitet,
19. Të ketë një komunikim dhe koordinim me të mirë ndërmjet sektorit të mirëmbajtjes, sektorit të tërheqjes dhe zyrtarit për kontrollin e mirëmbajtjes së mjeteve lëvizëse,

20. Të ketë një kontroll me të madhe të mjeteve lëvizëse me rastin e pranim dorëzimit për riparim apo pas riparimit, ka ndodhur që zgjuësi (Zifa) i lokomotivës ka qenë qëllimisht i bllokuar nga ana e makinistëve, kjo ka një ndikim direkt në sigurinë e komunikacionit hekurudhor,
21. Raportet për rastet e jashtëzakonshme do të duhej të dërgohen edhe të Zyra për kontroll/siguri dhe kualitet,
22. Zbatimi i me rigoroz i rregullores për mbrojtjen në punë.

Konkluzion:

Mbikëqyrja e implementimit të manualit të SMS dhe Deklaratave të Konformitetit është një proces i cili mund të bëhet në çdo kohë, atëherë kur ne e shohim të nevojshme dhe të arsyeshme, ju informojmë se Menaxhmenti i Trainkos-it duhet ti merr parasysh rekomandimet e më sipërme. Nëse gjatë mbikëqyrjes së radhës të gjeturat do të jenë të njëjta ne do të jemi të detyruar që të fillojmë me aplikimin e nenit 143 paragrafi 1 (1.11) dhe paragrafi 3 (3.7), të ligjit 04/L-063, për hekurudhat në Republikën e Kosovës i cili thotë se:

1. Personi juridik për kundërvajtje (shkelje administrative) gjobitet prej tremijë (3.000) deri tetëmijë (8.000) Euro nëse:
 - 1.11. sistemet e vendosura për menaxhimin e sigurisë nuk përmbajnë elementet bazike (neni 103 paragrafi 5. i këtij ligji),
3. Personi juridik për kundërvajtje (shkelje administrative) dënohet me gjobë prej pesëmijë (5.000) deri në dhjetëmijë (10.000) euro nëse:
 - 3.7. sistemet e vendosura për menaxhimin e sigurisë nuk përmbajnë elementet të cilat kanë të bëjnë me sigurinë e sistemit hekurudhor neni 103 paragrafi 2. dhe 3. i këtij ligji).



8.5. SHTOJCË V

8.5.1. Raporti vjetor i sigurisë për vitin paraprak (2014) ashtu siç parashihet më Ligjin 04/L-063 dhe Direktivën 2004/49/EC.



Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Regulativni Autoritet Železnica
Railway Regulatory Authority



Raporti vjetor i sigurisë 2014



09/09/2014

SHTATOR 2015

Përmbajtja

QËLLIMI I RAPORTIT	3
PJESA HYRËSE	4
ORGANIZIMI	9
ZHVILLIMET NË SIGURINË HEKURUDHORE	10
NDRYSHIME TË RËNDËSISHME NË RREGULLORE, LEGJISLACION DHE DISPOZITA ADMINISTRATIVE	16
ZHVILLIMI I CERTIFIKATËS DHE AUTORIZIMIT TË SIGURISË	17
MBIKËQYRJA E NDËRMARRJEVE HEKURUDHORE DHE MENAXHERVE TË INFRASTRUKTURËS	18
RAPORTIMI MBI ZBATIMIN E METODAVE TË PËRBASHKËTA TË SIGURISË (MPS) PËR VLERËSIMIN E RREZIKUT	27
MASAT ALTERNATIVE PËRMES PËRJASHTIMEVE LIDHUR ME ENTITETIN PËRGJEGJËS PËR MIRËMBAJTJEN (EPM-ECM) SKEMA E CERTIFIKIMIT	28
DEPARTAMENTI I SIGURISË KONKLUZIONET PËR VITIN E RAPORTIMIT PRIORITETET	28
BURIMET E INFORMACIONIT	29
L/ Anekset	30
Aneksi A - Struktura e Informacioneve Hekurudhore	30
Aneksi B - Struktura Organizative	34
Aneksi C - Zhvillimet në sigurinë hekurudhore	36
ANEKSI D - Zhvillimi i certifikatës dhe autorizimit të sigurisë - të dhënat numerike.....	41
Lista e shkurtesave.....	45

QËLLIMI I RAPORTIT

Raporti Vjetor i sigurisë për vitin 2014 mbulon aktivitetet e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave (ARH), respektivisht aktivitetet e departamentit të Sigurisë gjatë vitit 2014, ky është raporti i tretë me radhë të cilin e paraqesim te drejtori i përgjithshëm dhe te bordi i ARH-së. Ky raport i sigurisë për vitin 2014 është punuar ashtu siç kërkohet nga Ligji 04/L-063 neni 20 për hekurudhat e Kosovës si dhe Direktiva 2004/49/EC neni 18.

Objektivat dhe përmbajtja e raportit janë të përcaktuara në nenin 20 Ligji 04/L-063 mbi sigurinë hekurudhore.

Ky raport i përshkruan aktivitetet e vitit paraprak të departamentit të sigurisë, menaxherit të infrastrukturës (Infrakos) dhe operatorit me trena (Trainkos), raporti duhet të përmbajë informacionet për së paku mbi:

- a. zhvillimet e sigurisë hekurudhore duke përfshirë informacionin për Treguesit e Përbashkët të Sigurisë (TPS);
- b. ndryshimet e rëndësishme në legjislacion dhe rregullativ në lidhje me sigurinë hekurudhore;
- c. zhvillimin e certifikatës së sigurisë dhe autorizimit të sigurisë në Kosovë;
- d. rezultatet dhe përvoja në lidhje me mbikëqyrjen e menaxherëve të infrastrukturës dhe të ndërmarrjeve hekurudhore;
- e. përjashtimet të cilat nëse vendoset të bëhen nga departamenti përgjegjës për Sigurinë hekurudhore lidhur me identifikimin dhe certifikimin e subjekteve përgjegjëse për mirëmbajtjen e mjeteve transportuese hekurudhore të regjistruara në vendet tjera jashtë Kosovës dhe të cilat mirëmbahen sipas ligjeve të këtyre vendeve.

Raporti është i bazuar në modelin e zhvilluar nga Agjensioni Evropian Hekurudhorë (European Railway Agency- ERA), dhe përmban të gjitha çështjet të cilat janë paraqitur në nenin 18 të Direktivës 2004/49/EC

PJESA HYRËSE

2.1. Hyrje në raport

Raporti vjetor i sigurisë për vitin 2014 është i tretë me radhë, është raport i cili përgatitet nga departamenti i sigurisë në kuader të ARH-së, në përputhje me ligjin 04/L-063 Neni 20 për hekurudhat e Kosovës si dhe nenin 18 të Direktivës 2004/49/EC.

Struktura e këtij raporti është në përputhje me rekomandimet (modelit dhe udhëzimit) e Agjencionit Evropian Hekurudhor (ERA).

Ky raport i sigurisë është përgatitur në radhë të parë nga informacioni i siguruar nga aktivitetet e departamentit të sigurisë si dhe nga informatat e raporteve vjetore të ndërmarrjes hekurudhore (Trainkos) dhe menaxherit të Infrastrukturës (Infrakos), Trainkos ka marrë një certifikatë të vlefshme të sigurisë në Kosovë në vitin 2013, gjithashtu edhe Infrakos ka marrë një autorizim të vlefshëm të sigurisë në Kosovë në vitin 2013.

2.2. Struktura e Informacioneve Hekurudhore (Aneksi A)

2.2.1. Harta e rrjetit (Aneksi A. 1.)

Hartat e bashkangjitura (Aneksi A. 1.) tregojnë të gjithë rrjetin hekurudhor në Republikën e Kosovës.

Rrjeti hekurudhor në Republikën e Kosovës është i ndarë në këto linja:

- **Linja Veri – Jug** që përshkon vendin nga kufiri me Serbinë (Stacioni Leshak) deri në kufirin me Maqedoninë (Stacioni Hani i Elezit), me gjithsejtë 148 km në linjën bazike hekurudhore 10 të SEETO-s. (Linjë funksionale).
- **Linja Verilindje deri në Perëndim** që përbëhet nga tri degë:
 - **Linja Lindore** nga kufiri me Serbinë (Stacioni Podujevë) deri në Fushë Kosovë me 45 km gjatësi.
 - Fushë Kosovë – Bardhosh 15 km (Linjë funksionale)
 - Bardhosh-Podujevë 30 km (Linjë jo -funksionale)
 - **Linja Perëndimore** nga Fushë Kosova deri në Pejë me 81 km gjatësi (Linjë funksionale),
 - **Linja Jug-Perëndim** nga Klina deri në Prizren me 58 km gjatësi.
 - Klinë – Xërxe 35 (Linjë funksionale)
 - Xërxe – Prizren 32.5 (Linjë jo-funksionale)

Me vendimin e Qeverisë së Kosovës më 01.09.2011 është bërë ndarja e Hekurudhave të Kosovës ShA në dy kompani të reja:

- Infrastrukturën e Hekurudhave të Kosovës **INFRAKOS Sh.A**, dhe
- Operimin me Trena të Hekurudhave të Kosovës **TRAINKOS Sh.A**.

Hekurudhat e Kosovës shtrihen në tërë territorin e Kosovës me një gjatësi prej 333,451 km. Në këtë gjatësi nuk përfshihen vijat industriale të cilat kapin gjatësinë prej 103,4 km. Vija e parë hekurudhore në Kosovë është ndërtuar në vitin 1874 në relacionin Hani i Elezit – Fushë Kosovë – Mitrovicë. Më vonë ka filluar dhe është kryer ndërtimi i rrjetit ekzistues hekurudhor nëpër tërë territorin e Kosovës. Vijat hekurudhore bëjnë lidhjen e të gjitha qendrave më të

rëndësishme të Kosovës përveç Gjakovës dhe Gjilanit. Nga kjo që u tha më lartë shihet se nga totali prej 333.451 km rreth 131.70 km linjë hekurudhore nuk shfrytëzohet apo 39.49 %.

Linjat hekurudhore të cilat nuk janë në funksion janë:

1. Fushë Kosovë - Leshak (kufiri me Serbinë - 76.5 km),
2. Prishtinë – Podujevë -Merdare (kufiri me Serbinë -32.2 km),
3. Xërxe – Prizren (23 km).

2.2.2. Lista e menaxherëve të infrastrukturës (MI) dhe ndërmarrjeve hekurudhore (NH) (Aneksi A.2.)

Ky aneks tregon se menaxheri i infrastrukturës ka një Autorizim të vlefshëm të sigurisë Pjesa A dhe B, si dhe ndërmarrja hekurudhore e cila gjithashtu ka një Certifikatë të vlefshme të Sigurisë Pjesa A dhe B që nga 24 janarë 2013.




Nr.	Emërtimi i kompanisë	Autorizim i Sigurisë pjesa A dhe B		Certifikatë e Sigurisë pjesa A dhe B	
1.	Menaxheri i Infrastrukturës (Infrakos)	24.01.2013	24.01.2013		
2.	Ndërmarrja Hekurudhore (Trainkos)			24.01.2013	24.01.2013

2.3. Përmbledhje- Analiza e Përgjithshme Trendi (p.sh. trendët në zhvillimin e sigurisë hekurudhore, autorizimi, certifikimi, autorizimi i futjes në shërbim etj)

- Në vitin 2014 numri i aksidenteve dhe incidenteve ishte 13 ka zbritur për 23.50 % në krahasim me vitin 2012 që ishte 17.
- Numri i personave të cilët ishin të lënduar në vitin 2014 është 14, kemi një zbritje prej 23% në krahasim me vitin 2013 që ishte 17.
- Në vitin 2014 numri i përgjithshëm i viktimave është (3), pra kemi një rritje në krahasim me vitin 2013 (2), pra 33.33 % më shumë viktime në vitin 2014.

	Nr i ngjarjeve të jashtëzakonshme	Nr i personave të vdekur	Nr i personave të lënduar	Dëme materiale në hekurudhat e Kosovës

2010	24	2	35	2488.9
2011	22	3	6	14137.95
2012	25	3	6	44762.36
2013	17	2	17	10330
2014	13	3	14	825



Autorizimi i Sigurisë dhe Certifikata e Sigurisë

Në përputhje me ligjin 04/L-063 neni 104, për hekurudhat e Kosovës si dhe dispozitat e Direktivës 2004/49/EC dhe Rregulloren e Komisionit 1169/2010, Rregulloren 1158/2010, të cilat parashohin dhënien e autorizimeve dhe certifikatave të sigurisë Pjesa A dhe Pjesa B për menaxheret e infrastrukturës dhe ndërmarrjet hekurudhore.

Secila ndërmarrje hekurudhore që mban licencë, duhet të marrë Certifikatën e Sigurisë para se t'i jepet e drejta për qasje në një infrastrukturë hekurudhore. Qëllimi i Certifikatës së Sigurisë është të ofrojë dëshmi se ndërmarrja hekurudhore ka të vendosur sistemin e menaxhimit të sigurisë (SMS) dhe mund të plotësojë kërkesat e paraqitura në TSI-të dhe në legjislacionin relevant të BE-së, si dhe në rregullat nacionale të sigurisë në ofrimin e shërbimeve të transportit të sigurt në rrjet.

Secili Menaxher i Infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët duhet të merr Autorizimin e Sigurisë, i cili konfirmon pranimin e sistemit të menaxhimit të sigurisë (SMS) dhe konfirmon pranimin e dispozitave të menaxherit të infrastrukturës për të plotësuar kërkesat specifike të domosdoshme për dizajn, mirëmbajtje dhe operim të sigurt të infrastrukturës hekurudhore, duke përfshirë mirëmbajtjen dhe operimin e kontrollit të trafikut dhe sistemin e sinjalizimit, kur është e përshtatshme.

2.3.2. Autorizimi për futjen në shërbim të nënsistemeve strukturale dhe mjeteve të transportit

Bazuar në Ligjin për Hekurudhat e Kosovës, neni 18 paragrafi 3.1, 3.3 neni 109, 110 dhe 111 secili mjet lëvizës para se të futet në shërbim duhet të autorizohet nga Departamenti i Sigurisë. ARH më datën: 29.11.2013 ka pranuar nga Trainkos kërkesën për marrjen e autorizimit për futjen në shërbim për 9 (nëntë) vagonë të udhëtarëve.

Më datë: 19.11.2013 dhe Trainkos ka dorëzuar kërkesën për marrjen e autorizimit për futjen në shërbim për 9 vagonë të Udhëtarëve.

Kurse me datë: Infrakos SH.A. me datë 13. 01. 2014 ka aplikuar për marrjen e Autorizimit për futjen në shërbim për pajisjen "Plasser & Theurer tipi 08-16-SH"

Më datë: 25.02.2014 ARH la lëshuar autorizimin për futjen në shërbim për 9 vagonë të Udhëtarëve

Me date: 31.01.2014 ARH la lëshuar autorizimin për futjen në shërbim për pajisjen "Plasser & Theurer tipi 08-16-SH"

Pas shqyrtimit të të gjithë dokumentacionit të ofruar nga Trainkos, si dhe pas plotësimit të dokumentacionit, më datën: 25.02.2014 kemi lëshuar Autorizimin për futjen në shërbim për 9 (nëntë) vagonë të udhëtarëve.

Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës Infrakos SH.A. me datë 13. 01. 2014 ka aplikuar për marrjen e Autorizimit për futjen në shërbim për pajisjen "Plasser & Theurer tipi 08-16-SH" te Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave.

Pas shqyrtimit të të gjithë dokumentacionit të ofruar nga Infrakos, si dhe pas plotësimit të dokumentacionit, më datën: 31.01.2014 kemi lëshuar Autorizimin për futjen në shërbim për mjetin e mirëmbajtjes Plasser & Theurer tipi 08-16-SH.

Formati dhe modeli i Autorizimit për futjen në shërbim është i njëjtë me atë i cili përdoret nga vendet anëtare të BE.

ORGANIZIMI

3.1. Prezantimi i organizimit

Bazuar në ligjin 04/L-063, nenit 3 paragrafi 1.42. Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave (ARH) të Kosovës është institucion i pavarur i cili është i ngarkuar për rregullimin, mbikëqyrje, organizimin e sektorit hekurudhor në Kosovë dhe i cili vepron si organ licencues, organ përgjegjës për çështjet e interoperabilitet dhe entiteteve të njoftimit, organ për rregullimin e tregut hekurudhor dhe departamentin për sigurinë hekurudhore dhe kompetencave të tjera të cilat i jepen në bazë të këtij ligji. ARH është themeluar në vitin 2010, në vitin 2014 kishte 16 të punësuar prej tyre 3 ishin përgjegjës për sektorin e sigurisë hekurudhore.

Departamenti përgjegjës për sigurinë hekurudhore është krijuar nën mbikëqyrjen e ARH për të siguruar që siguria hekurudhore mbahet dhe përmirësohet në sistemin hekurudhor të Kosovës.

Departamenti përgjegjës për sigurinë hekurudhore duhet të jetë i pavarur në organizimin e vet, strukturën ligjore dhe vendim marrjen nga ndonjë ndërmarrje hekurudhore, menaxher i infrastrukturës, aplikues apo entitet i prokurimit.

Bazuar në ligjin 04/L-063 për hekurudhat në Republikën e Kosovës departamentit përgjegjës për sigurinë hekurudhore i janë besuar detyrat në vazhdim:

1. autorizimi për futjen në shërbim të nënsistemeve strukturale që e përbëjnë sistemin hekurudhor dhe kontrollimin që ato operojnë dhe mirëmbahen në përputhje me kërkesat esenciale;
2. mbikëqyrja nëse përbërësit e interoperabilitetit të nënsistemeve hekurudhore janë në përputhje me kërkesat esenciale të kërkuara nga direktivat për ndëroperim;
3. autorizimi i futjes në punë të mjeteve të reja lëvizëse apo i atyre të modifikuara substancialisht;
4. lëshimi, përtëritja, amendamenti dhe revokimi i pjesëve relevante të certifikatave të sigurisë dhe autorizimeve të sigurisë, si dhe kontrollimi nëse janë plotësuar kushtet dhe kërkesat e paraqitura në to, dhe se menaxheri i infrastrukturës dhe ndërmarrjet hekurudhore janë duke operuar sipas kërkesave të ligjit në Kosovë;
5. monitorimi, promovimi, zbatimi dhe kur është e duhur bërja e propozimeve për të zhvilluar raporte të afërta pune me ministrinë dhe pjesëmarrësit e tjerë të tregut, kornizën rregullative të sigurisë duke përfshirë sistemin e rregullave nacionale të sigurisë;

6. mbikëqyrja se a janë të regjistruara mjetet lëvizëse dhe nëse informacioni që ka të bëjë me sigurinë në regjistrin nacional është i azhurnuar;
7. mbikëqyrja se a mbahet dhe azhurnohet rregullisht regjistri i pronarëve të mjeteve transportuese hekurudhore;
8. mbikëqyrja se a mbahet dhe azhurnohet rregullisht regjistri i infrastrukturës (RINF).

ARH në rolin e autoritetit të sigurisë është gjithashtu një pjesëmarrës i rregullt në takimet dhe aktivitetet e organizuara nga Agjensioni Evropian i Hekurudhave (ERA- European Railway Agency), si dhe në shumë aktivitete tjera të organizuara si nga SEETO po ashtu edhe nga vendet e tjera.

Struktura Organizative e ARH është paraqitur në Aneksin B.

ZHVILLIMET NË SIGURINË HEKURUDHORE

4.1. Iniciativat për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e performancës së sigurisë

ARH duhet të siguroj që siguria hekurudhore përgjithësisht të mirëmbahet, atëherë kur është e arsyeshme dhe praktike përmirësohet vazhdimisht duke marrë parasysh legjislacionin e BE-së, ndryshimet, përparimet teknike dhe shkencore dhe prioritetin që i jepet parandalimit të aksidenteve serioze.

Për të arritur një regjim më efikas të mbikëqyrjes, ARH- departamenti i sigurisë ka përdorur metodën për qasje ndaj rrezikut. Në planifikimin e aktiviteteve mbikëqyrëse jemi bazuar nga përvoja me raportimet e aksidenteve, incidenteve si dhe përvoja nga proceset tjera janë përdorur në mënyrë aktive që prioritetet tona të përqendrohen në aktivitetet që përfaqësojnë rreziqet më të larta.

Prandaj, niveli i sigurisë në hekurudhë është varur nga mirë-funksionimi ndërmjet ARH, Menaxherit të Infrastrukturës dhe operatorit me trena. Për këtë arsye, niveli i sigurisë në hekurudha është përshkruar në formën e objektivave për përmirësimin e sigurisë që janë zbatuar nga të gjitha palët ARH, Menaxheri i Infrastrukturës dhe operatorit me trena.

Bazuar në informatat e më sipërme, vëmendja do të përqendrohet si në vijim:

- Rrezikun individual i cili ndërlidhet me udhëtarët, stafin (përfshirë edhe stafin e kontraktuesve),
- Rrezikun individual të shfrytëzuesve të vendkalimeve (kryqëzimeve hekurudhë-rrugë) dhe të tjerëve,
- Rrezikun individual duke mos paragjykuar rregullat e detyrueshme ekzistuese nacionale dhe rajonale,

- Rrezikun individual lidhur me personat e pa autorizuar në objektet hekurudhore,
- Riskun social,
- Përfshirja aktive nga menaxhmenti i lartë në siguri (duke përfshirë vlerësimet e menaxhmentit),
- udhëzime të brendshme për vendkalimet dhe pajisjet e sigurisë,
- përdorimi aktiv i analizës së rrezikut (CSM RA).

Menaxheri i Infrastrukturë dhe Ndërmarrja Hekurudhore janë përgjegjës për sigurinë në rrjetin hekurudhor të Kosovës, ata duhet të implementojnë Sistemin e tyre për Menaxhimin e Sigurisë (SMS) në mënyrë që të parandalohen aksidentet dhe incidentet.

ARH- departamenti i sigurisë i merr parasysh të gjitha rekomandimet në raportet nga organi për hetimin e aksidenteve dhe siguron që NH dhe MI i zbatojnë masat adekuate.

8.6. Analizimi i detajuar i trendit të te dhënave

Në mënyrë që të lehtësohet vlerësimi i arritjes së qëllimeve të përbashkëta të sigurisë (QPS) të zhvilluara në BE dhe të ofrohet monitorim i zhvillimit të përgjithshëm të sigurisë hekurudhore, Organi përgjegjës për sigurinë duhet të mbledhë informacion për treguesit e përbashkët të sigurisë (TPS) nëpërmes të raporteve vjetore të Menaxherit të Infrastrukturës dhe Ndërmarrjes Hekurudhore siç është përcaktuar me ligjin për hekurudhat e Kosovës 04/L-063 dhe direktivës së sigurisë 2004/49/EC, ku si referencë i kemi paraqitur të dhënat nga viti 2009 e tutje.

Numri i aksidenteve:

2010	2011	2012	2013	2014
24	22	25	17	13

Numri i përgjithshëm i ngjarjeve të jashtëzakonshme të ndodhura në vitin 2014 ishte 13, pra kemi një zvogëlim në krahasim me vitin 2014 që ishte 17 ose (**zvogëlim për 23.50 %**).

Numri i të vdekurve:

2010	2011	2012	2013	2014
2	3	3	2	3

Për periudhën 2013 kemi të raportuar 2 të vdekur si pasojë e aksidenteve kurse për vitin 2014 kemi 3 të vdekur si pasojë e aksidenteve ose (**ritje prej 33.33%**).

Numri i të lënduarve:

2010	2011	2012	2013	2014
35	6	6	6	14

Numri i personave të cilët ishin të lënduar në vitin 2014 është 14, kemi një zbritje prej 23% në krahasim me vitin 2013 që ishte 17.

Gjatë 2014 nuk ka pasur viktima të pasagjerëve apo të fuqisë punëtore në aksidentet e trenave.

- 13 Numri i ngjarjeve të jashtëzakonshme
- 3 (tre) qytetarë kanë vdekur si pasojë e aksidenteve.
- 0 të vdekur si pasojë e vetëvrasjes.
- 14 (gjashtë) qytetarë kanë pësuar lëndime.
- 0 nuk ka pasur tentim për vetëvrasje.





Viti	Numri i ngjarjeve të jashtëzakonshme	Të vdekur si pasojë aksidenti	Të Vetëvrasarë	Të lënduar	Tentim vetëvrasje
2014	13	3	0	14	0

Në Aneksin C janë paraqitur të dhëna me të detajuara mbi zhvillimet kryesore dhe trendin e të dhënave për pesë vitet e fundit.

Në vitin 2014, ka pasur një rritje të vogël të tren/km të udhëtarëve 281986 km në krahasim me vitin paraprak 2013 që ishte 281931 tren/km), dhe 120014 tren/ km për transportin e mallrave një rritje prej 9%, në krahasim me vitin paraprak 2013 që ishte 109183 tren/ km).

Viti	Kilometrat e kaluara të trenit të udhëtarëve	Kilometrat e kaluara të trenit të mallrave
2010	328305	132562
2011	313902	122008
2012	328305	132562
2013	281931	109183
2014	281986	120014



Shënime të përgjithshme për vitin 2014:

1	Km. për tren të udhëtarëve	281986
2	Numri i udhëtarëve	352410
3	Tren/km për udhëtarë	12689370
4	Net/ Ton të transportuar	834829
5	Neto ton/km	41741450
6	Tren/km për mallra	120014
7	Km. Total të shfrytëzuar	402000

8.7. Rezultatet e rekomandimeve të sigurisë

Departamenti i sigurisë edhe gjatë vitit 2014 nuk ka pranuar asnjë rekomandim i cili ka të bëjë me sigurinë nga organi për hetimin e aksidenteve hekurudhore (KHAIA).

Rekomandimet e sigurisë hekurudhore duhet të përgatitën dhe shpërndahen nga Organi për Hetimin e Aksidenteve (KHAIA).

8.8. zhvillimet në sigurinë hekurudhore janë paraqitur në aneksin C



Figura 1.

NDRYSHIME TË RËNDËSISHME NË RREGULLORE, LEGJISLACION DHE DISPOZITA ADMINISTRATIVE

Në mënyrë që të harmonizohet kuadri ligjor në Kosovë me ato të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, Parlamenti i Kosovës ka miratuar Ligjin nr. 04/L-063 i datës 14.11.2011 hekurudhat e Kosovës (ka hyrë në fuqi me 01.01.2012), në të cilin Ligj janë transpozuar plotësisht nga acquis e BE-së Direktiva e 2004/49; Direktiva 2001/14, Direktiva 91/440 dhe 95/18, Direktiva 2007/59 dhe Direktiva 2008/57 dhe pjesërisht Direktiva 2012/34.

Për kryerjen e detyrave sipas ligjit për hekurudhat e Kosovës, Struktura e ARH-së, përfshinë: Menaxhmentin, Departamentet dhe personelin mbështetës. Çdo departament ka funksione të përcaktuara për t'iu përgjigjur nevojave të mobilitetit të shoqërisë, transportit dhe ekonomisë, siç janë të rregulluara më këtë ligj dhe me aktet nënligjore të nevojshme që nxjerrin vetë departamentet dhe menaxhmenti i ARH-së.

Departamente në kuadër të ARH-së janë:

- Departamenti i sigurisë,
- Departamenti i tregut hekurudhor,
- Departamenti i interoperabilitetit,
- Departamenti i licencimit.

Të gjitha të dhënat lidhur me ndryshimet në legjislacion, rregullore dhe dispozita administrative mund ti gjeni në ueb faqen e ARH: www.arh-ks.org

ARH respektivisht departamentet përkatëse edhe gjatë kësaj periudhe raportuese pra gjatë vitit 2014 kanë përgatitur edhe rregullore të cilat janë miratuar nga ana e bordit mbikëqyrës të ARH,

Rregulloret e miratuara nga ARH gjatë vitit 2014 janë:

- Rregullore 01/2014 për Modelin e deklaratës së konformitetit për llojin e autorizuar të mjetit hekurudhor,

ARH- ka përgatitur edhe disa rregullore të tjera të cilat në mungesë të bordit nuk janë nënshkruar.

Këto rregullore janë përgatitur me qëllim të përmirësimit të procedurave për: miratimin e ekspozitave të rrjetit, licencimin e makinistëve, mbikëqyrjen e NH dhe MI pas lëshimit të një certifikate apo autorizimi të sigurisë.

ZHVILLIMI I CERTIFIKATËS DHE AUTORIZIMIT TË SIGURISË

6.1. Legjislacioni nacional - data e aplikimit - disponueshmëria

Lëshimi i certifikatës dhe autorizimit të sigorisë bëhet në pajtim me nenin 94, nenin 104 të ligjit 04/L-063 për hekurudhat e Kosovës, nenit 10 dhe 11 të Direktivës 2004/49/EC.

Pas përgatitjes së të gjitha akteve nënligjore të domosdoshme për lëshimin e certifikatës dhe autorizimit të sigorisë siç janë:

- Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2012 për lëshimin e certifikatës dhe autorizimit të sigorisë,
- Rregullores së ARH Nr. 02/2012, për dhënien e certifikatës së sigorisë,
- Rregullores së ARH Nr. 03/2012, për dhënien e autorizimit të sigorisë,
- Rregullores së ARH Nr. 06/2012, për regjistrimin e infrastrukturës.

Departamenti i sigorisë me datë: 26.11.2012, nga NH (Trainkos) ka pranuar aplikacionin për marrjen e certifikatës së sigorisë, kurse me datë: 12.12.2012, nga MI (Infrakos) ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit të sigorisë.

Në përputhje me ligjin 04/L-063 neni 104, për hekurudhat e Kosovës si dhe dispozitat e Direktivës 2004/49/EC dhe Rregulloren e Komisionit 1169/2010, Rregulloren 1158/2010, të cilat parashohin dhënien e autorizimeve dhe certifikatave të sigorisë Pjesa A dhe Pjesa B për menaxheret e infrastrukturës dhe ndërmarrjet hekurudhore.

Departamenti i sigorisë pas vlerësimit të detajuar të aplikacioneve nga të dy kompanitë Trainkos (certifikatë të sigorisë) dhe Infrakos (autorizim të sigorisë), kemi arritur që me datë 24 janar 2013 të lëshojmë certifikatën e sigorisë pjesa A dhe B për Trainkos, si dhe Autorizimin e sigorisë pjesa A dhe B për Infrakos.

ARH me datë 24 janar 2013 ka lëshuar për:

Infrakos- Autorizimin e sigorisë, pjesa A&B, dhe

Trainkos- Certifikatën e sigorisë, pjesa A&B.

ARH- Departamenti i sigorisë bën lëshimin e certifikatave dhe autorizimeve të sigorisë pjesa A dhe B. Bazuar në Udhëzimin administrative Nr. 04/2012 për dhënien e certifikatës së sigorisë dhe autorizimit të sigorisë për NH dhe MI, neni 11 paragrafi 1 certifikimi dhe autorizimi i sigorisë është pa pagesë për tre vite prej datës së hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi.

6.2. Të dhënat numerike

Aneksi D përmban një përmbledhje të dhënave të ndryshme numerike për certifikatat dhe autorizimet e sigurisë.

Në vitin 2014 ARH nuk ka pranuar asnjë nga aplikimet e më poshtme:

- aplikacion për autorizim të sigurisë pjesa A,
- aplikacion për autorizim të sigurisë pjesa B,
- aplikacion për certifikatë të sigurisë pjesa A,
- aplikacion për certifikatë të sigurisë pjesa B,
-

MBIKËQYRJA E NDËRMARRJEVE HEKURUDHORE DHE MENAXHERVE TË INFRASTRUKTURËS

7.1. Përshkrimi i mbikëqyrjes së ndërmarrjes hekurudhore (NH) dhe menaxherit të infrastrukturës hekurudhore (MI)

Në kuadër të departamentit të sigurisë janë tre të punësuar, të cilët janë përgjegjës për mbikëqyrjen e NH dhe MI, ne kryesisht jemi fokusuar në plotësimin e legjislacionit sekondar ku në fillim të vitit 2013 kemi përgatitur rregulloren Nr. 03/2013 Metodat e përgjithshme të sigurisë për mbikëqyrje nga organi përgjegjës i sigurisë pas lëshimit të një certifikate apo autorizimi të sigurisë.

Bazuar në ligjin Nr. 04/L-063, neni 100 paragrafët 1,2,3,4, neni 103 dhe neni 104 paragrafi 2 për hekurudhat në Republikën e Kosovës, Rregullores së ARH-së Nr. 03/2013 Metodat e Përgjithshme e Sigurisë për Mbikëqyrje nga Organi Përgjegjës i Sigurisë pas lëshimit të një Certificate apo Autorizimi të Sigurisë, Direktivës së sigurisë 2004/49/EC nenet 4, 9 dhe aneksi III. Departamenti i Sigurisë ka filluar procesin e mbikëqyrjes së implementimit të Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë (SMS) nga ana e Menaxherit të Infrastrukturës Infrakos datë: (18-22).05.2015 dhe Ndërmarrja Hekurudhore Trainkos datë: 12-15.05.2015.

7.1.1. Përshkrimi i mbikëqyrjes së menaxherit të infrastrukturës hekurudhore (MI)

Qëllimi i këtij procesi të mbikëqyrjes së implementimit të SMS ka qenë që të sigurohemi se Infrakos e ka vendosur Sistemin për Menaxhimin e Sigurisë dhe ky sistem plotëson kërkesat e sigurisë dhe përmban elementet të cilat kanë të bëjnë me sigurinë e sistemit hekurudhor në Kosovë.

Ne gjate mbikëqyrjes së implementimit të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë (SMS) kemi mbajtur takime me të gjithë personat përgjegjës nga departamentet të cilët janë përgjegjës për mirëmbajtjen e sigurisë hekurudhore siç janë:

- Zyra e Auditimit të Brendshëm,
- Kontrollor i Brendshëm,
- Zyra për Standarde dhe Siguri (Zyrtari për Siguri),
- Sektori për Shkollim dhe Mbrojtje në Punë,
- Departamenti i Komunikacionit,
- Departamenti i Mirëmbajtjes së Linjave Hekurudhore dhe
- Departamenti i Elektroteknikës.

Departamenti i Sigurisë ka kryer procesin e mbikëqyrjes së implementimit të Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë (SMS) nga ana e Menaxherit të Infrastrukturës Infrakos datë: (18-22).05.2015

Në vazhdim po e paraqesim raportin me rekomandime të cilin e kemi dërguar në Infrakos-in me datë 10 Qershor 2015, ky raport përmban të gjeturat gjatë procesit të mbikëqyrjes së implementimit të Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë (SMS).

Rekomandimet e më poshtme vlejné pothuajse për të gjithë sektorët dhe të gjitha nivelet e menaxhmentit të Infrakos-it.

23. Menaxhmenti i Infrakos-it duhet të jetë i përkushtuar që politikat e sigurisë, SMS dhe Deklaratat e Konformitetit (DK) të implementohen në tërësi ashtu siç janë paraparë në Manualin e SMS.
24. Sistemi i menaxhimit të sigurisë duhet të dokumentohet në të gjitha pjesët relevante dhe duhet të përshkruaj ndarjen e rolit dhe përgjegjësi, llojin e shërbimeve, vlerësimin e rrezikut etj. siç parashihet në deklaratën FO_DK_05.
25. Shpërndarja e përgjegjësi të bëhet tek të gjithë personat përgjegjës për siguri ashtu siç parashihet në deklaratën FO_DK_06.
26. Sigurimi i kontrollit në të gjitha nivelet e menaxhmentit të bëhet ashtu siç parashihet në deklaratë FO_DK_07.
27. Politika e sigurisë e duhet të shpërndahet të i gjithë stafi përgjegjës për siguri ashtu siç është paraparë në FO_DK_10.
28. Ka pasur një monitorim (auditim) të pjesshëm të sigurisë, monitorimi duhet të kryhet dhe të dokumentohet në baza të rregullta ashtu siç parashihet në deklaratën e konformitetit FO_DK_19.
29. Organizimi i trajnimit (shkollimit) për SMS dhe DK në të gjitha nivelet e Infrakos-it përgjegjëse për siguri, ku personat përgjegjës për shkollim së bashku me menaxherët e secilit sektor do të organizonin trajnimin për stafin e tyre, por gjithmonë me pjesëmarrjen e kontrollorit të brendshëm dhe sektorit për standarde dhe siguri.
30. Të ketë një rritje të komunikimit dhe koordinim me të mirë ndërmjet Departamenti të Komunikacionit, mirëmbajtjes së linjave hekurudhore, elektroteknikës me kontrollorin e brendshëm dhe sektorin për standarde dhe siguri.

31. Raportet për rastet e jashtëzakonshme do të duhej të dërgohen edhe të kontrollori i brendshëm dhe sektori për standarde dhe siguri.
32. Secili departament apo sektor duhet të ketë të emëruar një person përgjegjës për siguri dhe
33. Zbatimi i me rigoroz i rregullores për mbrojtjen në punë.

7.1.3. Inspektimi i linjave hekurudhore

Gjatë vitit 2014 kemi kryer inspektimin e linjave hekurudhore të cilat janë shfrytëzim si dhe ato të cilat nuk janë në shfrytëzim aktualisht siç janë:

- Prishtinë - Fushë Kosovë.
- Fushë Kosovë – Medvec – Magure.
- Fushë Kosovë – Hani i Elezit.
- Fushë Kosovë – Pejë.
- Klinë-Prizren.
- Prishtinë-Podujevë dhe
- Fushë Kosovë-Mitrovicë.

Gjatë inspektimit të linjave hekurudhore janë inspektuar:

- + Sinjalizimi
- + Tunelet
- + Bulonat
- + Binarët
- + Dukshmëria
- + Ndriçimi
- + Mirëmbajtja pranë vijës hekurudhore
- + Urat
- + Traversat
- + Rampat mbrojtëse
- + Kalimet në nivel
- + Platforma e stacioneve
- + Balasti
- + Ndërrueset

Në vazhdim po ju paraqesim vetëm disa nga të gjeturat gjatë inspektimit të linjave hekurudhore në vitin 2014.



Figura 1.



Figura 2.

Ne këto dy fotografi shihet vendkalimi i cili gjendet në hyrje të Pejës në afërsi të pompës së benzinës (USA-H) vendkalimi në fjalë është i pajisur me shenja të rrezikut STOP dhe kryqi i Andreut në të dy anët e rrugës. Me qenë se në këtë vendkalim frekuentojnë numër i madh i automjeteve dhe paraqet rrezik për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion, ky vendkalim duhet të pajiset me rampe mbrojtëse (barrierë) dhe sinjalizim me drite (semafor).



Figura 3.



Figura 4.

Në këto dy fotografi shihet gjendja e urave e cila është njëjtë të shumica e urave, siç shihet në fotografi ura ka mbrojtëse anësore në të dy anët, traversat në gjendje të mirë teknike, gjendja statike e urës e mirë, ura posedon vetëm një rrugë për këmbësor, në fotografimin e dyte shihet se disa bulona të cilët bëjnë lidhjen në mes traversës dhe binarit mungojnë, të disa ura ka mungesë të bulonave të cilët bëjnë lidhjen e traversës me bazamentin e urës.



Figura 5.



Figura 6.

Në këto dy fotografi shihet gjendja e infrastrukturës hekurudhore në dalje të qytetit të Podujevës, siç shihet në fotografi gjendja e binarëve dhe e traversave nuk është aspak e mirë për shkak të mbulimit me baltë dhe mbeturina, problem tjetër paraqet edhe dukuria e ndërtimit të objekteve të banimit në afërsi të hekurudhës.

7.1.4. Inspektimi i mjeteve lëvizëse hekurudhore

Gjatë vitit 2014 kemi kryer inspektimin e mjeteve lëvizëse hekurudhore të cilat janë shfrytëzim nga Trainkos siç janë:

- ✚ Lokomotiva
- ✚ Trena Motorik
- ✚ Vagonë të Udhëtarëve dhe
- ✚ Mjeteve tërheqëse.

Më poshtë po ju paraqesim një rast të inspektimit të mjeteve lëvizëse, në këtë rast të Lokomotivës.

Nr. Evropian: 92 00 2640 007-6	Nr. paraprak: 661/228-003
Nr. Autorizimit: KS 51 2013/0001	Datë: 04.12.2014 – 05.12.2014

Karroceria e pa dëmtuar pa korrozion.

Sistemi i frenimit në baze të dokumentacionit funksional.

Radiolidhja e cila shërben për komunikim në mes të personelit të trenit, drejtuesve të trenit dhe stafit përgjegjësve të stacioneve është funksionale.

Gjami i përparme i pa dëmtuar.

Shpejtësi matësi i cili shërben për matjen e shpejtisë së lëvizjes është funksional.

Fshesat e xhamave të cilat shërbejnë për pastrimin e gjatit të përparmë me qëllim të rritjes së dukshmërisë gjatë lëvizjes janë funksionale.

Dorëza për frenim të vrullshëm e cila shërben për frenim të shpejte në rast të ndonjë rreziku është funksionale.

Dyert në mjetin lëvizës janë të pa dëmtuara hapja dhe mbyllja e tyre bëhet me lehtësi.

Dyshemeja është e pastër dhe e pa dëmtuar.

Shkallet të cilat shërbejnë për hipje dhe zbritje të makinistit dhe personelit të trenit janë stabile.

Sistemi i ngrohjes është funksional.

Sistemi i ndriçimit është funksional.

Buria e cila paralajmëron të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion të kenë kujdes se treni është duke lëvizur është funksionale.

Sistemi kundër zjarrit, lokomotiva në fjalë posedon aparat kundër zjarrit.

Lidhëset e ajrit janë funksionale.

Rekomandim

Në raportin e mirëmbajtjes së mjeteve lëvizëse të shënohen dimensionet e rrotave maksimale, minimale, dhe ekzistuese për të gjitha mjetet lëvizëse të cilat janë në funksion.

Komente

Të vazhdohet mirëmbajtja, minimumi të mbahet gjendja ekzistuese sa i përket elementeve të cilat kanë të bëjnë me sigurinë e mjetit lëvizës.

Këto informata të cilat i kemi paraqitur më lartë na janë ofruar nga përfaqësuesi i kompanisë Trainkos si dhe nga inspektimi që kemi bërë ne.

7.2 Përshkrimi i trajtimit të aspekteve ligjore në raportet vjetore të menaxherëve të infrastrukturës dhe ndërmarrjet hekurudhore - Disponueshmeria e raporteve vjetore para 30 qershorit, në përputhje me ligjin Nr. 04/L-063, neni 103 (6) për hekurudhat e Kosovës si dhe nenin 9 (4) Direktivës për Siguri hekurudhore

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave (ARH) të Kosovës ka pranuar raportin vjetor për vitin 2014 nga menaxheri i infrastrukturës Infrakos me datë 19.06.2015 si dhe raportin vjetor nga ndërmarrja hekurudhore Trainkos me datë 30.06.2015.

Raporti vjetor i sigurisë 2014

- INFRAKOS- Menaxheri i Infrastrukturës hekurudhore (19.06.2015) dhe
- TRAINKOS- Ndërmarrja Hekurudhore (30.06.2015).

7.3. Ankesat nga MI dhe NH ndaj departamentit të sigurisë gjatë vitit 2014

Departamenti i sigurisë nuk ka pranuar asnjë ankesë nga MI dhe NH apo nga ndonjë palë tjetër, për punën të cilën e kemi kryer gjatë vitit 2014.

7.4. Numri i inspektimeve të NH dhe MI gjatë vitit 2014

Inspektimet e linjave hekurudhore		F. Kosovë Medvec Magure	Prishtinë F. Kosovë	F. Kosovë Hani i Elezit	F. Kosovë Pejë	Prishtinë Podujevë	F. Kosovë Mitrovicë	Klinë Prizren
Numri i Inspektimeve	Planifikuar	1	1	1	1	1	1	1
	Pa Planifikuar	/	/	/	/	/	/	/
	Realizuara	1	1	1	1	1	1	1

7.5. Numri i mbikëqyrjeve të sigurisë të NH dhe MI gjatë vitit 2014

Mbikëqyrjet		Certifikatat e lëshuara të sigurisë pjesa A	Certifikatat e lëshuara të sigurisë pjesa B	Autorizimet e lëshuara të sigurisë pjesa A&B	Aktivitete tjera
Numri i Mbikëqyrjeve	Planifikuara	1	1	1	/
	Pa Planifikuara	/	/	/	/
	Realizuara	1	1	1	/

RAPORTIMI MBI ZBATIMIN E METODAVE TË PËRBASHKËTA TË SIGURISË (MPS) PËR VLERËSIMIN E RREZIKUT

Rregullorja Nr 352/2009/EC të Komisionit të datës 24 prill 2009 mbi adoptimin e një metode të përbashkët të sigurisë (MPS) për vlerësimin e rrezikut duhet të aplikohet nga 1 korrik 2012. Edhe pse kjo metodë ka filluar të aplikohet nga shtetet anëtare të BE që nga vitit 2010.



- a) *te të gjitha modifikimet e rëndësishme teknike të mjeteve lëvizëse, siç janë të përcaktuara në nenin 2 (c) të Direktivës 2008/57/EC.*
- b) *të gjitha modifikimet strukturore të rëndësishme për nën-sistemet, ku Neni 15 (1) të Direktivës 2008/57/CE, ose një TSI kërkon atë.*

Bazuar në ligjin 04/L-063 për hekurudhat e Kosovës, metodat e përbashkëta të sigurisë (MPS) –duhet të zhvillohen dhe të përshkruajnë se sa janë vlerësuar dhe arritur caqet e sigurisë dhe përputhshmëria e tyre me kërkesat tjera të sigurisë.

Për vitin 2014 nuk kemi një raportim për atë se sa janë aplikuar MPS.

Si rezultat i kësaj MPS (CSM) janë të përfshira në një fushë me fokus të veçantë në planin tonë të mbikëqyrjes për vitin 2015.

Aktivitetet apo Informacionet lidhur me zbatimin e MPS gjithashtu do ti kemi në vitin 2015.

MASAT ALTERNATIVE PËRMES PËRJASHTIMEVE LIDHUR ME ENTITETIN PËRGJEGJËS PËR MIRËMBAJTJEN (EPM-ECM) SKEMA E CERTIFIKIMIT

Gjatë vitit 2014 nuk kemi ndonjë Entitet Përgjegjës të Mirëmbajtjes të certifikuar, në planin e punës për vitin 2015 kemi paraparë që të përgatitet baza ligjore- rregullore apo udhëzim për certifikimin e Entitetit Përgjegjës të Mirëmbajtjes.

DEPARTAMENTI I SIGURISË KONKLuzionET PËR VITIN E RAPORTIMIT - PRIORITETET

Departamenti i sigurisë gjatë vitit 2014 ka vazhduar me mbikëqyrjen e vazhdueshme të sigurisë me qëllim të rritjes së nivelit të sigurisë në sektorin hekurudhor.

Fushat specifike të fokusuara:

- *përdorimi aktiv i analizës së rrezikut dhe njohja e MPS (CSM),*
- *autorizimin e mjeteve lëvizëse të menaxherit të infrastrukturës,*
- *autorizimin e mjeteve lëvizëse të ndërmarrjes hekurudhore,*
- *përfshirja aktive e menaxhmentit në rritjen e sigurisë,*
- *Rreziku lidhur me kushtet në rrjetin kombëtar dhe trajtimin e rrezikut lidhur me kushtet ekstreme të motit.*



Promovimi aktiv i sigurisë do të vazhdojnë nëpërmjet kontakteve të drejtpërdrejta ndërmjet ARH, NH dhe MI.

BURIMET E INFORMACIONIT

Raporti vjetor i sigurisë për vitin 2014, është përgatitur nga raportet e sigurisë të Infrakosit dhe Trainkosit si dhe nga aktivitetet e kryera gjatë vitit 2014 nga departamenti i sigurisë.

Menaxheri i Infrastrukturës	Data e dorëzimit të raportit të sigurisë
Infrakos Sh.A	19.06.2015

Ndërmarrja hekurudhore (NH)	Data e dorëzimit të raportit të sigurisë
Trainkos Sh.A	30.06.2014

Inspektimet	Data e dorëzimit të raportit të inspektimit me rekomandime të sigurisë për Infrakos-in
Infrastruktura	30.12.2014

Inspektimet	Data e dorëzimit të raportit të inspektimit me rekomandime të sigurisë për Trainkos-in
Mjetet lëvizëse	30.12.2014

L/ Anekset

ANEKSI A - STRUKTURA E INFORMACIONEVE HEKURUDHORE

A.1. Harta e rrjetit




Figura 7.



Figura 8.




Figura 9.

A.2. Lista e menaxherëve të infrastrukturës (MI) dhe ndërmarrjeve hekurudhore (NH)

A2.1. Menaxheri i Infrastrukturës

Emri	Adresa	Web faqja	Autorizimi i Sigurisë A-B (datë/numer)	Data e fillimit të aktivitetit komercial	Gjatësia e përgjithshme e linjës/gjerësia
Infrakos Sh.A.	Sheshi i Lirisë pn. 12000 Fushë Kosovë Republika e Kosovës	www.infrakos.com	24.01.2013 KS 21 2013 001 KS 22 2013 001	23.12.2005	333.451/1435

A.2.2. Ndërmarrja Hekurudhore

Emri	Adresa	Web faqja	Certifikata e Sigurisë A-B (datë/numer)	Data e fillimit të aktivitetit komercial
Trainkos Sh.A.	Sheshi i Lirisë pn. 12000 Fushë Kosovë Republika e Kosovës	www.trainkos.com	24.01.2013 KS 11 2013 001 KS 12 2013 001	16.08.2011

Aneksi

B - Struktura Organizative

B.1. Grafiku: Organizimi i brendshëm i ARH-së gjatë vitit 2014 ishte si më poshtë.




Figura 10.

B.2. Grafiku: Rrjedha Organizative (marrëdhëniet) ndërmjet Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave (ARH) me organet e tjera kombëtare






Figura 11.




Aneksi C - Zhvillimet në sigurinë hekurudhore

C.1. Të dhënat për metodat e përbashkëta të sigurisë


Rezultatet




Trendi i zhvillimeve për udhëtarë dhe mallëra 2014



Numri i vendkalimeve



Vendkalimet në vitin 2014



C.2. Definicionet e përdorura në raportin vjetor

C.2.1. Definicionet e zbatueshme në pajtim me ligjin 04/L-063 për hekurudhat e Kosovë dhe Rregulloren Nr 2003/91/EC

Person i vrarë

Do të thotë çdo person i vrarë menjëherë ose vdekur brenda 30 ditëve, si rezultat i një aksidenti, me përjashtim të vetëvrasjeve;

Person i plagosur rëndë

Nënkupton çdo person i plagosur i cili është shtruar në spital për më shumë se 24 orë, si pasojë e një aksidenti, duke përjashtuar tentim vetëvrasjet;

Km-Udhëtarëve

Nënkupton njësinë e masës që përfaqëson transportin e një udhëtari me hekurudhë gjatë një distancë prej një kilometri. Vetëm distanca në territorin kombëtar të raportimit Vendi do të merren parasysh;

Vetëvrasje

Nënkupton aktin me dashje të lëndojë veten duke rezultuar në vdekje, regjistruar dhe klasifikuar si i tillë nga autoriteti kompetent kombëtar;

Aksidenti

Nënkupton ngjarjen e padëshirueshme dhe të paqëllimtë apo zinxhirin specifik të ngjarjeve të tilla të cilat kanë pasoja dëmtuese;

Aksidenti serioz

Nënkupton ndonjë ndeshje apo rrëshqitje të trenave që rezulton në vdekjen e të paktën një personi apo lëndimet serioze të së paku pesë apo më shumë personave apo dëmtim të gjerë të mjeteve lëvizëse hekurudhore, infrastrukturës dhe mjedisit apo ndonjë aksident tjetër i ngjashme me ndikim të dukshëm në rregulloren e sigurisë hekurudhore apo në menaxhimin e sigurisë;

Incidenti

Nënkupton ndonjë ndodhi tjetër nga aksidenti apo aksidenti serioz që shoqërohet me operimin e trenave dhe që ka efekt në sigurinë e operimit;

**Treni**

Nënkupton kompozicionin e mjeteve lëvizëse hekurudhore duke përfshirë këtu edhe tërheqjen;

Vendkalimi

Nënkupton kryqëzimin e vijës hekurudhore me infrastrukturën rrugore në të njëjtin nivel;



Fig 3

ANEKSI D - Zhvillimi i certifikatës dhe autorizimit të sigurisë - të dhënat numerike

D.1. certifikatat e sigurisë në përputhje me ligjin nr. 04/L-063 dhe Direktivën 2004/49/EC

	Numri i përgjithshëm i certifikatave	Numri i certifikatave pjesa A në ERADIS
D.1.1. Numri i certifikatave të sigurisë pjesa A të lëshuara në Kosovë në vitin raportues dhe në vitet e mëparshme dhe të cilat janë të vlefshme deri në fund të vitit 2014	1	0

	Numri i përgjithshëm i certifikatave pjesa B	Numri i certifikatave pjesa B në ERADIS
D.1.2. Numri i certifikatave të sigurisë Pjesa B të lëshuara në Kosovë në vitin raportues dhe në vitet e mëparshme dhe të cilat janë të vlefshme deri në fund të vitit 2014	Numri i certifikatave pjesa B, për të cilën pjesa A ka qenë e lëshuar në Kosovë	0
	Numri i certifikatave pjesa B, për të cilën pjesa A ka qenë e lëshuar në një shtet tjetër	0

		A	R	P
D.1.3. Numri i aplikacioneve të reja për certifikatë të sigurisë pjesa A dorëzuar nga ndërmarrjet hekurudhore në vitin 201	Certifikatë e re	0	0	0
	Certifikatë e rinovuar	0	0	0
	Certifikatë e ndryshuar	0	0	0

			A	R	P
D.1.4. Numri i aplikacioneve të reja për certifikatë të sigurisë pjesa B dorëzuar nga ndërmarrjet hekurudhore në vitin 2014	Kurë pjesa A është lëshuar në Kosovë	Certifikatë e re	0	0	0
		Certifikatë e rinovuar	0	0	0
		Certifikatë e ndryshuar	0	0	0
	Kurë pjesa A është lëshuar në një shtet tjetër	Certifikatë e re	0	0	0
		Certifikatë e rinovuar	0	0	0
		Certifikatë e ndryshuar	0	0	0

A = pranuar (accepted): aplikimi pranohet, certifikata tashmë është lëshuar
R = refuzuar (rejected): aplikimi refuzohet, asnjë certifikatë nuk është lëshuar
P = pritje (pending): rasti është ende në pritje, asnjë certifikatë është lëshuar deri më tani.

	Numri i përgjithshëm i certifikatave të anuluar pjesa A në 2013	Numri i certifikatave të anuluar pjesa A në ERADIS
D.1.5. Numri i certifikatave të sigurisë pjesa A të anuluar në vitin raportues 2013	0	0
D.1.6. Numri i certifikatave të sigurisë pjesa B të anuluar në vitin raportues 2013	0	0

D.1.1. Lista e vendeve prej nga një NH ka aplikuar për një certifikatë të sigurisë pjesa B në Kosovë, e cila e ka marrë certifikatën e sigurisë pjesa A.

Emri i NH	Shteti ku certifikata e sigurisë pjesa A është lëshuar
/	/

D.2. autorizimi i sigurisë në përputhje me ligjin nr. 04/L-063 dhe Direktivën 2004/49/EC

	Numri i përgjithshëm i autorizimeve të sigurisë
D2.1. Numri i autorizimeve të sigurisë të lëshuara për menaxherët e infrastrukturës në vitin raportues dhe nga vitet e më parshëm, të cilat janë valide deri në fund të vitit 2014.	1

		A	R	P
D.2.2. Numri i aplikacioneve të reja për autorizim të sigurisë dorëzuar nga menaxherët e infrastrukturës në vitin 2014.	Autorizim i ri	0	0	0
	Autorizim i rinovuar	0	0	0
	Autorizim i ndryshuar	0	0	0

A = pranuar (accepted): aplikimi pranohet, autorizimi tashmë është lëshuar

R = refuzuar (rejected): aplikimi refuzohet, asnjë autorizim nuk është lëshuar

P = pritje (pending): rasti është ende në pritje, asnjë autorizim është lëshuar deri më tani.

D.2.1. Numri i autorizimeve të sigurisë të anuluar gjatë vitit raportues	0
--	---



Figura 14.

D.3. Aspektet procedurale- certifikata e sigurisë pjesa A

	I ri	Përditësuar/Ndryshuar	Rinovuar
Koha mesatare në mes të pranimit të aplikimit me informacionin e nevojshëm dhe dhënia finale e certifikatës së sigurisë pjesa A për ndërmarrjet hekurudhore.	3 javë	/	/

D.4. Aspektet procedurale- certifikata e sigurisë pjesa B

		I ri	Përditësuar/Ndryshuar	Rinovuar
	Kurë pjesa A është lëshuar në Kosovë	3 javë	/	/
Koha mesatare në mes të pranimit të aplikimit me informacionin e nevojshëm dhe dhënia finale e certifikatës së sigurisë pjesa B për ndërmarrjet hekurudhore	Kurë pjesa B është lëshuar në një shtet tjetër	3 javë	/	/

D.5. Aspektet procedurale- autorizimi i sigurisë pjesa A

	I ri	Përditësuar/Ndryshuar	Rinovuar
Koha mesatare në mes të pranimit të aplikimit me informacionin e nevojshëm dhe dhënia finale e autorizimit të sigurisë pjesa A, për menaxherët e infrastrukturës në vitin 2013	3 javë	/	/

D.6. Aspektet procedurale- autorizimi i sigurisë pjesa B

	I ri	Përditësuar/Ndryshuar	Rinovuar
Koha mesatare në mes të pranimit të aplikimit me informacionin e nevojshëm dhe dhënia finale e autorizimit të sigurisë pjesa B, për menaxherët e infrastrukturës në vitin 2013	3 javë	/	/

Këto të dhëna përfshijnë kohën e përgjithshme nga pranimi i aplikimit për dhënien e certifikatës apo autorizimit, duke përfshirë edhe kohën e nevojshme për kompletimin e dokumentacionit dhe certifikatave/ autorizimeve. Për ndërmarrjen hekurudhore dhe menaxherin e infrastrukturës nga Kosova përpunimi i aplikacioneve për pjesën A dhe B është bërë së bashku për këtë arsye kohet janë identike.



Lista e shkurtesave

ARH	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave të Kosovës
ERA	European Railway Agency
SEETO	South East European Transport Observer
MI	Menaxheri i Infrastrukturës
NH	Ndërmarrja Hekurudhore
SMS	Sistemi për Menaxhimin e Sigurisë
TPS	Treguesit e Përbashkët të Sigurisë
OHA	Organi për Hetimin e Aksidenteve
RINF	Regjistri i Infrastrukturës
A	Accepted
R	Rejected
P	Pending
TSI	Technical Specifications for Interoperability
STI	Specifikat Teknike për Interoperabilitet
MPS	Metodat e Përbashkëta të Sigurisë
EPM	Entiteti Përgjegjës për Mirëmbajtje
ECM	Entity in Charge for Maintenance
KHAIA	Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike

**8.9. SHTOJCË VI****8.9.1. Raporti me rekomandime të sigurisë dërguar Ferronikelit.****DEPARTAMENTI I SIGURISË****FORMULAR PËR INSPEKTIMIN E VAGONAVE TË MALLRAVE – FERONIKEL****DATË: 09-12-2015**

Nr	Emërtimi		Fletëzimi i vagonëve / Shenjëzimi reflektues	Dimenzionimi i rrotave pas gdhendjes	Trashësia e rrotave	Papuçet frenuese	Gjendja fizike e vagonëve	Lidhëset e ajrit	Çengel i	Hapja / mbyllja e vagonetave
1	Numri Paraprak	33 72 665 7056-9	Vagoni është jashtë operimit							
	Numri Evropian	33 00 6657 001-2								
2	Numri Paraprak	33 72 665 7044-5	Mungon	Nuk ka të dhëna për dimensionet e lejuara	Gjendja e mirë	Gjendja pjesërisht e mirë	E mirë	Funksionale	E mirë	Funksionale
	Numri Evropian	33 00 6657 002-0								
3	Numri Paraprak	33 72 665 7049-4	Mungon	Nuk ka të dhëna për dimensionet e lejuara	Gjendja e mirë	Gjendja pjesërisht e mirë	E mirë	Funksionale	E mirë	Funksionale
	Numri Evropian	33 00 6657 003-8								
4	Numri Paraprak	33 72 665 7057-7	Mungon	Nuk ka të dhëna për dimensionet e lejuara	Gjendja e mirë	Gjendja e mirë	E mirë	Funksionale	E mirë	Funksionale
	Numri Evropian	33 00 6657 004-6								
5	Numri Paraprak	33 72 665 7054-4	Vagoni është jashtë operimit							
	Numri Evropian	33 00 6657 005-3								

6	Numri Paraprak	33 72 665 7041-1	Mungon	Nuk ka të dhëna për dimensionet e lejuara	Gjendja e mirë	Gjendja e mirë	E mirë	Funksionale	E mirë	Funksionale
	Numri Evropian	33 00 6657 006-1								
7	Numri Paraprak	33 72 665 7043-7	Mungon	Nuk ka të dhëna për dimensionet e lejuara	Gjendja e mirë	Gjendja e mirë	E mirë	Funksionale	E mirë	Funksionale
	Numri Evropian	33 00 6657 007-9								
8	Numri Paraprak	33 72 665 7060-1	Mungon	Nuk ka të dhëna për dimensionet e lejuara	Gjendja e mirë	Gjendja e mirë	E mirë	Funksionale	E mirë	Funksionale
	Numri Evropian	33 00 6657 008-7								
9	Numri Paraprak	33 72 665 7042-9	Mungon	Nuk ka të dhëna për dimensionet e lejuara	Gjendja e mirë	Gjendja e mirë	E mirë	Funksionale	E mirë	Funksionale
	Numri Evropian	33 00 6657 009-5								
10	Numri Paraprak	33 72 665 7048-6	Mungon	Nuk ka të dhëna për dimensionet e lejuara	Gjendja e mirë	Gjendja e mirë	E mirë	Funksionale	E mirë	Funksionale
	Numri Evropian	33 00 6657 010-3								
11	Numri Paraprak	33 72 665 7061-9	Mungon	Nuk ka të dhëna për dimensionet e lejuara	Gjendja e mirë	Gjendja e mirë	E mirë	Funksionale	E mirë	Funksionale
	Numri Evropian	33 00 6657 011-1								
12	Numri Paraprak	33 72 665 7046-0	Mungon	Nuk ka të dhëna për dimensionet e lejuara	Afër harxhimit të rrotave	Gjendja e mirë	E mirë	Funksionale	E mirë	Funksionale
	Numri Evropian	33 00 6657 012-9								
13	Numri Paraprak	33 72 665 7051-0	Mungon	Mungesa e të dhënave në formular	Gjendja e mirë	Gjendja pjesërisht e mirë	E mirë	Funksionale	E mirë	Funksionale
	Numri Evropian	33 00 6657 013-7								
14	Numri Paraprak	33 72 665 7058-5	Mungon	Nuk ka të dhëna për dimensionet e lejuara	Gjendja e mirë	Gjendja e mirë	E mirë	Funksionale	E mirë	Funksionale
	Numri Evropian	33 00 6657 014-5								
15	Numri Paraprak	33 72 665 7040-3	Mungon	Nuk ka të dhëna për dimensionet e lejuara	Gjendja e mirë	Gjendja e mirë	E mirë	Funksionale	E mirë	Funksionale
	Numri Evropian	33 00 6657 015-2								
16	Numri Paraprak	33 72 665 7052-8	Mungon	Nuk ka të dhëna për dimensionet e lejuara	Gjendja e mirë	Gjendja pjesërisht e mirë	E mirë	Funksionale	E mirë	Funksionale
	Numri Evropian	33 00 6657 016-0								
17	Numri Paraprak	33 72 665 7053-6	Mungon	Nuk ka të dhëna për dimensionet e lejuara	Gjendja e mirë	Gjendja e mirë	E mirë	Funksionale	E mirë	Funksionale
	Numri Evropian	33 00 6657 017-8								
18	Numri Paraprak	33 72 665 7047-8	Mungon	Nuk ka të dhëna për dimensionet e lejuara	Gjendja e mirë	Gjendja pjesërisht e mirë	E mirë	Funksionale	E mirë	Funksionale
	Numri Evropian	33 00 6657 018-6								
19	Numri Paraprak	33 72 665 7045-2	Mungon	Nuk ka të dhëna për dimensionet e lejuara	Gjendja e mirë	Gjendja e mirë	E mirë	Funksionale	E mirë	Funksionale
	Numri Evropian	33 00 6657 019-4								

20	Numri Paraprak	33 72 665 7055-1	Mungon	Nuk ka te dhëna për dimensionet e lejuara	Gjendja e mirë	Gjendja e mirë	E mirë	Funksionale	E mirë	Funksionale
	Numri Evropian	33 00 6657 020-2								
21	Numri Paraprak	33 72 665 7062-7	Mungon	Nuk ka te dhëna për dimensionet e lejuara	Gjendja e mirë	Gjendja e mirë	E mirë	Funksionale	E mirë	Funksionale
	Numri Evropian	33 00 6657 021-0								
22	Numri Paraprak	33 72 665 7050-2	Mungon	Nuk ka te dhëna për dimensionet e lejuara	Gjendja e mirë	Gjendja pjesërisht e mirë	E mirë	Funksionale	E mirë	Funksionale
	Numri Evropian	33 00 6657 022-8								
23	Numri Paraprak	33 72 665 7064-3	Mungon	Nuk ka te dhëna për dimensionet e lejuara	Gjendja e mirë	Gjendja e mirë	E mirë	Funksionale	E mirë	Funksionale
	Numri Evropian	33 00 6657 023-6								
24	Numri Paraprak	33 72 665 7059-3	Mungon	Nuk ka te dhëna për dimensionet e lejuara	Afër harxhimit të rrotave	Gjendja e mirë	E mirë	Funksionale	E mirë	Funksionale
	Numri Evropian	33 00 6657 024-4								

Rekomandimet:

- Te behet fletëzimi te gjithë vagonët
- Te behet shenjëzimit reflektues i te gjithë vagonëve
- Te behet ndërrimi i papuçeve frenuese te vagonët te cilët janë harxhuar
- Te shkruhen ne formularin e mirëmbajtjes dimensionet e rrotave pas gdhendjes
- Hapja dhe mbyllja e vagonëve është në gjendje të mirë te të gjithë vagonët
- Lidhëset e ajrit ne gjendje te mire te të gjithë vagonët
- Gjendja fizike e vagonëve të mallit është e mire te të gjithë vagonët
- Çengeli ne gjendje te mire te të gjithë vagonët

VAGONI I MALLIT

Numri paraparak 33 72 665 7044-5

Numri evropian 33 00 6657 002-0



- Mungesa e fletëzimit të të gjithë vagonët
- Te behet shenjëzimit reflektues i të gjithë vagonëve
- Papuçet frenuese disa prej tyre janë të harxhuara
- Lidhëset e ajrit në gjendje të mire (funksionale)
- Gjendja e profilit të rrotave të mire (profili i mjaftueshëm)
- Hapja dhe mbyllja e vagonëve në gjendje të mirë (funksionale)
- Gjendja fizike e vagonit është e mirë
- Çengeli në gjendje të mire (funksionale)

VAGONI I MALLIT

Numri paraparak 33 72 665 7049-4

Numri evropian 33 00 6657 003-8





- Mungesa e fletëzimit të të gjithë vagonët
- Te behet shenjëzimit reflektues i të gjithë vagonëve
- Papuçet frenuese disa prej tyre janë të harxhuara
- Lidhëset e ajrit në gjendje të mire (funksionale)
- Gjendja e profilin të rrotave të mire (profili i mjaftueshëm)
- Hapja dhe mbyllja e vagonëve në gjendje të mirë (funksionale)
- Gjendja fizike e vagonit është e mirë
- Çengeli në gjendje të mire (funksionale)

VAGONI I MALLIT

Numri paraprak 33 72 665 7046-0

Numri evropian 33 00 6657 012-9



- Mungesa e fletëzimit të të gjithë vagonët
- Te behet shenjëzimit reflektues i të gjithë vagonëve
- Papuçet frenuese në gjendje të mire
- Lidhëset e ajrit në gjendje të mire (funksionale)
- Gjendja e profilin të rrotave afër harxhimit
- Hapja dhe mbyllja e vagonëve në gjendje të mirë (funksionale)
- Gjendja fizike e vagonit është e mirë
- Çengeli në gjendje të mire (funksionale)

VAGONI I MALLIT

Numri paraparak 33 72 665 7051-0

Numri evropian 33 00 6657 013-7



- Mungesa e fletëzimit të të gjithë vagonët
- Te behet shenjëzimit reflektues i të gjithë vagonëve
- Papuçet frenuese disa prej tyre janë të harxhuara
- Lidhëset e ajrit në gjendje të mire (funksionale)
- Gjendja e profilit të rrotave të mire (profili i mjaftueshëm)
- Hapja dhe mbyllja e vagonëve në gjendje të mirë (funksionale)
- Gjendja fizike e vagonit është e mirë
- Çengeli në gjendje të mire (funksionale)

VAGONI I MALLIT

Numri paraparak 33 72 665 7052-8

Numri evropian 33 00 6657 016-0



- Mungesa e fletëzimit të të gjithë vagonët
- Te behet shenjëzimit reflektues i të gjithë vagonëve
- Papuçet frenuese disa prej tyre janë të harxhuara
- Lidhëset e ajrit në gjendje të mire (funksionale)
- Gjendja e profilit të rrotave të mire (profili i mjaftueshëm)
- Hapja dhe mbyllja e vagonëve në gjendje të mirë (funksionale)
- Gjendja fizike e vagonit është e mirë
- Çengeli në gjendje të mire (funksionale)

VAGONI I MALLIT

Numri paraprak 33 72 665 7047-8

Numri evropian 33 00 6657 018-6



- Mungesa e fletëzimit të të gjithë vagonët
- Te behet shenjëzimit reflektues i të gjithë vagonëve
- Papuçet frenuese disa prej tyre janë të harxhuara
- Lidhëset e ajrit në gjendje të mire (funksionale)
- Gjendja e profilit të rrotave të mire (profili i mjaftueshëm)
- Hapja dhe mbyllja e vagonëve në gjendje të mirë (funksionale)
- Gjendja fizike e vagonit është e mirë
- Çengeli në gjendje të mire (funksionale)

VAGONI I MALLIT

Numri paraparak 33 72 665 7050-2

Numri evropian 33 00 6657 022-8



- Mungesa e fletëzimit të të gjithë vagonët
- Te behet shenjëzimit reflektues i të gjithë vagonëve
- Papuçet frenuese disa prej tyre janë të harxhuara
- Lidhëset e ajrit në gjendje të mire (funksionale)
- Gjendja e profilit të rrotave të mire (profili i mjaftueshëm)
- Hapja dhe mbyllja e vagonëve në gjendje të mirë (funksionale)
- Gjendja fizike e vagonit është e mirë
- Çengeli në gjendje të mire (funksionale)

VAGONI I MALLIT

Numri paraparak 33 72 665 7059-3

Numri evropian 33 00 6657 024-4





- Mungesa e fletëzimit të të gjithë vagonët
- Te behet shenjëzimit reflektues i të gjithë vagonëve
- Papuçet frenuese në gjendje të mirë
- Lidhëset e ajrit në gjendje të mirë (funksionale)
- Gjendja e profilit të rrotave afër harxhimit
- Hapja dhe mbyllja e vagonëve në gjendje të mirë (funksionale)
- Gjendja fizike e vagonit është e mirë
- Çengeli në gjendje të mirë (funksionale)

**8.10. SHTOJCË VII****8.10.1. Raporti me rekomandime të sigurisë dërguar Trainkos-it.****DEPARTAMENTI I SIGURISË****RAPORTI I INSPEKTIMIT TË MJETEVE LËVIZËSE HEKURUDHORE
LOKOMOTIVAT**

Nr.	Emërtimi		Buria / Radio Lidhja	Gjendja e rrotave	Papuçet frenuese	Shpejtësi matësi	Karroceria	Sistemi i ndriçimit / Sistemi i frenimit	Xhami i përparmë dhe anësorët	Sistemi kundër zjarrit	Hapja / mbyllja e dyerve
1	Numri Paraprak	Di / 3 619-005	Jashtë funksioni								
	Numri Evropian	92 00 2640 001-9									
2	Numri Paraprak	Di / 3 633-006	Jashtë funksioni								
	Numri Evropian	92 00 2640 002-7									
3	Numri Paraprak	Di / 3 641-007	Funksionale	Gjendja e mirë	Gjendja e mirë	Funksional	Funksionale	Gjendja e mirë	Gjendja e mirë	I pajisur	E mirë
	Numri Evropian	92 00 2640 003-5									
4	Numri Paraprak	Di / 3 643-008	Jashtë funksioni (Një motor tërheqjes ka rezistencë shumë të ulët. PG rregullatori nuk i punon dhe nuk ka fuqi tërheqëse)								
	Numri Evropian	92 00 2640 004-3									



5	Numri Paraprak	645 / 033-001	Funksionale	Gjendja e mirë	Gjendja e mirë	Funksional	Funksionale	Gjendja e mirë	I krisur	I pajisur	E mirë
	Numri Evropian	92 00 2620 005-4									
6	Numri Paraprak	661 / 132-002	Jashtë funksioni (Boshti i kollodokut, rezistenca e ulët në gjenerator kryesor dhe motor tërheqës)								
	Numri Evropian	92 00 2640 006-8									
7	Numri Paraprak	661 / 228-003	Funksionale	Gjendja e mirë	Gjendja e mirë	Funksional	Funksionale	Gjendja e mirë	I krisur	I pajisur	E mirë
	Numri Evropian	92 00 2640 007-6									
8	Numri Paraprak	661 / 231-004	Jashtë funksionit (Dëmtimi i boshtit të kollodokut)								
	Numri Evropian	92 00 2640 008-4									
9	Numri Paraprak	G1700-2 BB-009	Jashtë funksionit (Dizel motori është i dëmtuar)								
	Numri Evropian	92 00 2710 009-7									
10	Numri Paraprak	661/203 JT 38 CW - 009	Funksionale	Gjendja e mirë	Gjendja e mirë	Funksional	Funksionale	Gjendja e mirë	Gjendja e mirë	I pajisur	E mirë
	Numri Evropian	92 00 2640 010-0									
11	Numri Paraprak	661 / 114	Jashtë funksionit								
	Numri Evropian	92 00 2640 011-8									
12	Numri Paraprak	661 / 128	Jashtë funksionit								
	Numri Evropian	92 00 2640 012-6									
13	Numri Paraprak	661 / 254	Jashtë funksionit								
	Numri Evropian	92 00 2640 013-4									
14	Numri Paraprak	661 / 261	Jashtë funksionit								
	Numri Evropian	92 00 2640 014-2									
15	Numri Paraprak	664 / 062	Jashtë funksionit								
	Numri Evropian	92 00 2640 015-9									

Koment:

- Këto informata të cilat i kemi paraqitur më lartë na janë ofruar nga përfaqësuesit Trainkos si dhe nga informatat e mbledhura nga aktivitetet tona gjatë inspektimeve.

PËRSHKRIMI I LOKOMOTIVËS:

LOKOMOTIVA

- Numri paraprak Di / 3 619-005
- Numri evropian 92 00 2640 001-9



Rekomandimet:

- Xhami i përparmë i krisur (të bëhet ndërrimi i xhamit me qellim të rritjes së dukshmërisë gjatë lëvizjes),
- Mungojnë dimensionet nominale të rrotave në formularin e mirëmbajtjes (Përshkrimi i dimensionit të lejuar).

PËRSHKRIMI I LOKOMOTIVËS:

LOKOMOTIVA

- Numri paraprak Di / 3 633-006
- Numri evropian 92 00 2640 002-7



Koment:

- Jashtë funksioni,
- Mungojnë dimensionet nominale të rrotave në formularin e mirëmbajtjes (Përshkrimi i dimensionit të lejuar).

PËRSHKRIMI I LOKOMOTIVËS:

LOKOMOTIVA

- Numri paraprak Di / 3 643-008
- Numri evropian 92 00 2640 004-3



Koment:

- Lokomotiva është jashtë funksioni (Një motor tërheqjes ka rezistencë shumë të ulët. PG rregullatori nuk i punon dhe nuk ka fuqi tërheqëse),
- Mungojnë dimensionet nominale të rrotave në formularin e mirëmbajtjes (Përshkrimi i dimensionit të lejuar).

PËRSHKRIMI I LOKOMOTIVËS:

LOKOMOTIVA

- Numri paraprak 661 / 132-002
- Numri evropian 92 00 2640 006-8



Koment:

- Lokomotiva është jashtë funksioni (Boshti i kollodokut, rezistenca e ulët në gjenerator kryesor dhe motor tërheqës).
- Mungojnë dimensionet nominale të rrotave në formularin e mirëmbajtjes (Përshkrimi i dimensionit të lejuar).

PËRSHKRIMI I LOKOMOTIVËS:

LOKOMOTIVA

- Numri paraprak 661 / 231-004
- Numri evropian 92 00 2640 008-4



Koment:

- Lokomotiva është jashtë funksioni (Dëmtimi i boshtit të kollodokut)
- Mungojnë dimensionet nominale të rrotave në formularin e mirëmbajtjes (Përshkrimi i dimensionit të lejuar).

PËRSHKRIMI I LOKOMOTIVËS:

LOKOMOTIVA

- Numri paraprak G1700-2 BB-009
- Numri evropian 92 00 2710 009-7





Koment:

- Lokomotiva është jashtë funksionit (Dizel motori është i dëmtuar)
- Mungojnë dimensionet nominale të rrotave në formularin e mirëmbajtjes (Përshkrimi i dimensionit të lejuar).

LOKOMOTIVAT MANOVRUESE

Nr	Emërtimi		Buria / Radio Lidhja	Trashësia e rrotave	Sistemi i frenimit	Shpejtësi matësi	Karroceria	Sistemi i ndriçimit	Xhami i përparmë dhe anësorët	Sistemi kundër zjarrit	Hapja / mbyllja e dyerve
1	Numri Paraprak	MDD3 / 01	Funksionale	Gjendja e mirë	Gjendja e mirë	Funksional	Funksionale	Gjendja e mirë	I krisur	I pajisur	E mirë
	Numri Evropian	92 00 2760 001-3									
2	Numri Paraprak	MDD3 / 02	Funksionale	Gjendja e mirë	Gjendja e mirë	Funksional	Funksionale	Gjendja e mirë	Gjendja e mirë	I pajisur	E mirë
	Numri Evropian	92 00 2760 002-1									
3	Numri Paraprak	641 / 111	Jashtë funksionit								
	Numri Evropian	92 00 2660 003-0									
4	Numri Paraprak	641 / 112	Jashtë funksionit								
	Numri Evropian	92 00 2660 004-8									
5	Numri Paraprak	641 / 122	Jashtë funksionit								
	Numri Evropian	92 00 2660 005-5									
6	Numri Paraprak	641 / 129	Jashtë funksionit								
	Numri Evropian	92 00 2660 006-3									



7	Numri Paraprak	641 / 130	Jashtë funksionit
	Numri Evropian	92 00 2660 007-1	
8	Numri Paraprak	641 / 131	Jashtë funksionit
	Numri Evropian	92 00 2660 008-9	
9	Numri Paraprak	641 / 203	Jashtë funksionit
	Numri Evropian	92 00 2660 009-7	
10	Numri Paraprak	641 / 204	Jashtë funksionit
	Numri Evropian	92 00 2660 010-5	
11	Numri Paraprak	641 / 211	Jashtë funksionit
	Numri Evropian	92 00 2660 011-3	
12	Numri Paraprak	641 / 212	Jashtë funksionit
	Numri Evropian	92 00 2660 012-1	
13	Numri Paraprak	642 / 3 015	Jashtë funksionit
	Numri Evropian	92 00 2660 013-9	
14	Numri Paraprak	642 / 3 018	Jashtë funksionit
	Numri Evropian	92 00 2660 014-7	
15	Numri Paraprak	734 / 031	Jashtë funksionit
	Numri Evropian	92 00 2760 015-3	
16	Numri Paraprak	734 / 109	Jashtë funksionit
	Numri Evropian	92 00 2760 016-1	
17	Numri Paraprak	M 548	Jashtë funksionit
	Numri Evropian	92 00 2760 017-9	

PËRSHKRIMI: LOKOMOTIVAT MANOVRUESE:**LOKOMOTIVA MANOVRUESE**

- Numri paraprak MDD3 / 01
- Numri evropian 92 00 2760 001-3

**Koment:**

- Xhami anësor është improvizim dhe xhami i përparmë është i krisur (ndërrimi i xhamave me qëllim të rritjes së dukshmërisë gjatë lëvizjes).
- Mungojnë dimensionet nominale të rrotave në formularin e mirëmbajtjes (Përshkrimi i dimensionit të lejuar).
- Këto informata të cilat i kemi paraqitur më lartë na janë ofruar nga përfaqësuesit Trainkos si dhe nga informatat e mbledhura nga aktivitetet tona gjatë inspektimeve.
- Si përfundim disa nga të gjeturat gjatë inspektimeve tona janë rekomandime nga viti i kaluar të cilat është dashur të plotësohen Gjatë këtij viti kalendarik, prandaj kërkojmë nga Trainkos që komentet tona të merren në konsideratë dhe të punohet më shumë në plotësimin e tyre.



8.8. SHTOJCË VIII

8.8.1. Raporti me rekomandime të sigurisë dërguar Infrakos-it.

INSPEKTIMI I LINJËS HEKURUDHORE FUSHË KOSOVË-MAGURË

Datë: 13.09.2015

Gjatë inspektimit te linjës hekurudhore Fushë Kosovë-Magurë
janë inspektuar

- + Sinjalizimi
- + Traversat
- + Rampat mbrojtëse
- + Kalimet në nivel
- + Platforma e stacionit

- + Balasti
- + Ndërrueset
- + Bulonat
- + Binarët
- + Dukshmëria
- + Ndriçimi
- + Mirëmbajtja pranë vijës hekurudhore



Fig.1



Fig.2

Ne këto dy fotografi shihet vendkalimi i cili gjendet rrugës për Aeroport, vendkalimi është i pajisur me shenjat e rrezikut STOP dhe kryqi i ANDREUT vetëm ne njërën ane te rrugës, pasi qe ne pjesën tjetër te rrugës shenjat e rrezikut janë te rrëzuara, dukshmëria afër vendkalimit është e mire, vendkalimi nuk ka sistem te sinjalizimit apo rampe mbrojtëse. Krahasuar me vitin paraprak gjendja ne vendkalim është me e mire sa i përket pastrimit nga shkurret ne afërsi te vendkalimit, sa i përket parametrave tjerë te sigurisë gjendja është e njëjte. Me qenë se ne këtë vendkalim frekuentojnë një numër i madhe i automjeteve dhe paraqet rrezik për te gjithë pjesëmarrësit e komunikacionit, ky vendkalim duhet te sigurohet me sistem te sinjalizimit apo rampe mbrojtëse (barriere).



Fig.3



Fig.4

Ne këto dy fotografi shihet vendkalimi i cili gjendet te hyrja e vjetër e Aeroportit, krahasuar me vitin paraprak ky vendkalim ka nevojë te pastrohet nga barishtat te cilat gjenden fare pranë vendkalimit gjë qe e zvogëlon dukshmërinë e lëvizjes, sa i përket parametrave tjerë te sigurisë vendkalimi është i siguruar me shenjen STOP vetëm ne njërën ane te rrugës. Për shkak te frekuentimit te automjeteve nëpër këtë vendkalim, rekomandojmë qe Menaxheri i Infrastrukturës ne bashkëpunim me Aeroportin ndërkombëtar te Prishtinës te bëjnë marrëveshje për vendosjen e sinjalizimit me drite dhe barriera mbrojtëse ne rrugën e re dhe te vjetër për ne Aeroport.



Fig.5



Fig.6



Fig.7



Fig.8

Ne këto dy fotografi shihet vendkalimi legal i cili gjendet përafërsisht 300 m larg vendkalimit nga hyrja e vjetër e aeroportit, krahasuar me vitin paraprak gjendja e pastërtisë në afërsi të binarëve është më e mirë, mirëpo sa i përket parametrave tjerë të sigurisë në vendkalim gjendja nuk ka ndryshuar nga viti i kaluar, vendkalimi nuk ka shenja të rrezikut në asnjërën anë të rrugës, në afërsi të vendkalimit.



Fig.9



Fig.10

Ne këto dy fotografi shihet vendkalimi legal i cili gjendet përafërsisht 500 metra nga hyrja e vjetër e aeroportit, vendkalimi është tërësisht i pa siguruar mungojnë shenjat e rrezikut në të dy anët e rrugës, sinjali në afërsi të vendkalimit është jashtë funksionit. Krahasuar me vitin paraprak gjendja në këtë vendkalim është e njëjte nuk ka përmirësime sa i përket sigurisë hekurudhore. Me qëllim të rritjes së sigurisë në komunikacionin hekurudhor në vendkalim duhet të vendosen shenjat e rrezikut në të dy anët e rrugës.



Fig.11



Fig.12

Ne këto fotografi shihet vendkalimi i cili gjendet përball betonjerkës, vendkalimi është tërësisht i pa siguruar, mungojnë shenjat e rrezikut në të dy anët e rrugës, mirëmbajtja pranë binareve në gjendje të mirë, traversat në gjendje të mirë teknike, shtresa e balastit e mjaftueshme. Krahasuar me vitin paraprak vendkalimi është në gjendje të njëjte dhe nuk ka përmirësime sa i përket sinjalizimit. Me qëllim të rritjes së sigurisë në komunikacion vendkalimi duhet pajiset me shenjat e rrezikut në të dy anët e rrugës.



Fig.13



Fig.14

Ne këto dy fotografi shihet vendkalimi ilegal i cili gjendet përball shenjës treguese të komunikacionit rrugor përfundim i fshatit Harilaq, vendkalimi është i pa siguruar mungojnë shenjat e rrezikut në të dy anët e rrugës, shenja hektometrike është ndryshkur dhe gati sa nuk është mbuluar e tëra, krahasuar me vitin paraprak sa i përket gjendjes së sigurisë nuk ka përmirësim. Me qëllim të rritjes së sigurisë në komunikacionin hekurudhore dhe parandalimit të ndonjë aksidenti vendkalimi duhet të pajiset me shenjat e rrezikut në të dy anët e rrugës.



Fig.15



Fig.16

Ne këto dy fotografi shihet vendkalimi legal, i cili gjendet në afërsi të stacionit të Policisë rruga Mehmet Gradica, vendkalimi është i pa siguruar me shenja të rrezikut, në afërsi të vendkalimit siç shihet dukshmëria nuk është e mire për shkak të shkurreve. Krahasuar me vitin paraprak vendkalimi është në gjendje të njëjte dhe nuk ka përmirësime sa i përket sigurisë. Meqenëse ky vendkalim është shumë i frekuentuar nga automjetet dhe mund të vijë deri të ndonjë aksident, ky vendkalim duhet të pajiset me rampë mbrojtëse (barriere).



Fig.17



Fig.18

Ne këto dy fotografi shihet vendkalimi i cili gjendet në fshatin Medvec, vendkalimi është i pajisur me shenja të rrezikut në të dy anët e rrugës, shtresa e balastit është e pa mjaftueshme. Krahasuar me vitin paraprak vendkalimi është pajisur me shenja të rrezikut në të dy anët e rrugës.



Fig.19



Fig.20

Ne këto fotografi shihet vendkalimi legal i cili gjendet përball minierës në Medvec, vendkalimi është tërësisht i pa siguruar në të dy anët e rrugës. Me qenë se ky vendkalim frekuentohet nga automjetet, vendkalimi duhet të pajiset me shenja të rrezikut në të dy anët e rrugës.



Fig.21



Fig.22

Ne këto dy fotografi shihet gjendja e vendkalimit legal i cili gjendet përball punëtorisë së minierës në Medvec, vendkalimi është tërësisht i pa siguruar mungojnë shenjat e rrezikut në të dy anët e rrugës, shtresa e balastit është e pa mjaftueshme. Ky vendkalim duhet të pajiset me shenja të rrezikut në të dy anët e rrugës si dhe të përmirësohet niveli i shtresës së balastit.

8.9. SHTOJCË IX

8.9.1. Raporti i regjistrimit të mjeteve me pronësi të pa definuar

RAPORT

I mjeteve me pronësi të padefinuar

Departamenti i Interoperabilitetit me 04.02.2015 ka filluar me regjistrimin e mjeteve hekurudhore me pronësi të pa definuar, dhe së procesi, regjistrimit ka përfunduar më 10.04.2015. Aktiviteti është udhëhequr nga ARH, gjegjësisht Departamenti i Interoperabilitetit, por pjesë përbërëse e komisionit për regjistrimin e këtyre mjeteve kanë qenë edhe Departamenti i Sigurisë (ARH) dhe përfaqësuesit nga kopanit: Trainkos dhe Infrakosi

Prishtinë 24/04/2015



Përmbajtja

Nr	Titulli	Faqja
1.	Hyrje	2
2.	Grupi punues	3
3.	Procesi i regjistrimit	4
4.	Mbarëvajtja e procesit dhe vështirësitë	6

1. Hyrje

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave në vitin 2012 ka realizuar Regjistrimin e Mjeteve Lëvizëse Hekurudhore (mjetet në gjendje funksionale) në gjithë territorin e Kosovës (kërkesë sipas nenit 28(7) të Ligjit për Hekurudhat e Kosovës).

Me një angazhim dhe bashkëpunim në mes të ARH-së, Infrakosit, Trainkosit dhe Ferronikelit, kemi arritur që me sukses ta përfundojmë këtë regjistrim dhe ta krijojmë **Regjistrin Nacional të Mjeteve Lëvizëse (NVR)**, regjistër i kërkuar sipas Vendimi 2007/756/EC të Komisionit Evropian dhe Direktivës për Interoperabilitet 2008/57/EC.

Por në këtë regjistër nuk janë përfshirë mjetet hekurudhore të cilat kanë **pronësi të pa definuar**, andaj për të shkuar një hap tutje me procesin, duke qenë se askush nuk mund të marr përsipër pronësinë dhe administrimin e këtyre mjeteve.

Departamenti i Interoperabilitetit me 04.02.2015 ka filluar me regjistrimin e mjeteve hekurudhore me pronësi të pa definuar, që është aktivitet i udhëhequr nga ARH, gjegjësisht Departamenti i Interoperabilitetit, por pjesë përbërëse e komisionit për regjistrimin e këtyre mjeteve janë edhe Departamenti i Sigurisë (ARH) dhe kompania e Trainkosi-t dhe ajo e Infrakosi-t me përfaqësuesit e tyre. Procesi ka përfunduar më 10.04.2015, pasi është bërë regjistrimi i të gjitha mjeteve lëvizëse në tërë territorin e Kosovës.

2. Grupi punues

Duke qenë se Departamenti i Interoperabilitetit është përgjegjës për mbajtjen e Regjistrin Nacional të Mjeteve Lëvizëse, dhe se e ka edhe të nevojshëm të jetë në dijeni rreth administrimit, përgjegjësisë dhe pronësisë së mjeteve lëvizëse në përgjithësi në territorin e Kosovës, ka qenë udhëheqëse e këtij procesi.

Për të pas një grup sa më reprezentativ (propapil), grupit punuese i janë bashkangjitur edhe Departamenti i Sigurisë (ARH) dhe kompanitë e Trainkosit dhe ajo e Infrakosit, me përfaqësuesit e tyre, duke pasur kështu rolë asistues në grup.

Zyrtarët e përfshirë në procesin e regjistrimit dhe pozitat e tyre në grupin punuese i gjeni më poshtë në tabelën 1.

Tabela 1: Grupi Punues.

Zyrtari	Pozita	Kontaktet
Arber Zeka, Kryesues i grupit – ARH	Zyrtar për interoperabilitet	+377 44 406 995, arber.zeka@arh-ks.org
Fisnik Sopjani, Asistues - ARH	Inspektor i Sigurisë	+377 44 469 844, fisnik.sopiani@arh-ks.org
Ali Kadrolli, Asistues – Infrakosit	Shef i Shërbimit të Komunikacionit	+386 49 426 763, ali.kadrolli@kosovorailway.com
Muhamet Orllati, Asistues - Trainkos		+386 49 260 534, muhamet.orllati@trainkos.com

Vërejtje: Procesit të regjistrimit i janë bashkangjitur edhe asistenti i Departamentit të sigurisë Leotrim Maloku (ARH), në një fazë të më vonshme dhe zyrtari nga kompania e Trainkosit; Faik Hoti, i cili ka bërë zëvendësimin e Muhamet Orallanit përgjatë kohës sa ai ka qenë në pushim.

3. Procesi i regjistrimit

Pas mbajtjes së takimit paraprak, grupi ka vazhduar me punë në teren, ku dhe ka bërë mbledhjen e të dhënave nga mjete lëvizëse si:

- Numri i Mjetit Lëvizës
- Seria
- Koha e revizionit
- Boshtet
- Pronësia
- Gjendja teknike
- dhe ndonjë specifik tjetër e mundshme për ta identifikuar mjetin lëvizës.

Duhet cekur, se shpesh janë paraqitur probleme në mbledhjen e këtyre të dhënave, pasi që shumica e mjeteve lëvizëse kanë qenë në gjendje shumë të keqe teknike, qa e ka pamundësuar marrjen e shenjave identifikuese apo karakteristikave teknike të mjetit lëvizës.



Figura 1: Gjendja e ML-ve

Gjithsejtë janë të regjistruar 490 mjete lëvizëse me pronësi të pa definuar, ku se cilit nga mjetet e regjistruara më rastin regjistrimit i është dhënë edhe një numër rendor, që të është më e lehtë pastaj për identifikime të mëtutjeshme.

Përgjatë regjistrimit, kemi kaluar përmes edhe të 65 mjeteve lëvizëse që janë në pronësi të Trainkosit. Por këto mjete vetëm janë identifikuar edhe nuk është bërë ri regjistrim në lidhje më to, duke qenë së para fillimit të procesit të regjistrimit të mjeteve më pronësi të pa definuar, është bërë azhurnimi i **Regjistrimit Nacional të Mjeteve Lëvizëse (NVR)**.

Nëse i referoheni tabelës 2, aty gjeni regjistrin e numrit të mjeteve lëvizëse të pa definuar pronësia e tyre. Ky regjistër përmban vetëm të dhëna preliminare, pasi që regjistri do të ri shikohet dhe njëherë për të evituar eventalisht gabimet e mundshme teknike, rishikim do të argumentohet edhe më anë të fotografive dhe dokumentacioneve të tjera të nevojshme:

Regjistrimi	Data e Regjistrimit (prej deri)	Sasia	Nr nga ARH	Vendi i ML-ve
1	04.02.2015 – 13.03.2015	90	1-163	Fushë-Kosovë
2	26.02.2015 – 11.03.2015	73	85-157	Bardhë i Madh
3	16.03.2015 – 03.04.2015	309	164-472	Miradi
4	08.04.2015	6	473-478	Obiliq, KEK
5	10.04.2015	12	479-490	Mitrovicë, Fafos (Trepçe)
	Total	490		

4. Mbarëvajtja e procesit dhe vështirësitë

Gjatë procesit të regjistrimit të mjeteve lëvizëse me pronësi të pa definuar kemi hasur në shumë mjete lëvizëse të demoluar totalisht, të cilave edhe nuk është e mundur të u shihet numri identifikues, apo edhe karakteristikat e tjera teknike. Me gjithë atë identifikimin e tyre, e kemi bërë në bazë të karakteristikave të tjera teknike të mjetit lëvizës. Shih fotot:



Të disa mjete lëvizëse, kemi hasur edhe nga dy numra identifikues, ku numri i vendosur në ballë ndryshon nga numri i vendosur në bosht apo gjetiu, kjo argumentohet së mjeti lëvizës e ka ndryshuar pronësinë. Megjithatë ne kemi identifikuar mjetin dhe i kemi shënuar të dy numrat e tij, për ta pas më lehtë pastaj identifikimin dhe përcaktimin e pronarit të mjetit lëvizës.



Gjatë regjistrimit të mjeteve lëvizëse të pa definuar pronësia e tyre, kemi hasur në mjete lëvizëse të cilat janë në operim, dhe se këto mjete janë të pa autorizuar për të operuar. Mjetet lëvizëse në fjalë i është bërë një revizion për tu futur në operim, kjo edhe mund të shihet në fotografën 2: Gjithashtu këtu duhet cekur së Revizioni i këtyre mjeteve është i shënuar si në foto, ku argumentohet se revizioni i është bërë në Fushë-Kosovë gjatë vitit 2014.





8.10. SHTOJCË X

8.10.1. Raporti i Monitorimit të Tregur

RAPORTI VJETOR I MONITORIMIT TË TREGUT HEKURUDHORE PËR VITIN 2014



PRISHTINË, 2015



Përmbajtja

Hyrje.....	3
Qëllimi i Raportit.....	3
Metodologjia.....	3
Përmbledhje e të gjeturave.....	4
Transporti i Udhëtarëve.....	5
Transporti i Mallrave.....	5

Fokusi i Raportit

1. Struktura e përgjithshme e tregut.....	6
2. Infrastruktura.....	8
3. Tregu në Transportin e Udhëtarëve.....	10
4. Tregu në Transportin e Mallrave.....	13
5. Shërbimet hekurudhore të lidhura me transportin hekurudhor.....	17
Harta e Rrjetit Hekurudhor të Kosovës.....	20

Hyrje

Departamenti i Rregullimit të Tregut në kuadër të kompetencave ligjore dhe konform planit të punës, njërën nga përgjegjësit kryesore e ka edhe monitorimin e tregut hekurudhor në vend. Në kuadër të kësaj përgjegjësie ligjore departamenti i rregullimit të tregut krahas raportit vjetor të punës e ka përgatitur edhe një raport për fushën e monitorimit të tregut, ku në detaje ka paraqitur të dhënat e gjetura nga tereni dhe burime të ndryshme të informacionit nga entitete të ndryshme që merren me statistika dhe analiza të transportit në përgjithësi. Ky është raporti i dytë më radhë që përgatitet për Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave.

Qëllimi i raportit

Qëllimi i raportit të monitorimit është që të mbledh sa më shumë të dhëna për tregun hekurudhor, në mënyrë që këto dhëna t'i vë në shërbim të funksionimit më të mirë të sektorit hekurudhor. Monitorimi i tregut është konsideruar si një instrument dhe mekanizëm i rëndësishëm i cili mund të kontribuoj në rritjen e cilësisë së shërbimeve në transportin hekurudhor, po ashtu raporti i monitorimit të tregut mund të shërbej si një dokument i rëndësishëm që paraqet zhvillimin e tregut hekurudhor në vend për të gjitha palët e interesit.

Metodologjia

Në mungesë të një dokumenti i cili i përcakton treguesit e monitorimit të tregut, ne si departament kemi ndjekur metodën e Irg-Rail Grup për monitorimin e tregut hekurudhor, duke qenë anëtar me të drejta të plota në këtë grup të pavarur të rregullatorëve të tregut hekurudhor. Udhëzimet që i ka përgatitur dhe publikuar Irg-Rail, ne i kemi shfrytëzuar si model dhe udhërrëfyes për monitorimin e tregut hekurudhor në vend. Përmes këtyre udhëzimeve ne kemi hartuar një plan për përgatitjen e raportit të monitorimit ku i kemi përfshirë treguesit e tregut hekurudhor evropian, më poshtë do të keni mundësi të shihni edhe fokusin e këtij raporti.

Përmbledhje e të gjeturave

Departamenti i Rregullimit të Tregut gjatë punës monitoruese gjatë vitit 2014 ka regjistruar disa mospërmbushje të obligimeve ligjore të cilat e kanë pamundësuar funksionimin e tregut hekurudhor në nivelin e kënaqshëm, duke vërejtur situatën e cila ka mbretëruar dhe gjendjen



që janë ndërmarrjet hekurudhore këto mospërmbushje të obligimeve ligjore nuk janë adresuar në nivel me te larta më shpresë se në të ardhmen do të rregullohen.

Disa nga mospërmbushjet e obligimeve ligjore janë:

Marrëveshja kontraktuale: Kjo marrëveshje është një detyrim ligjor për Qeverinë dhe menaxherin e Infrastrukturës “Infrakos” e cila parashihet me nenin 63.3 të ligjit për hekurudhat, mirëpo kjo marrëveshje deri me tani nuk është arritur. Qëllimi i kësaj marrëveshje është që Menaxherit të Infrastrukturës t’i siguroj një financim stabil për një periudhe afatgjate.

Marrëveshja Kornizë: Kjo marrëveshje është një obligim ligjor që duhet të arrihet në mes të Menaxherit të Infrastrukturës dhe Operatorit, kjo ndryshe quhet edhe marrëveshja mbi qasjen në infrastrukturë e cila i konkretizon dhe definon shërbimet që i pranon operatori nga menaxheri i Infrastrukturës, parashihet me nenin 76 të ligjit për hekurudhat, gjatë vitit 2014 nuk është nënshkruar.

Kontrata e shërbimeve publike PSO: Kjo kontratë nuk është arritur sipas formatit ligjor në mes autoritetit kompetent dhe operatorit, nuk ka pasur as tender që parashihet me nenin 132 të ligjit për hekurudhat, kjo kontratë parashihet me nenin 130 të ligjit për hekurudhat.

Pagesat e qasjes në infrastrukturë: Pagesat e qasjes kanë qenë fokusi i debatit në mes të palëve të interesit, këtë proces e kemi monitoruar dhe kemi dhen rekomandimet tona konform situatës se tregut dhe vendeve të rajonit, pas një procesi të gjatë Ministria e Infrastrukturës si organ që vendos për pagesat e propozuara nga Infarkosi, ka nxjerr vendim që të aprovoj modelin e vitit 2013 për argëtimin e pagesave të qasjes dhe nivelin e tarifave për vitin 2015.

Transporti i udhëtarëve

Transporti i udhëtarëve në vitin 2014 është realizuar nga Operatori Publik “Trainkos”, janë realizuar gjithsej 296,756 tren/km, kilometrat e udhëtarëve kanë pasur një ngritje për 5% në krahasim me 2013, burimi kryesor i të ardhurave në këtë transport ka qenë Kontrata për ofrimin e shërbimeve publike me gjithsej 57% të hyrave (OSHP), pagesat e qasjes për transportin e udhëtarëve ka qenë në mesataren 1.41€ për tren km, mesatarja e numrit të trenave në ditë ka qenë 14.10 trena në ditë. Transporti i udhëtarëve ka funksionuar në këto linja: Prishtinë-Pejë-Prishtinë, Fushë Kosovë-Hani i Elezit- Fushë Kosovë, si dhe me një linje

ndërkombëtare Prishtinë-Shkup-Prishtinë, numri i udhëtarëve në transportin hekurudhor në vitin 2014 ka pasur një rënie në 4.70% në krahasim me vitin 2013.

Transporti i mallrave

Transporti i mallrave në vitin 2014 është realizuar nga Operatori Publik "Trainkos" Tren/kilometrat e realizuar në transportin e mallrave për vitin 2014 kanë qenë 83,210 tren/km, nëse e krahasojmë me vitin 2013, trenkilometrat kanë pasur një rënie për 24% më pak në vitin 2014 se sa viti 2013. Pagesat e qasjes kanë qenë në mesataren 4.90€ për tren/km, mesatarja e trenave të mallrave në ditë ka qenë 12 trena për ditë, realizimi i transportit të mallrave në neto ton në vitin 2014 ka pasur një rënie rreth 16% krahasuar me vitin 2013.

1. Struktura e përgjithshme e tregut

Kjo pjesë paraqet gjendjen reale të funksionimit të tregut hekurudhor në vend, funksionimin dhe realizimin e transportit hekurudhor në përgjithësi, përdorimin e rrjetit hekurudhor përgjatë vitit raportues 2014.



1.1 Gjithsej transport hekurudhor në tren kilometra:

- Gjithsej transport hekurudhor në tren kilometra për vitin 2014 ka qenë 379,966 trenkilometer.

1.2 Liberalizimi i tregut të mallrave:

- Transporti i tregut të mallrave ka filluar të funksionoj në kuadër të legjislacionit të ri për hekurudhat me 1 Shtator 2011 kur është nda menaxhimi i Hekurudhave të Kosovës në dy kompani, përgjegjës për operim në transportin e tregut të mallrave është kompania publike Trainkos, e cila është e vetme pa konkurrent në transportin hekurudhor të mallrave

1.3 Liberalizimi i tregut të udhëtarëve:

- Transporti i tregut të udhëtarëve ka filluar të funksionoj në kuadër të legjislacionit të ri për hekurudhat me 1 Shtator 2011 kur është nda menaxhimi i Hekurudhave të Kosovës në dy kompani, përgjegjës për operim në transportin e tregut të udhëtarëve është kompania publike Trainkos, e cila është e vetme pa konkurrent në transportin hekurudhor të udhëtarëve deri me tani.

1.4 Numri i ndërmarrjeve aktive hekurudhore:

- Numri i ndërmarrjeve aktive hekurudhore në Republikën e Kosovës në vitin 2014 ka qenë një (1), e cila kompani është pajisur me certifikatë të licencës dhe certifikatë të sigurisë nga Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave, përkatësisht departamentet përkatëse (Departamenti i Licencimit dhe Departamenti i Sigurisë).

1.5 Trafiku i mallrave dhe udhëtarëve në tren kilometra:

- Transporti i trafikut të mallrave në tren kilometër përgjatë vitit 2014 ka qenë 83, 210 tren/km.
- Transporti i trafikut të udhëtarëve në tren kilometër përgjatë vitit 2014 ka qenë 296, 756 tren/km

1.6 Përdorimi i rrjetit:

- Përdorimi i rrjetit hekurudhor në Republikën e Kosovës përgjatë vitit 2014 në përqindje ka qenë nën 50%, për disa arsye. Problemet në infrastrukturë e kanë bërë të pamundshme funksionimin e Linjës Prishtinë-Podujevë, si dhe Klinë-Prizren, po ashtu për shkaqe politike në vend edhe linja Fushë-Kosovë-Leshak nuk ka funksionuar fare nga viti 2008 e deri me tani, edhe pse i plotëson kushtet teknike për shfrytëzim.

2. Infrastruktura

Në këtë pjesë përfshihen karakteristikat e rrjetit hekurudhor, madhësia dhe përdorimi i tij, pagesat e qasjes në infrastrukturë për transportin e mallrave dhe udhëtareve.





2.1 Gjatësia e trasesë në kilometra:

- Hekurudhat e Kosovës disponojnë me 347 km gjatësi ndërtimore të linjave hekurudhore një binarësh, dhe me 110 km tjera me binar privat apo industrial, gjithsej 443 km trase. Nuk ka Linja të elektrifikuar në rrjetin hekurudhor. Hekurudhat e Kosovës janë të lidhur me dy shtete: Republikën e Serbisë dhe Republikën e Maqedonisë. Infrastruktura është pronë e shtetit dhe menaxhohet nga Menaxheri i Infrastrukturës "Infrakos"

2.2 Intensiteti i përdorimit të rrjetit, Trenat për linje kilometër në ditë:

- Intensiteti i përdorimit të rrjetit në funksion të operatorit gjatë vitit 2014 ka qenë me një mesatare prej 3.00 Trenat për linje kilometër në ditë

2.3 Mesatarja e pagesave të qasjes në trase, Euro për tren kilometër , mallra, udhëtar:

- Pagesat e qasjes në infrastrukturë për operatorin në transportin e mallrave kanë qenë në mesataren e 4.90€ për tren km, për transportin e udhëtarëve ka qenë në mesataren 1.41€ për tren km.

2.4 Përqindja e pagesave të qasjes në trase në drejtim të të ardhurave për tren kilometër:

- Të ardhurat nga pagesat e qasjes në vitin 2014 kanë qenë për 11% më të ultë se në vitin 2013.
- Të ardhura nga pagesat e qasjes për transportin e udhëtarëve në vitin 2014 kanë qenë 9.27% më të ultë se në vitin 2013.
- Të ardhura nga pagesat e qasjes për transportin e mallrave në vitin 2014 kanë qenë 15.10% më të ultë se në vitin 2013.

3. Tregu hekurudhor i udhëtarëve

Në këtë pjesë kemi përfshi disa elemente me rëndësi për transportin e udhëtarëve hekurudhor pronësinë apo aksionet , përqindjet e kilometrave të udhëtarëve për vitin raportues dhe krahasimin me vitet paraprak, rritjen apo zbritjen me përqindje, të hyrat e ndërmarrjeve nga transporti i udhëtarëve për tren kilometër, burimin e të ardhurave të ndërmarrjes hekurudhore, norma e shfrytëzimit të trenave, mesatarja numrit të udhëtarëve, krahasimi me vitin paraprak, numrin total të udhëtimeve të udhëtarëve, si dhe intensitetin e përdorimit të rrjetit për transportin e udhëtarëve



3.1 Pronësia e ndërmarrjes në tregun e transportit të udhëtarëve:

- Ndërmarrja e cila operon në funksion të transportit të udhëtarëve në rrjetin hekurudhor të Kosovës është ndërmarrje 100% publike.

3.2 Kilometrat e transportit të udhëtarëve dhe evolucioni i kilometrave të udhëtarëve:


- Në transportin e udhëtarëve janë realizuar gjithsej 296,756 tren/km
- Kilometrat e udhëtarëve kanë pasur një ngritje për 5% në krahasim me 2013.

3.3 Të hyrat e ndërmarrjes hekurudhore të udhëtarëve, EUR për tren km të kryera nga trenat e udhëtarëve:

- Ekzistoj gjithsej katër (4) burime të të ardhurave të ndërmarrjes hekurudhore në transportin e udhëtarëve, ato janë: Të hyrat nga kontrate e ofrimit të shërbimeve publike-OSHP, Të hyrat nga transporti i udhëtarëve-MZHE, Shitja nga biletat, dhe nga Transporti i organizuar.

Përqindja e të ardhurave të përgjithshme të ndërmarrjes hekurudhore në transportin e udhëtarëve në formë tabelore:

Të hyrat nga transporti i udhëtarëve-OSHP	57.17%
Të hyrat nga transporti i udhëtarëve-MZHE	28.53%
Shitja nga biletat	13.70%
Transporti i organizuar	0.60%

**Figura 1.**

3.4 Norma e shfrytëzimit të Trenave:

- Në vitin 2014 në rrjetin hekurudhor kanë qarkulluar 5149 trena të udhëtarëve, në krahasim me vitin 2013 kanë qenë 10 trena më shumë, që në përqindje i bie 0.19% me shumë se viti paraprak.
- Nëse e përpjesëtojmë numrin e trenave në vite (5149) me numrin e ditëve të vitit (365) i bie se i kemi pasur mesatarisht 14.10 trena për ditë.

Krahasimi i Trenave	Numri i Trenave
Viti 2013	5139
Viti 2014	5149
Dallimi 2014-2013	10

Numri i udhëtarëve në mijë 2012-2014:

Vitet	2012	2013	2014
Numri i udhëtarëve në mijë	366,537	369,777	352,410




Figura 2.


Si shihet nga të dhënat sa i përket transportit të udhëtarëve në vitin 2014 ka pasur një rënie në 4.70% në krahasim me vitin 2013.

3.5 Intensiteti i përdorimit të rrjetit nga transporti i udhëtarëve, Trenat e udhëtarëve për km trase në ditë:

- Intensiteti i përdorimi i rrjetit nga transporti i udhëtarëve ka qenë 2.34 , trena të udhëtarëve për km trase në ditë (Llogaritja: Tren km e realizuar / gjatësia e trasesë / dite e vitit)

4. Tregu hekurudhor i mallrave

Kjo pjesë përshkruan gjendjen aktuale dhe zhvillimin e tregut të mallrave, konkurrencën e këtij transporti me transportet tjera, tren kilometrat e realizuara, numrin e trenave të mallrave, pronësinë apo aksionet e operatoreve të mallrave, të hyrat nga transporti i mallrave për tren kilometër etj.



4.1 Transport i mallrave për tren kilometra, dhe numri i trenave të realizuar:

- Trenkilometrat e realizuar në transportin e mallrave për vitin 2014 kanë qenë 83,210 tren/km, nëse e krahasojmë me vitin 2013, trenkilometrat kanë pasur një renje për 24% më pak në vitin 2014.
- Numri i trenave të realizuar për vitin 2014 ka qenë 4378 trena në vitë, në krahasim me vitin 2013 janë realizuar -708 trena me pak, që në përqindje i bjenë 13.92% me pak.
- Nëse e përpjesëtojmë numrin e trenave në vitë (4378) me numrin e ditëve të vitit (365) i bie se i kemi pasur mesatarisht 12 trena për një ditë.
- Intensiteti i përdorimi i rrjetit nga transporti i mallrave ka qenë 0.65 , trena të mallrave për km trase në ditë (Llogaritja: Tren km e realizuar / gjatësia e trasesë / dite e vitit)

Krahasimi i Trenave	Numri i Trenave
Viti 2013	5086
Viti 2014	4378
Dallimi 2014-2013	-708

4.2 Transporti i mallrave 2012-2014:

Ton mallrat e realizuar në transportin e mallrave në mijë (2012-2014)

Vitet	2012	2013	2014
Sasia e mallrave e realizuar ne neto ton	747,416.00	1,002,457.84	837,829.54



Sasia e mallrave të transportuara në milion ton - km	49	43	39




Figura 3.

Përqindja e neto ton kilometrave në vitin 2014 krahasuar me 2013:

Siç shihet nga të dhënat realizimi i transportit të mallrave në neto ton në vitin 2014 ka pasur një rënie rreth 16% krahasuar me vitin 2013.




Figura 4.

4.3 Pronësia e tregut të operatorëve në transportit e mallrave:

- Ndërmarrja e cila operon në funksion të transportit të mallrave në rrjetin hekurudhor të Kosovës është ndërmarrje 100% publike.

4.4 Të hyrat e ndërmarrjeve hekurudhore të mallrave:

Shitjet nga transporti i mallrave	88.96%
Shërbimet tjera të transportit të mallrave	11.04%




Figura 5.

5. Shërbimet hekurudhore të lidhura me transportin hekurudhor.

Kjo pjesë e raportit përfshihen disa shërbime hekurudhore që kanë të bëjnë me hekurudhat, siç janë stacionet e udhëtarëve, terminalët e mallrave (numrin e objekteve të ngarkim/shkarkimit), objektet e mirëmbajtjes dhe mjetet e rimbushjes me karburante, po ashtu numrin e stacioneve për formimin e trenave.

5.1 Stacionet e udhëtarëve:

- Stacionet e udhëtarëve përgjatë rrjetit hekurudhor kategorizohen në: stacione të zotëruara me personel, dhe në vendqëndrime ku nuk janë të zotëruara me personel.

5.1.1 Numri i stacioneve të udhëtarëve:

- Numri i stacioneve për udhëtar i zotëruar me personel në rrjetin hekurudhor është 23 stacione (nga këto stacione 15 mund të përdoren edhe për dërgesa me vagonë të mallrave), dhe 27 vendqëndrime të trenit, ku shfrytëzohen nga udhëtarët.

5.1.2 Numri i operatorëve për stacionet e udhëtarëve:

- Numri i operatorëve që përdorin rrjetin hekurudhor është një(1), operatori publik Trainkos, është ai i cili i ka pasur në dispozicion stacionet e udhëtarëve për shfrytëzim.

5.2 Terminalët e mallrave:

Me termin Terminalët e mallrave në rrjetin hekurudhor, nënkuptohen të gjitha vendet zyrtare (stacionet) e hapura për transport të mallrave në të cilat kryhet ngarkim-shkarkimi i mallrave. Në stacionin e Miradisë është i ndërtuar terminal i posaçëm që mundë t'i pranoi të gjitha llojet e dërgesave të mallrave konvencionale dhe atyre të kontejnerëve si dhe përgatitjen e tyre për dërgim deri në depon e pranuesit të mallit. Terminali disponon me kran për manipulim me kontejnerë me peshë ngritëse prej 40 tonë. Lartësia e ngritjes është 9 m, përkatësisht në pesë nivele. Hapësira e terminalit është 8000 m² e asfaltuar. Gjatësia e fushës operative është 400 metra. Terminali ka binarin për vendosjen e vagonëve në ngarkim dhe shkarkim. Në platonë e terminalit e cila është e asfaltuar mundë të vendosën 13 vagonë me kontejnerë. Pjesa tjetër është e asfaltuar dhe shërben për shkarkimin e mallrave tjerë. Terminali ka edhe rampën anësore për ngarkimin dhe shkarkimin e mallrave me gjatësi prej 120 metrave.

Numri i objekteve të ngarkim / shkarkimit është një (1)

Numri i terminaleve intramodale të mallrave është një (1)

Numri i operatorëve të terminaleve intermodal të mallrave është një (1)

Stacionet përmbledhëse (stacionet ku përdoren për formimin trenave):

Numri i stacioneve përmbledhëse:

Numri i stacioneve të përbashkëta me vendet e formimit të trenave është katër (4)

5.3 Objektet për mirëmbajtje:

Objektet e mirëmbajtjes janë ato objekte ku mirëmbajtja e mjeteve lëvizëse kryhet, objekti dhe pajisjet e mirëmbajtjes janë pronësi të kompanisë së operimit me trena "Trainkos"

Numri i pajisjeve të mirëmbajtjes është një (1)

Numri i objekteve të mirëmbajtjes së operatorëve është një (1)

5.4 Pajisjet për furnizim me derivate:


Pajisjet për furnizim konsiderohen pajisjet të cilat furnizojnë ndërmarrjet hekurudhore me derivate. Objekti dhe pajisjet për furnizim me derivate janë në pronësi të kompanisë së operimit me trena "Trainkos"

Numri i pajisjeve për furnizim është një (1)

Numri i operatorëve të pajisjeve për furnizim është një (1)

Lidhja midis gjithsej tren kilometrave dhe numrit të pajisjeve furnizuese është një (1)

**RRJETI HEKURUDHOR
I KOSOVËS**



Mars, 2016